

Duke respektuar vullnetin e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut të shprehur në zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 15 korrik të vitit 2020 dhe duke rikonfirmuar angazhimin e të gjithë qytetarëve për paqe, stabilitet dhe siguri, marrëdhënie të mira ndëretnike dhe ndërfaqinësore, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shtet ligjor, mjedis jetësor të pastër dhe mirëqenie shoqërore;

Të përcaktuar fuqishëm që pas anëtarësimit në NATO të sigurojmë edhe anëtarësimin në Bashkimin Europian;

Partitë politike që fituan shumicën e vendeve të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendosën të krijojnë shumicë parlamentare që të formojnë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë me mandatin e realizimit të përcaktimeve politike në këtë:

## **PROGRAM PUNE I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË PERIU DHËN 2020-2024**

Shumica parlamentare e shpreh vullnetin e saj të fortë politik për të formuar një qeveri që do të garantojë **vazhdimësi** në zbatimin e prioriteteve të përbashkëta strategjike: anëtarësimi në NATO dhe në Bashkimin Europian, marrëdhënie të mira ndërfaqinësore dhe ndëretnike, kohezion të brendshëm, ballafaqim me pandeminë e virusit korona dhe **energji të re dhe vendosmëri** për të krijuar rritje më dinamike ekonomike, zhvillim të qëndrueshëm, arsim modern, shtet efikas ligjor dhe institucione të qëndrueshme.

### **Transformimi i ekonomisë (MK Restart) për rritje të përshpejtuar dhe standard më të lartë**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqitet me një koncept ambicioz dhe të plotë për vazhdimin e politikave të nisura pozitive dhe ndërmarrjen e politikave të guximshme, të bashkërenduara, të negociuara dhe efektive që e përshtasin ekonominë tonë për kohën e re. Në tre vitet e fundit treguam se mund të sigurohet një rritje më e lartë ekonomike (në vitin 2019, PBB-ja u rrit me 3.6%) që krijon vende të reja pune (për dy vite u krijuan 60,000 vende të reja pune) paralelisht me sigurimin e rrogave më të larta (rroga mesatare u rrit në 27,206 denarë, e që është rritja historikisht më e lartë). U konfirmua se mund të arrihet papunësia historikisht më e ulët (në vitin 2019 papunësia ra në 16.6%) së bashku me një rritje të rrogës minimale nga 9,000 denarë në 14,500 denarë për më pak se tre vjet.

Kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka goditur rëndë ekonominë tonë dhe atë botërore. Të gjitha institucionet përkatëse parashikojnë që këtë vit bota do të hyjë në një recesion dhe kjo është e dukshme edhe te partnerët tanë tradicionalë ekonomikë dhe tregtarë. Kjo goditje i preku rëndë ekonominë më të mëdha dhe më të zhvilluara. Ekonominë më të fuqishme po hyjnë në një recesion dhe po raportojnë një rritje të konsiderueshme të papunësisë dhe trysni të dukshme në sistemet sociale dhe shëndetësore.

Kjo nënkuptonte pakësim të porositve të prodhuesit tanë, vështirësi në transportimin dhe furnizimin e lëndëve të para, si dhe konsum ndjeshëm të pakësuar në tregun e brendshëm dhe atë botëror. Masat kufizuese për mbrojtje nga COVID-19 në mënyrë plotësuuese i ngadalësuan ose i ndaluan proceset e prodhimit dhe i ulën të ardhurat e ndërmarrjeve tona. I gjithë shteti, të gjithë qytetarët tanë, institucionet dhe ekonomia në përgjithësi ishte dhe është vënë në provën më të vështirë deri më tani. Kjo krizë globale nuk mund të na anashkalonte, por ne mundëm dhe siguroam një përgjigje të duhur dhe të shpejtë.

Qëllimi ynë nuk është që Qeveria të jetë një menaxhuese e suksesshme e krizës, por ta kapërcejmë shpejt krizën dhe të kthehemi në rrugën e rritjes dhe zhvillimit, në zbatimin e politikave thelbësore, që sa më shpejtë të përgatitemi për „normalitetin e ri" pas COVID-19, duke e trasuar rrugën europiane me politika reformuese dhe rritje të përshpejtuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme,

duke synuar përmirësimin e standardit të jetesës dhe cilësinë e jetës së qytetarëve, në nivel të BE-së, për një periudhë afatmesme.

Ne planifikojmë që të përqendrohemi në implementimin e procesit kryesor të transformimit të ekonomisë sonë. Me hyrjen në aleancën e NATO-s dhe fillimin e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Europian, përfundimisht bëhemi pjesë e shoqërisë së më të zhvilluarve, më të pasurve dhe më të aftëve. Ne po hyjmë në tregun e përbashkët europian me forcë të re dhe mundësi të reja. Qëllimi i qeverisë është transformimi i ekonomisë sonë për të qenë më konkurruese, fillimisht brenda dhe pastaj jashtë vendit. Lëvizja e ekonomisë do të bazohet në një valë të fortë të investimeve publike, investimeve të drejtpërdrejta të brendshme dhe të huaja dhe, më e rëndësishmja, në risi (inovacion) në të gjithë sektorët, duke synuar rritje të ndjeshme të prodhimit, cilësisë dhe vlerës së shtuar të prodhimeve dhe shërbimeve. Digjitalizimi po bëhet një proces thelbësor që ekonomia të bëhet më efikase, cilësia e jetës të rritet, ndërkaq rezultatet të bëhen më efektive.

Që të jetë i suksesshëm transformimi i ekonomisë sonë në një ekonomi dinamike, të hapur dhe konkurruese, ne ofrojmë një kornizë të qëndrueshme makroekonomike në të cilën sistemi i taksave do të jetë i parashikueshëm, efikas, i drejtë dhe seriozisht do të zvogëlojë ekonominë gri dhe do të nxisë nismën private dhe investimet. Dukshëm do të forcojmë kapacitetin e realizimit të investimeve publike. Investimet kapitale do të jenë gjeneratori i konsumit të investimeve publike, që krejtësisht të përqendrohemi në potencialin e madh të konsumit vendor dhe të investimeve.

Deri në fund të mandatit, ne do ta kthejmë ekonominë tonë në rritje solide dhe të qëndrueshme prej 4%. Gjatë krizës do të angazhohemi që ta ruajmë lartësinë e rrogës minimale në vlerën prej 14,500 denarë. Pas përfundimit të krizës, Qeveria do të vazhdojë me zotimet e dëshmuara të saj: 1) rritjen e rrogës minimale, deri në fund të mandatit, në vlerë prej 20 deri 40% dhe 2) rritjen e rrogës mesatare, deri në fund të mandatit, në vlerë prej 20 deri në 30%, në varësi të kohëzgjatjes dhe ndikimit të epidemisë në ekonominë botërore dhe atë të vendit.

Shumën e investimeve të huaja e planifikojmë në një nivel prej të paktën një miliard euro për katër vjet, duke u përqendruar në ato të bazuara në risi, shkallë të lartë të finalizimit të prodhimeve dhe shërbimeve si dhe në qëndrueshmëri të afarizmit.

Qeveria do të krijojë një kornizë ligjore dhe financiare që do të rrisë nivelin e investimeve publike në 2.2 miliardë euro, ndërsa investimet private të drejtpërdrejta do të jenë 1.2 miliardë gjatë gjithë mandatit. Për atë qëllim, Qeveria do të bëjë një rikonfigurim të plotë të procedurave dhe të sistemit të realizimit të investimeve kapitale publike nëpërmjet Njësisë së Përcjelljes në Ministrinë e Financave dhe Njësisë Qendrore të Mbështetjes së Investimeve Publike, në nivel qeveritar, me qëllimin e vetëm - realizimin e plotë, transparent dhe në kohë të shpenzimeve buxhetore dhe, veçanërisht e rëndësishme, matjen e rezultateve dhe efekteve të politikave ekonomike në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë. Për më tepër, për çdo investim të vlefshëm kapital, qeveria do të krijojë një ITF – investment taks force (grup pune investimesh) me ekspertë vendas dhe të huaj.

Qeveria do të fillojë zbatimin (në faza dhe me disa pilot institucione) e financimit buxhetor sipas parimit të përmbushjes së treguesve të zhvillimit (KPI e mençur) ku çdo departament do të ketë treguesit e tij të zhvillimit që do të përcaktohen në fillim të vitit dhe do të përcillen çdo tre muaj. Duke e matur përqindjen e realizimit të treguesve, do të miratohen shumat e mjeteve për tremujorin e ardhshëm. Qëllimi ynë është t'i nxisim institucionet të rrisin përqindjen e realizimit të programeve vjetore dhe alokimin aktual të mjeteve aty ku ka kapacitet dhe aftësi realizimi (kthimi te ekonomia / te qytetarët).

Shkallën e papunësisë, gjatë kohës së krizës, do ta mbajmë të qëndrueshme, dhe pas përfundimit të krizës dhe deri në fund të mandatit ne do të vazhdojmë të ulim papunësinë nga 3% në

vit, siç kemi bërë në tre vitet e fundit. Pas përfundimit të krizës, synimi ynë do të jetë papunësia njëshifrorëshe.

Për të mbështetur një rritje të këtyllë dinamike, ne do të sigurojmë mbështetje të drejtpërdrejtë për investimet vendore dhe të huaja në vlerë prej 300 milionë euro nga buxhetet e brendshme dhe nga alokimi i drejtpërdrejtë i 300 milionë eurove nga fondet europiane. Ne do të realizojmë mbështetjen e drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve vendase, nëpërmjet Planit të Rritjes Ekonomike dhe Ligjit të Mbështetjes Financiare të Investimeve, me financim paraprak të nevojave teknologjike dhe inovative në funksion të eksportit në vlerë prej 10 deri 15% të investimit të projektuar.

Qeveria do të risë vëllimin e mbështetjes financiare për ndërmarrjet vendase, nëpërmjet Planit të Rritjes Ekonomike, me 25% për çdo vit, krahasuar me atë të paraprak.

Duke pasur parasysh ndikimin e pandemisë në ekonominë vendore dhe botërore si dhe nevojën për të nxitur aktivitetin investues pikërisht në kohë krize, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjashtë muajt e ardhshëm do të zbatojë fletobligacion zhvillimi si një praktikë e provuar e llojit të bashkinvestimit të qytetarëve dhe afarizmit në zhvillimin inovativ të ekonomisë. Qëllimi do të jetë financimi i projekteve zhvillimore ku ka kthim të mjeteve nga të ardhurat, pra zvogëlimi i shpenzimeve, nxitja e zhvillimit - rritja e prodhimit dhe modernizimi i proceseve të prodhimit (infrastruktura, bashkëfinancimi i investimeve në sektorin privat, efikasiteti i energjisë dhe digjitalizimi i sektorit publik).

Qeveria do të kryejë analizë për liberalizim gradual të politikave investuese të fondeve pensionale private në shtyllën e dytë dhe të tretë të financimit kapital të sigurimit pensional. Analiza do të përgatitet në bashkëpunim me një institucion ndërkombëtar financiar dhe / ose partner europian (EIB (BEI), Komisioni Europian) dhe duhet të përcaktojë arsyetimin dhe modelin për rritjen graduale të shumës së mjeteve (% e portofolit) që fondet të mund të investojnë në projekte që kanë potencial për kthim më të lartë të mjeteve. Një qasje e këtyllë lidhet drejtpërdrejt me futjen e modelit të “cikleve jetësore” dhe futjen e një portofoli të rrezikut, që për pensionistët e ri do të sigurojë kthim më të lartë të investimeve dhe, së dyti, në mënyrë të kujdesshme, për pensionistët më të moshuar që janë të orientuar drejt një rreziku më të ulët.

Një shtysë e konsiderueshme për hyrjen e fondeve të huaja investuese do të jetë krijimi i një fondi të veçantë aksionar në vitin 2020, si pjesë e Planit të Rritjes Ekonomike. Me fondin aksionar parashihet të menaxhojë një shoqëri për menaxhimin e fondeve, e zgjedhur në konkurs ndërkombëtar. Kushtet për zgjedhjen e një shoqërie parashikojnë që, përveç fondeve shtetërore, fondi të investojë edhe mjetet e veta, përkatësisht mjete nga fonde private të investimeve.

### *Mjedisi i parashikueshëm afarist*

Me fillimin e bisedimeve do të harmonizojmë mjedisin afarist në përputhje me rregulloret e BE-së. Do të garantojmë parashikueshmëri në fushën e politikës tatimore. Tatimi mbi fitimin mbetet në 10% gjatë gjithë periudhës 20-24, ndërkaq parashikojmë lirim nga ky tatim gjatë riinvestimeve të fitimit në vitin 2021, si përgjigje e ndikimit të efektit të pandemisë covid. Tatimi i të ardhurave personale do të ulët në 0% në vitin 2023 për industrinë e IT-së në mënyrë të përshkallëzuar: 5% në vitin 2021, 3% në vitin 2022 dhe 0% në vitin 2023. Tatimi i të ardhurave personale mbetet në 10%, por ne mbetemi në qëndrimin për futjen e tatimit progresiv nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës të bisedimeve dhe arritjes së pajtueshmërisë për zbatimin e tij. Gjithashtu, do të hapet një proces bisedimesh për sistemin e tatimeve në aspekt të raportit midis tatimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, përkatësisht raportit të tatimit në pronë, në të ardhura dhe në konsum sipas shembullit të vendeve të zhvilluara dhe specifikave të ekonomisë sonë. Mbetemi të përkushtuar ndaj përligjshmërisë së tatimit, duke ofruar një sistem të mirëmenadur të tatimit progresiv të të ardhurave totale personale, pas një analize serioze paraprake dhe të hollësishme dhe të një debati publik, duke u përqëndruar në rikonfigurimin e konceptit të të ardhurave personale (të ardhurat e familjes) dhe zbatimin e një tatimi për luks.

Qeveria parashikon rikonfigurimin e TVSH-së nëpërmjet:

- zbatimit të një Ligji të ri të Tatimit të Vlerës së Shtuar, që do të sigurojë përfitime tatimore për ndërmarrjet që janë të orientuara drejt eksportit, në një mënyrë të tillë që ata të mos e paguajnë TVSH-në për lëndët e para dhe makineritë e dedikuara për eksport. Në këtë mënyrë ata do të jenë më konkurrues dhe do të kenë mjete financiare dukshëm më të larta;
- Shkallë e vetme prej 10% TVSH për të gjitha shërbimet e restoranteve;
- Rishikimi i normave të TVSH-së për lëndët e para për prodhuesit vendas, ulja e normës së TVSH-së për prodhuesit bujqësorë dhe ulja e normës së TVSH-së për lëndët e para për ndërmarrjet e orientuara drejt eksportit
- Ulje nga 18 në 5% për shërbimet zejtare;
- Ngritja e pragut të pagesës së TVSH-së nga 2 në 3 milionë qarkullim vjetor nga 1.1.2022 dhe barazimi i pragut të lirimit nga tatimi mbi fitimin në 3 milionë denarë qarkullim vjetor.

Qeveria do të vazhdojë me projektin e suksesshëm "TVSH-ja ime" dhe do të rrisë kufirin për individ në 2.300 denarë për një tremujor dhe 9.200 denarë për një vit, d. m. th. në 36.800 denarë mesatarisht për një familje katër anëtarëshe.

Qeveria do të vazhdojë me kthimin e rregullt, pa dallim dhe në kohë të TVSH-së për personat juridikë.

Me një Ligj të ri të Tarifës Doganore dhe pështatjes së përshpejtuar (heqjen, eliminimin dhe uljen e tarifave dhe normave doganore) në raport reciprok me nivelin e tarifave doganore të Tarifës së Përbashkëta Doganore të Bashkimit Europian, qeveria do të sigurojë çmime më të ulëta për ndërmarrjet vendase, duke i bërë më konkurruese për eksport.

Qeveria do të krijojë kushte për vetërregullim të qëndrueshëm në sektorin e kontabilitetit dhe të revizionit të sektorit të korporatave, zbatimin e plotë të Standardeve Ndërnacionale të Kontabilitetit për sektorin e NVM-së deri në vitin 2023 dhe saktësimin dhe përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe të revizionit në sektorin e përgjithshëm publik.

Qeveria do të zbatojë një tatim të ri të qarkullit gjatë pagesës për lojërat e fatit - në normën prej 4% të vlerës bruto të paguar. Të njëjtin do ta paguajnë organizatorët e lojërave të fatit dhe nuk do të transferohet te përdoruesit. Këto fonde do të përdoren për të mbështetur rritjen, zhvillimin dhe përgjegjësinë sociale. Në të njëjtën kohë, Qeveria do të propozojë një ligj që ndalon hapjen e kazinove dhe lojërave të fatit afër shkollave, kopshteve dhe objekteve fetare.

#### *Mbështetje më të madhe për ndërmarrjet dhe sektorët vendas*

Qëllimi ynë është të krijojmë një mjedis për afarizëm dinamik dhe konkurrues, i çliruar nga ndikimet politike, ulje të procedurave dhe pengesave administrative, duke e shfrytëzuar krejtësisht frymën sipërmarrëse dhe njohuritë e kapitalit njerëzor në vend. Transformimi i ekonomisë do të pasohet nga një sërë masash mbështetëse të mirëmenduara, praktike dhe të qëndrueshme, që në të vërtetë do të ndihmojnë që afarizmi ynë të rritet, të zhvillohet dhe të jetë i qëndrueshëm. Si deri më tani, mbështetja kryesore do të jetë pikërisht për forcën lëvizëse të ekonomisë sonë, sektorin më të madh të punësimit, krijuesin e vlerës dhe të konsumatorit më të fortë, pra ndërmarrjet mikro dhe të vogla.

Ne vazhdojmë me Planin e Rritjes Ekonomike dhe me masat e parashikuara në politikë, duke e rritur fondin për të paktën 20% në vit.

Ne do të mundësojmë themelimin e një ndërmarrjeje me një shumë minimale të kapitalit aksionar prej 1 euro. Me këtë masë, qytetarët kanë mundësinë të themelojnë një ndërmarrje me shpenzime minimale dhe të realizojnë idetë dhe planet e tyre afariste nëpërmjet ndërmarrjeve të sapo hapura. Ne besojmë se qytetarët e Maqedonisë së Veriut kanë ide, dhe meqë idetë janë kapitale, ne e hapim sektorin e afarizmit, e bëjmë atë të arritshëm për të gjithë dhe bëjmë thirrje për një garë të ideve dhe të konkurrencës.

Qeveria do të shfuqizojë tatimin mbi të ardhurat personale (i njohur si tatim personal, dhe zbatohet si kthim i tatimit) për kategorinë e trajnimit, kualifikimeve, marrjen e licencave (të përcaktuara

pikërisht vetëm për veprimtarinë e ndërmarrjes) që do të përmirësojë cilësinë e fuqisë punëtore me të cilën disponojnë ndërmarrjet. Do të zbatojmë një ndryshim të plotë të sistemit të pagesave dhe të shumës së tatimit të ndërmarrjes, në përputhje me lartësinë e tatimit të ndërmarrjes, numrin e të punësuarve dhe të ardhurat vjetore.

Do ta shfuqizojmë tatimin e ndërmarrjes për dy vitet e para për të gjitha ndërmarrjet e sapo krijuara dhe do të ulim tepër ndjeshëm shpenzimet e marrjes së dokumentacionit ligjor për nevojat e afarizmit (dokumente nga Regjistri Qendror, Doganat, dokumentacioni për pjesëmarrje në tenderë dhe institucione të tjera shtetërore). Për shembull: ulje tepër e ndjeshme e çmimit për dhënien e gjendjes aktuale.

Fillestarëve në afarizëm u nevojitet ndihmë për të përmbushur kërkesat rregullatore. Regjistri Qendror i ndërmarrjeve tregtare detyrimisht do t'u lëshojë një „Informator“ me të gjitha të dhënat e rëndësishme për të udhëhequr afarizëm: dokumentet e nevojshme që duhet t'i ketë një ndërmarrje, procedura e regjistrimit të një paguesi të TVSH-së, cilat kushte duhet të plotësojnë në përputhje me kërkesat e inspektimeve, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji i Marrëdhënieve të Punës, mundësitë e ofruara nga shteti për subvencionimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve, mënyrat e hyrjes dhe sigurimin e dokumentacionit për institucionet shtetërore dhe informacione të tjera që do të lehtësojnë punën e ndërmarrjeve.

Qeveria, nëpërmjet dialogut me dhomat ekonomike, do të fillojë procesin e uljes së detyrimeve parafiskale deri në 75% dhe nivelizimin e tyre sipas madhësisë së subjekteve ekonomike. Do të krijojmë një regjistër të shpenzimeve parafiskale që do të përditësohet dhe plotësohet rregullisht, në mënyrë që ndërmarrjet, në çdo kohë, të kenë kontroll dhe do të mundin në mënyrë të përshtatshme t'i planifikojnë aktivitetet e tyre financiare. Për shembull, do ta heqim tarifën e lidhjes së aparatit fiskal me serverat e DHP-së dhe atë të kontrollimit të qarkullimit të kryer nga DHP-ja, do të rregullohet saktësisht servisimi i aparateve fiskale të ndërmarrjeve dhe do të jetë falas për të gjithë subjektet tregtare që përdorin aparate fiskale, afati kohor për ndryshimin e SIM-kartelës së arka fiskale do të rritet nga një në tre vjet, do ta kufizojmë çmimin e kontrolleve sistematike të detyrueshme të punonjësve.

Do të prezantojmë standardet europiane në sigurimin e përgjegjësisë së automjeteve duke e ulur çmimin e kartonit të gjelbër, si prodhim i liberalizimit të çmimit të SA-së dhe zgjidhjes së problemit me automjetet e pasiguruara.

Do të vazhdojmë të përmirësojmë sistemin e mbështetjes për automjetet ekologjike (duke u përqendruar te automjetet elektrike dhe ato me hidrogjen) dhe për automjetet me vlerë më të ulët dhe mesatare duke i hequr ose ulur shpenzimet tatimore dhe jotatimore (të atilla si tatimi i automjeteve, TVSH-ja, dogana, harxhimet e regjistrimit, pagesa rrugore etj ...). Do të përkushtohemi fuqishëm për rregullimin e tregut të automjeteve të përdorura dhe mbrojtjen e konsumatorëve me anë të një sistemi për kontrollimin e cilësisë dhe parametrave të deklaruar të automjetit, si dhe zbatimin e një dispozite ndëshkuese në lidhje me mashtrimet me numrin e kilometrave të automjetit.

Do të zbatojmë një ligj për falimentimin personal si model për mbrojtjen e nevojave të jetesës së debitorit nëpërmjet mosekzekutimit të borxhit të tij në një lartësi të caktuar, parandalimit të huazimeve të reja, por edhe kreditorëve, të cilët do të jenë në gjendje të paguajnë vlerën reale. Me një ligj të tillë nuk do të krijohet një sistem i spirales së borxhit.

Do të publikojmë rregullisht një listë të bardhë të tatimpaguesve, përkatësisht të ndërmarrjeve që i paguajnë rregullisht detyrimet e tyre tatimore. Në Ligjin e Disiplinës Financiare do t'i përfshijmë institucionet shtetërore dhe ato qeveritare dhe do t'i barazojmë me detyrimet e sektorit privat.

Qeveria do të propozojë një Ligj të ri të e-Tregtisë në mënyrë që ta rregullojë afarizmin dhe ta luftojë konkurrencën e pandershme dhe evazionin fiskal. Me këtë ligj duhet të rregullohet në mënyrë të konsiderueshme e-tregti nëpërmjet zbatimit të dispozitave për e- faturën, e-llogarinë fiskale dhe e-pagesën. Ky ligj duhet të sigurojë përfitime të mëdha për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe përfshirjen e tyre në zinxhirët e furnizimit global dhe tregtinë globale.

Qeveria do të propozojë një ligj të veçantë për engjujt afarist dhe ndryshime në Ligjin e Fondeve të Investimeve, me çka në mënyrë të konsiderueshme do t'i pakësojmë kufizimet për krijimin e fondeve të investimeve. Do të mundësojmë krijimin e fondeve hibride të kapitalit të rrezikuar, përkatësisht do të sigurohen fonde në të cilat përveç qeverisë, investitorët institucionalë dhe ato privatë, korporatat, bankat, fondet e pensione dhe engjujt afarist do të jenë në gjendje të paraqiten si investitorë.

Do të subvencionojmë shpenzimet e ndërmarrjeve eksportuese që kanë certifikim TUV dhe CE për prodhimet që marrin pjesë një herë në vjet në një panair në Europë dhe një herë në vjet në një panair në SHBA, Afrikë ose Azi, në shumën prej 50% të shpenzimeve të pjesëmarrjes.

Qeveria do të propozojë një zgjidhje më të mirë institucionale për të mbështetur rritjen e potencialit të zonave zhvillimore. Në të njëjtën kohë, krejtësisht do të zgjidhen të gjitha pengesat procedurale dhe logjistike për funksionimin e zonës zhvillimore të Tetovës, së bashku me terminalin doganor, dhe Qeveria do të ndihmojë zhvillimin e infrastrukturës në zonën industriale të Vizbegut.

Qeveria do ta fillojë procesin e rikapitalizimit të Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut dhe do të sigurojë instrumente të qarta, matëse dhe efektive për financimin e nevojave eksportuese të ndërmarrjeve, përkatësisht financimin e drejtpërdrejtë të eksportit dhe rritjen e vëllimit dhe të konkurrencës së produkteve dhe shërbimeve të Maqedonisë së Veriut.

Për nevojat e luftës kundër konkurrencës së pandershme, me anë të masave të përshtatshme, do të jetë e pamundur të kryhet një aktivitet që nuk është i regjistruar dhe do të harmonizojmë Ligjin e Ndalimit dhe të Pengimit të Kryerjes së Aktivitetit të Paregjistruar me të gjitha ligjet që zbatohen nga inspektoratet. Rezultati do të jetë zvogëlimi dhe eliminimi i ekonomisë gri dhe konkurrencës së pandershme me të cilën përballen ndërmarrjet e regjistruara private, pronarë individualë, individë që i binden ligjit, paguajnë tatime, përmbushin standardet dhe i paraqesin dhe i paguajnë si duhet punonjësit.

Në fushën e turizmit, Qeveria do të sigurojë një sistem për subvencionimin e turizmit alternativ dhe kulturor. Vendet arkeologjike do të përshtaten dhe do të jenë në dispozicion për vizitë nga turistë vendas dhe të huaj. Do të mundësojmë përdorimin e Wi-Fi-së shtetërore falas duke klikuar në një vegëz që do të çojë në anën promovuese të komunës, rajonit, në hyrje të shtetit, në ndalesa ose pompa së benzinës.

Duke e shfryrëzuar kërkesën në rritje për turizmin malor të profilizuar, parashikojmë krijimin e një zyre të veçantë për turizmin malor dhe përmbajtjet malore, e ngarkuar për përcaktimin dhe menaxhimin e investimeve të pritura vendore, publike dhe private dhe investimeve të huaja, zbatimin e një sistemi ndryshimesh në këtë segment dhe pozicionimi i vendit në turizmin e integruar malor rajonal dhe europian. Kjo zyrë do të përqendrohet në zhvillimin e Malit të Sharrit, Mavrovës, Matkës, Pelisterit dhe Galiçicës. Do të fillojmë përgatitjet plotësuese për zhvillimin e turizmit në Majën e Carit në Malet e Osogovës, si një pikë qendrore e turizmit dimëror dhe malor. Qeveria do të shqyrtojë modele të ndryshme për Kodrën e Diellit për zhvillimin e saj si një qendër turistike rajonale me mundësinë e investimeve private ose të partneritetit publiko-privat që do të mundësonte ndërtimin e një teleferiku nga Tetova deri në Kodrën e Diellit. Në të njëjtën kohë, qeveria do të fillojë rindërtimin e shtëpizave ekzistuese malore dhe ndërtimin e shtëpive të reja duke përcaktuar një model menaxhimi dhe investimi në to dhe trasimin dhe promovimin e shtigjeve zyrtare të bjeshkatarisë.

Qeveria do të mbështesë përpunimin e aplikacionit iOS dhe Android për turizmin në MK, të ndarë në sektorë (verë, dimër, bjeshkatari, çiklizëm, kampim, zona arkeologjike, turne vere ...), sipas shembullit të sistemit të informacionit për planifikimin hapësinor.

Qeveria do të nxisë futjen e modeleve inovative në konceptin e turizmit "shëndetësor" dhe "pensional" për pensionistët vendas dhe të huaj, duke ndjekur shembullin e praktikave të suksesshme në destinacionet e zhvilluara turistike. Qeveria do të mbështesë fushatat e reklamimit për të promovuar shtetin si një vend për t'u kënaqur dhe brend i njohur turistik në rritje dhe do t'i nxisë subjektet

ekonomike që financojnë/sponsorizojnë video materiale të prodhuara vendore për të promovimin e shtetit.

Qeveria do të nisë projektin "Yll plus" për subvencione shtetërore në lartësi prej 50% të investimit për kapacitetin e regjistruar hotelierik, që synon të marrë një shkallë më të lartë të kategorizimit të objektit të tij, në të gjitha destinacionet kryesore turistike.

### *Ekonomi inovative*

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të ndjekë një politikë ekonomike që synon zhvillimin e inovacionit dhe investimeve në zhvillimin teknologjik si një mundësi të transformimit të dëshiruar të ekonomisë. Një ekonomi e këtillë krijon më shumë vlerë të shtuar, i zhvillon burime njerëzore dhe siguron produktivitet dhe rroga më të larta.

Deri në fund të vitit 2020 do të përfundojë procesi i analizës dhe i rekomandimeve për forcimin e mëtejshëm të Fondit të Inovacionit dhe të Zhvillimit Teknologjik, transformimin e tij dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së mekanizmave mbështetës dhe rezultateve afatmesme dhe afatgjata. Ky proces zbatohet me mbështetjen e Bankës Botërore dhe Mbretërisë së Bashkuar. Me këtë proces do të mundësohet hyrja e mjeteve të investimeve të huaja si partnerë strategjikë të Fondit në mbështetje të rritjes ekonomike, bazuar në inovacionin dhe futjen e teknologjive të reja. Me të dy proceset, shteti si një investitor i përhershëm dhe i ardhshëm do të ketë një kthim të drejtpërdrejtë të investimit (në përputhje me politikën dhe masat e veta), ndërsa mundëson zbatimin e politikave të tjera të zhvillimit (mbështetja dhe zhvillimi i talentëve, nxitja e hulumtimit dhe e zhvillimit ...).

Qeveria fuqimisht do të realizojë projektin që Maqedonia e Veriut të bëhet përsheptues rajonal për start up, me çka do të bëhemi qendër e zhvillimit të afarizmave të reja për sipërmarrësit e rinj, me potencial për rritje të shpejtë. Me zbatimin e përsheptuesit rajonal, brenda gjashtë muajve nga shpallja e thirrjes së parë, fushëveprimi i aplikantëve do të zgjerohet në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, kriteret e përshtatshme të aplikimit do të nxisin lidhjen e ideve të afarizmit nga disa vende në rajon, dhe kështu edhe zgjerojnë tregun "fillestar" nga dy në 17 milionë konsumatorë. Si model për zbatimin e programit dhe përcjelljen e projekteve do të përdoret ai ekzistues i mbështetjes së start up-ëve dhe përsheptuesve, i zhvilluar dhe i pilotuar në dy vitet e fundit në Maqedoninë e Veriut.

Qeveria do të vazhdojë të investojë në parkun shkencor-teknologjik që filloi të operojë në mars të vitit 2019, duke synuar që ai të ishte plotësisht funksional në vitin 2025. Vlera e parashikuar e investimeve në infrastrukturën fizike, sipas Studimit të Fizibilitetit të përgatitur nga ekspertët e KE-së, realizuar për nevojat e Fondit, është rreth 80 milion euro. Në të tashmë janë pilotuar programet e digjitalizimit të shoqërisë dhe të transferimit të teknologjive. Veçmë është përgatitur një projekt paraprak për një hapësirë të re për ndërmarrjet start-up, që duhet të realizohet në vitin 2020.

Në "fshatin maqedonas" të dikurshëm (pronë e shtetit) Qeveria do të krijojë një "fshat start up" (Start-up Village) që do të ofrojë një mundësi për shumë të rinj, nga vendi dhe jashtë, për të filluar një afarizëm pa pasur nevojë të paguajnë shpenzimet e përgjithshme. E njëjta përvojë do të zbatohet në pesë qytete, me mundësi për të bashkëpunuar në lokacione të veçanta shtetërore.

Qeveria do të iniciojë projektin për Qendrën Rajonale të Kërkimeve dhe të Diagnostikës në Mjekësi, që do të mundësojë hyrjen e teknologjisë së re, të njohurive dhe shfrytëzimin e plotë të potencialit ekzistues njerëzor në fushën e kërkimit dhe diagnostikimit në mjekësi. Është duke u analizuar mundësia që një prej elementeve të përqendrohet në mjekësinë kardiovaskulare. Projekti do të realizohet deri në vitin 2024 nëpërmjet partneritetit publiko-privat, ndërkaq aktivitetet përgatitore janë duke u zhvilluar për planifikimin hapësinor dhe sigurimin e dokumenteve të nevojshme të planifikimit urban. Për realizimin e kësaj dhe të aktiviteteve tjera në fushën e mjekësisë, Fondi dhe Ministria e Shëndetësisë tashmë kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me shtetin e Izraelit. Vlera e parashikuar e investimit është 20-25 milionë euro.

Brenda 12 muajve, Qeveria do të krijojë një sistem të granteve për veprimtari hulumtuese, që do të përfshijë institucionet e arsimit të lartë dhe angazhimin e tyre në mbështetje të rritjes së përshtetshme të bazuar në inovacione.

Ne nuk ndalemi vetëm në modelet e përmendura inovative për transformimin dhe zhvillimin e ekonomisë. Na duhet një model i vazhdueshëm i inovacioneve të hapura, madje edhe në sektorin publik. Ne jemi plotësisht të përkushtuar që, me përvojën e jashtme dhe të vendit, të krijojmë modele të reja plotësuese për funksionimin e proceseve kryesore. Qëllimi është ofrimi i cilësisë më të mirë dhe realizimi i shpenzimeve publike dhe të investimeve kapitale, pikërisht duke zbatuar modele të reja (inovative) të punës në institucione (siç u përmend më lart).

### *Ne investojmë në qytetarët tanë*

Në mandatin e kaluar, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut tregoi se rrogat më të larta nënkuptojnë punëtorë më të kënaqur dhe rritje të prodhimtarisë. Edhe këtë mandat do të vazhdojmë me të njëjtën politikë. Rritja dhe zhvillimi kërkon njohuri dhe punëtorë të kënaqur, të cilët do të shpërblehen dhe vlerësohen mjaft për vlerën që krijojnë në shtetin tonë.

Politika e Qeverisë në këtë mandat do të jetë që paralelisht të vazhdojë të ulë papunësinë dhe të nxisë rritjen e rrogave, siç është përshkruar më sipër.

Qëllimi i Qeverisë do të jetë të ketë sukses në uljen e papunësisë me 3% në vit. Gjatë krizës së shkaktuar nga Covid do të luftojmë për çdo vend punë, siç e dëshmuam gjatë valës së parë. Këtë do ta bëjmë nëpërmjet:

- Sigurimit të dy miliardë denarëve çdo vit për masat aktive të mbështetjes së punësimit dhe vetëpunësimit
- Përkrahjes së sektorëve më të prekur nga kriza e shkaktuar nga epidemia me anë të mbështetjes për ruajtjen e vendeve të punës
- Vazhdimin të subvencionimit të kontributeve për ndërmarrjet që do të rrisin rrogat e punëtorëve të tyre nga 600 në 6000 denarë
- Do të rregullohet puna sezonale, në mënyrë që të rritet periudha e punës sezonale, si dhe një liri më e madhe kontraktuale, pra mundësi që punëdhënësi të paguajë kontribute ose kompensim për punëtorët sezonalë në periudhën jo-sezonale.
- Do të krijojmë një sistem kuponi për pagesën e kontributeve sociale për punëtorët sezonalë, me çka drejtpërdrejtë do të ndikojmë në uljen e ekonomisë gri dhe mbrojtjen e atyre “punonjësve të padukshëm” që bëjnë punë dhe që nuk mund të realizojnë ndonjë përfitim, e as mbrojtje ligjore
- Do të shfuqizohet mundësia e punës pas moshës 64 vjeçare në sektorin publik, përveç personelit deficitar (siç janë punonjësit shëndetësorë dhe ata arsimor universitar). Në këtë mënyrë do të ketë më shumë mundësi për të rinjtë për të punuar në sektorin publik, por edhe do të zvogëlohet administrata në departamentet ku nuk ka nevojë për ta ruajtur vendin e punës
- Do ta ofrojmë konceptin e orarit fleksibil të punës për të premtën dhe mundësinë për të zvogëluar numrin e orëve të punës gjatë javës në mënyrë që të sigurojmë një barashpeshë më të madh midis jetës profesionale dhe asaj familjare.

Krijimi i politikave të përshtatshme ekonomike dhe sociale kërkon një pasqyrë të plotë dhe të qartë të kushteve specifike ekonomike dhe sociale në nivelin shtetëror dhe vendor. Për këtë qëllim, është thelbësore që të bëhet një regjistrim i popullsisë sa më shpejt të jetë e mundur. Përqëndrimi kryesor duhet të jetë në të dhënat socio-ekonomike që mungojnë, ndërkaq besimi në procesin dhe rezultatet do të ndërtohet nëpërmjet përfaqësimit të drejtë të të gjitha bashkësive etnike në procesin e regjistrimit.

Në këtë fushë, detyra kryesore e kësaj qeverie do të jetë rikthimi i besimit të të rinjve në një të ardhme të besueshme dhe të sigurt në vendin tonë, dhe për këtë arsye ne do të ndjekim politika të synuara për të rritur punësimin e tyre:

- Vazhdimi i pagesës prej 3000 denarë në muaj shtesa rinore për të rinjë të punësuar deri në 23 vjet me të paktën arsim të mesëm të përfunduar të cilët janë duke punuar në prodhimtari
- Kthim i tatimit mbi të ardhurat personale për të gjithë punonjësit e rinj nën 30 vjeç, në dy vitet e para me çka mjetet do të kthehen drejtpërdrejt në llogarinë e tyre
- Lirimi nga tatimet për të gjitha ndërmarrjet private të sapo krijuara, të themeluara nga të rinjë deri në 30 vjet ose gra, për sa kohë që qarkullimi është nën 3 milionë denarë
- Mbështetje e drejtpërdrejtë e sipërmarrjes së të rinjve dhe grave me anë të granteve në vlerë prej 5000 deri në 15000 euro për fillimin e afarizmit të tyre të ri
- Do të krijohet një Fond të Intelektualëve të Rinj me të cilin do të thërrasim në përfshirjen e të rinjve që janë larguar nga vendi dhe janë dëshmuar dhe kanë arritur rezultate në shkencë, afarizëm dhe fusha të tjera. Ata do të angazhohen si mentorë të fëmijëve dhe të rinjve në vendlindje
- Ligji për sigurimin e të rinjve, që do të institucionalizojë këtë formë të mbështetjes për të rinjtë deri në punësimin e tyre
- Krijimi i një fondi bursash për të rinjtë, për nevojat e zejtarisë
- Mësim i përforcuar praktik në shkollat e mesme profesionale nëpërmjet modeleve të bashkëpunimit me shoqatat e dhomave ekonomike dhe të vetëqeverisjes lokale, si dhe garave rinore për sipërmarrësi
- Bashkëpunimi i të ashtuquajturve triple helix (spiralja e trefishtë), ku universitetet, komuniteti i afarizmit dhe qeveria së bashku përgatisin kurrikula që do të jenë një përgjigje reale ndaj nevojave dhe kërkesave të tregut të punës
- Ligj të Mbështetjes së Sipërmarrjes Sociale, duke u përqëndruar te të rinjtë dhe gratë, dhe hapja e tre qendrave për mbështetjen e ndërmarrjeve sociale
- Ofrimi i mundësisë për studentët e rregullt që të mund të punësohen me orar të plotë, me një numër të caktuar orësh - një mundësi që studentët e numrit më të madh të vendeve europiane e kanë në dispozicion.

### *Transporti i sigurt*

Zhvillimi ekonomik, stabiliteti dhe komunikimi me vendet e rajonit dhe Europën varen drejtpërdrejt nga infrastruktura e transportit. Rrugë të shpejta dhe të sigurt, si dhe koha më e shkurtër e transportit janë elementet kryesore për një infrastrukturë moderne të një vendi, e me këtë edhe qytetarë të kënaqur.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të zbatojë strategjinë dhjetëvjeçare të zhvillimit të infrastrukturës rrugore, modernizimin dhe sigurinë nëpërmjet investimeve të mëdhaja në vlerë prej dy miliardë eurosh shtesë.

Gjatë këtij afati, do të fillojmë ose përfundojmë ndërtimin e rrugëve të mëposhtme:

- Autostrada me gjatësi prej 260 km, si më poshtë: Kërçovë - Ohër (në ndërtim e sipër), Shkup - Bllacë (në ndërtim e sipër), Veles - Prilep - Manastir (fillojmë me përgatitjen e dokumentacionit të projektit), Strugë - Trebenishtë, Strugë - Qafë Thanë, Gostivar - Kërçovë dhe Tetovë - Gostivar (zgjerimi i sektorit ekzistues)
- Rrugë të shpejta dhe rajonale në gjatësi prej 300 km, si më poshtë: Smokvicë - Strumicë - Novo Selë, qarkorja Manastir - Mexhitlija, Shtip - Radovish (në ndërtim e sipër), Burim-Ura e Boshkos, rruga e shpejtë Shtip - Koçan (seksioni i parë Shtip - Krupishtë e lëshojmë në përdorim, vazhdojmë me seksionin Krupishtë - Koçan që është në ndërtim e sipër, Kumanovë - Kriva Pallankë, seksioni Kumanovë - Rankovcë dhe seksioni Rankovcë - Kriva Pallankë (në ndërtim e sipër), Dellçevë - Koçan, Gradsko - Prilep (në ndërtim) dhe unaza e Tetovës (kryqëzimi Trebosh-Poroj-Neproshten). Për rrugën Tetovë-Prizren bazuar në një studim të fizibilitetit, së bashku me anën e Kosovës do të analizojmë se cila zgjidhje është ekonomisht e arsyetueshme.

- Rrugë lokale në gjatësi prej 950 km: Qeveria do të vazhdojë investimet me anë të të cilave në tre vitet e fundit punuam në ndërtimin e rrugëve lokale në të gjithë vendin në mënyrë që të përmirësojmë kushtet e jetesës. Ky program tashmë ka siguruar fonde për rehabilitimin e mbi 450 km rrugëve lokale dhe udhëve, që do të sigurojnë qasje më të lehtë dhe të sigurt të qytetarëve në spitale, shkolla, mjedise sportive, qendra kulturore dhe fetare dhe mjedise të tjera me interes publik dhe shoqëror. Secila komunë, nga shuma totale prej 70 milionë euro, do të ketë në dispozicion fondet e saj në vlerë prej 500,000 euro deri në një shumën maksimale prej 1,600,000 euro për ndërtimin dhe sanimin e rrugëve lokale dhe rrugëve tjera. Me marrëveshje me Bankën Botërore, një pjesë e këtyre mjete u shfrytëzuan për ballafaqimin me pandeminë, ndërkaq qeveria do të sigurojë mjete shtesë për 500 km të tjera rrugë lokale.
- Rehabilitimi i rrugëve në gjatësi prej 1500 km: Katllanovë - Petrovec, Hipodrom - Petrovec, Milladinovc - Petrovec, Milladinovc - Hipodrom, Shkup - Bllacë, Katllanovë - Veles, Veles - Gradsko - Negotinë - Demir Kapi, Manastir - Demir Hisar, Krushevë - Demir Hisar, Drugovë - Demir Hisar, Krivogashtan - Krushevë, Krushevë – Kumbull – Lumi i Shkretë, Manastir dhe kalimi kufitar me Greqinë, Gryka e Farishkës - Prilep, Karpallak - Zhelinë, Misllodezhdë - Zbrazhdi, Podmolë - Strugë – Shën Naum, Ohër - Shën Naum, Kërçovë - Makedonski Brod, Anet e Mavrovës - Zhirovnice, Nikiforovë - Leunovë - Bunec, Uzem - Toranicë, Makedonska Kamenicë - Sasa, Kumanovë - Stracin, Koçan - Ponikvë, Strumicë - Berovë, Shën Nikollë - Neokazi, Kondovë - Radushë, Gjergjeli - Bogdanci, autostrada Tabanoc - kryqëzimi T, autostrada Karpallak - Zhelinë.

Paralelisht me këtë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të investojë në ndërtimin e urave, por edhe në rregullimin e pikave të zeza dhe investime të përgjithshme në rritjen e sigurisë së trafikut në rrugët tona. Do të fillohet me ndërtimin e një sistemi inteligjent të transportit (SIT) në Korridorin 10. Sistemi ofron kontroll dhe informacion në rast të motit, bllokimeve të rrugëve, matjes së dendësisë së trafikut dhe peshës së automjeteve të rënda, kontroll mbi transportin e mallrave të rrezikshme etj.

Qeveria do të krijojë infrastrukturë që do të përcjellë dhe përmirësojë sistemin e sigurisë rrugore.

Përqëndrim i veçantë do të vendoset në rinovimin dhe zgjerimin e dy vendkalimeve kufitare Qafë Thanë dhe Deve Bair, të cilat do të përmirësojnë kushtet e punës në objektet administrative, do të lehtësojnë formalitetet doganore dhe do të lejojnë qarkullimin më të shpejtë të njerëzve dhe mallrave. Deri në fund të vitit 2020 do të bëhet studimi për zhvillimin e ardhshëm dhe zgjerimin e kapaciteteve në pikat kufitare, me rekomandime konkrete për investime në të ardhmen dhe mundësi për kalime të përbashkëta kufitare. Në atë drejtim, do të analizojmë zgjerimin e mundshëm të kapaciteteve në vendkalimin kufitar Jazhincë së bashku me rrugën Tetovë-Jazhincë dhe hapjen e vendkalimit kufitar Llojan-Miratocë.

Qeveria do të angazhohet në përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet investimeve të mëtejshme në ndërtimin e hekurudhës Kumanovë - Bellakoc - Kriva Pallankë - Deve Bair, vazhdimi i riparimit të Nogaevc - Negotinë, stacioni i përbashkët kufitar hekurudhor Tabanoc, përgatitja e një dokumenti teknik të projektit hekurudha Shkup - Shkup Veri - Gjorçe Petrov - Vollkovë - Bllacë dhe kalimi i përbashkët kufitar hekurudhor me Republikën e Kosovës dhe për një hekurudhë të re Milladinovc - aeroport - Petrovec, përgatitja e dokumentacionit të plotë teknik Kërçovë – Ohër - Strugë dhe Kërçovë deri në Lin, Shqipëri, përgatitja e dokumentacionit teknik të projektit për rindërtimin, rehabilitimin e hekurudhës Shkup - Kërçovë si pjesë e Korridorit 8, përgatitjen e një projekti pilot për pjesën Zelenikovë - Draçevë - Lisiçe - Pintija - 11 Tetori – Shkup Patniçka.

Në fushën e transportit ajror, qeveria do të krijojë një strategji të re, funksionale dhe të qëndrueshme nacionale për zhvillimin e saj. Pas përfundimit të krizës Covid, do të lëshohen destinacione të reja për të rritur numrin e fluturimeve dhe të pasagjerëve, nivelin e sigurisë dhe për të mundësuar një

sistem të transportit ajror efikas, të rregullt, të sigurt dhe të qëndrueshëm ekologjik, të disponueshëm me kushte të barabarta për të gjithë.

#### *Përpilimi i planit*

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të punojë në zgjidhje të reja ligjore në sektorin e ndërtimit për të harmonizuar plotësisht ligjet sistemore që rregullojnë fushën e ndërtimit dhe planifikimit urban. Do të synohet që procedurat të bëhen më transparente për qytetarët, dhe në të njëjtën kohë ta mbrojmë dhe përmirësojmë mjedisin jetësor dhe natyrën. Në të njëjtën kohë, ne do të forcojmë inspektimet, kompetencat e Inspektoratit Shtetëror të Ndërtimit dhe të Urbanizimit nëpërmjet zbatimit të inspektoreve rajonale urbane.

Për të forcuar cilësinë e ndërtimit të financuar nga shteti dhe për të siguruar integritet më të madh në tenderët e ndërtimit dhe realizimin e tyre, do të zbatojmë implementim të centralizuar të përzgjedhjes së ndërmarrjeve për mbikëqyrjen e projekteve të ndërtimit. Pastaj, për çdo projekt, mbikëqyrësi do të caktohet rastësisht, me çka që do të pamundësohen lidhjet midis ndërmarrjeve të ndërtimit dhe mbikëqyrësit, që gjithmonë janë në dëm të shtetit dhe të qytetarëve.

Qeveria në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale do të vazhdojë të zbatojë politikat e planifikimit njerëzor dhe rregullimit hapësinor nëpërmjet planeve të veprimit dhe zbatimit të programit vjetor të planifikimit hapësinor për vendbanimet që nuk kanë përgatitur dokumentacionin urban, që do të sigurojë zhvillim demografik afatgjatë, ekonomik, social dhe të qëndrueshëm të vendbanimeve. Ne jemi duke u përqendruar në ndërtimin e 500 km-ve ujësjellës dhe kanalizim, për çka do të sigurojmë 100 milion euro për të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sigurisht, një nga përparësitë kryesore mbetet ndërtimi i stacioneve të trajtimit të ujërave të zeza. Këto projekte kontribuojnë në një jetë normale këtu në vend, por gjithashtu kontribuojnë në një mjedis më të pastër dhe të shëndetshëm. Do të kërkojmë, para se gjithash nga vetëqeverisjet lokale, të aplikojnë me projektet e tyre prioritare në fushën e infrastrukturës komunale. Vetëm në këtë mënyrë do të kontribuojmë në zhvillimin e zonave të qëndrueshme rurale që po zhvillohen në drejtimin e duhur.

Qëllimi ynë është të përmirësojmë kushtet e jetesës dhe të rrisim standardin e jetesës së të gjithë qytetarëve. Jemi përqendruar maksimalisht në përmirësimin e infrastrukturës komunale nëpërmjet ndërtimit të ujësjellësit, kanalizimeve dhe stacioneve të trajtimit, si dhe rindërtimin e rrjetit ekzistues komunal. Duke investuar në infrastrukturën komunale, jo vetëm që do të sigurojmë një jetë më të mirë për qytetarët, në zonat industriale do të sigurojmë kushte më të mira të punës për ndërmarrjet, do ta mbrojmë mjedisin dhe do të kontribuojmë për një jetë të shëndetshme dhe një mjedis më të shëndetshëm.

#### *Politika bujqësore*

Bujqësia është sektori i dytë më i madh në vend për nga të ardhurat nacionale bruto (PBB). Bujqësia është thelbësore për zhvillimin e të gjithë ekonomisë, zhvillimin e baraspeshuar rajonal dhe ruajtjen e zonave rurale në një gjendje vitale, duke krijuar kushte për popullatën e re për të qëndruar në to.

Bujqësia dhe prodhimi i ushqimit janë mundësia jonë për sukses. Pandemia e virusit COVID-19 edhe më shumë e theksoi nevojën që popullatës t'i sigurohet ushqim i shëndetshëm, i sigurt, cilësor dhe i llojllojshëm nga prodhimi vendas. Duke siguruar sasi të mjaftueshme të ushqimit cilësor dhe të sigurt për nevojat e konsumatorëve vendas dhe duke krijuar prodhime me vlerë të shtuar dhe eksport në tregjet e huaja, sigurohet një standard më i mirë jetese për bujkun, dhe kështu edhe për të gjithë shoqërinë.

Qëllimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut janë: duke krijuar kushte për bujqësi të qëndrueshme dhe modernizimin e saj në prodhimin parësor dhe dytësor për të rritur prodhimin dhe

për të rritur cilësinë e prodhimeve bujqësore të vendit, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë e ushqimit dhe mirëqenien e kafshëve, përkatësisht krijimin e konkurrencës dhe të vlerës së shtuar të prodhimeve bujqësore, dhe në të njëjtën kohë për të siguruar kënaqësinë e nevojave të tyre të prodhimit vendas. Nëpërmjet arritjas së konkurrencës së prodhimeve bujqësore do të sigurohet domosdoshmërisht një jetë dinjitoze për bujqit dhe zhvillim i zonave rurale.

Do të përgatisim dhe përshtatim bujqësinë tonë ndaj ndryshimeve globale të klimës me anë të investimeve dhe masave inovative që do të ndikojnë pozitivisht në llojin dhe cilësinë e prodhimeve bujqësore. Për të arritur këto qëllime, bujqit duhet të jenë në gjendje të shtojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre, por edhe institucionet të përforcojnë kapacitetet e tyre. Nëpërmjet politikës së zhvillimit rural do të ndikohet në përmirësimin e mirëqenies së popullsisë rurale dhe do të sigurohen kushte që të rinjtë të qëndrojnë dhe të jetojnë në fshatra.

Politikat në sektorin e bujqësisë do të jenë në përputhje me detyrimet e përgjithshme dhe udhëzimet e vendit për përshtatjen me politikën e përbashkët bujqësore të BE-së. Prandaj, politikat në sektor do të drejtohen në aftësimin e sektorit që të funksionojë në kushtet e tregut të vetëm europian, duke mos i shpërfillur nevojat dhe prirjet e tregut të brendshëm dhe e tregjeve në kornizat globale. Përqëndrimi i politikave do të zhvendoset në fermat tregtare familjare që do të jenë në gjendje të specializohen në prodhime bujqësore me cilësi të lartë, prodhime organike dhe tradicionale. Për këtë qëllim, shteti do të nxisë konsolidimin e patundshmërive të vogla, do të caktojë tokën shtetërore për prodhuesit e vërtetë në masën që ata mund ta përdorin në mënyrë më racionale, do të mbështesë investimet në modernizimin e bujqësisë dhe investimet në prodhimin inovativ bujqësor.

Aktivitetet e zhvillimit të bujqësisë do të përqendrohen në trajnimin e tij për marrëdhënie konkurruese, dhe kjo arrihet vetëm me prodhime të cilësisë së lartë dhe të sigurt, dhe me çmim konkurrues.

Si një mbështetje e drejtpërdrejtë për krijimin e sistemit të PRODHIMIT BUJQËSOR TË QËNDRUESHËM DHE KONKURUES, parashikojmë aktivitetet dhe masat e mëposhtme:

- Mbështetje financiare vjetore prej 200 milionë euro për bujqësi dhe zhvillim rural;  
Mbështetje financiare vjetore prej 200 milionë euro për politikën agrare që synon krijimin e kushteve për qëndrueshmërinë e fermave bujqësore që do të përpiqen të rrisin prodhimin, cilësinë e prodhimit, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë e ushqimit, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe për bujqësinë moderne dhe konkurruese dhe prodhimet me vlerë të shtuar.
- Pagesa në kohë e mbështetjes së drejtpërdrejtë në bujqësi: 30% e lartësisë së masave themelore 30 ditë pas aplikimit dhe 70% sipas kalendarit të pagesave.  
Pagesa e mjeteve financiare në kohën kur ju nevojiten është mbështetje e drejtpërdrejtë për bujqësinë. Nga vitin 2021 do të fillojmë me pagesën e 30% të shumës së masave themelore 30 ditë pas aplikimit. Pjesa tjetër e mjeteve, për një masë të caktuar, do të realizohet pas kontrollit të kryer, sipas një dinamike të caktuar dhe kalendarit të pagesës. Kalendarin do ta rregullojmë me ligj, që bujqit të dinë saktësisht se kur mund të presin mjete financiare.
- Rritja e subvencionit të "Naftës së gjelbër"  
Ulja e shpenzimeve të prodhimit për të përmirësuar konkurrencën e prodhimeve bujqësore. Në periudhën e ardhshme. Në periudhën e ardhshme do të vazhdojmë të zbatojmë këtë masë, duke e rritur subvencionimin e shpenzimeve të furnizimit me karburant për makineritë bujqësore çdo vit, në mënyrë që të subvencionohen 100% deri në fund të vitit 2024.
- Rritje e mbështetjes së pagesave të drejtpërdrejta për krerë lopësh, delesh, dhishë, dosash, kafshësh thithëse, zogj pulash, sqkash, zogjsh njëditorë, familje bletësh dimëruese, me 10% të atyre ekzistues.
- Rritja e mbështetjes për qumështin e prodhuar dhe të ofruar të lopës me cilësi më të mirë për dy denarë për litër
- Investimi në krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të integruar për kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së qumështit të papërpunuar

- Kthimi i bashkësive të vjetra të ekonomisë së ujit
- Vazhdimi i procesit të konsolidimit të tokës bujqësore
- Mbështetje për mirëmbajtjen e plantacioneve afatgjate
- Krijimi i një fondi ndërhyrës në programin e pagesave të drejtpërdrejta
- Nxitja i trashjes së mëshqerrave dhjamore mbi 500 kg.
- Kthimi i tatimit mbi të ardhurat personale për bujqit
- Ulja e tatimit mbi vlerën e shtuar për shërbimet veterinarë nga 18% në 5%
- Nxitja e zbatimit të masave agro-ekologjike

Të vetëdijshëm për nevojën e rritjes së ndjeshme të sasisë, qëllimin dhe efektivitetin e INVESTIMEVE në prodhimin bujqësor, i planifikojmë masat e mëposhtme:

- Mbështetje për furnizimin me makineri moderne, pajisje dhe paketim
- Fond garantues për kreditim dhe financim të projekteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural, së bashku me ofrimin e shërbimeve këshilluese brenda fondit
- Mbështetje për ndërtimin e depove ftohëse, kapacitete të përpunimit, qendrave të blerjes dhe të shpërndarjes
- Mbështetje për ngritjen e plantacioneve afatgjatë
- Mbështetje në furnizimin me material gjenetik të cilësi të lartë
- Mbështetje financiare për lopët qumështore nën kontrollin e veçorive të prodhimit
- Dhënia e kullosave me qira afatgjatë
- Investimi në infrastrukturën e kullosave
- Investimet në partneritetin publiko-privat në sektorin e bujqësisë
- Investimi në ndërtimin e digave dhe sistemeve të furnizimit me ujë
- Investimi në pyllëzim
- Investime në mekanizimin e ri pyjor

Për realizimin e politikave dhe aktiviteteve dhe për arritjen e prodhimit bujqësor të qëndrueshëm, fitimprurës, konkurrues, modern dhe inovativ, për herë të parë në historinë tonë do të rrisim rrënjësisht investimet në një nga segmentet më të rëndësishme, KAPITALIN NJERZOR, nëpërmjet masave të mëposhtme:

- Mbështetje për bujqit e rinj: Do të fillojmë me zbatimin e masës së ripërritjes në sektorin e bujqësisë duke krijuar kushte për motivimin e bujqëve të rinjë deri në 40 vjet për të qëndruar në prodhimin bujqësor (deri në 20,000 euro grante). Për të përmirësuar strukturën e moshës, për të ndaluar procesin e plakjes dhe ripërtëritjen e brezave, do të ofrojmë ndihmë për bujqit e rinj duke: alokuar tokë bujqësore për bujq të rinjë që kanë afarizëm bujqësor, alokimin e fondeve për të filluar një aktivitet bujqësor, rritjen e shumës së subvencioneve themelore, Subvencionimi i rrogës (nga 3000 denarë) i një të sapo punësuar bujqësor në ekonominë bujqësore në moshën nën 25 vjeçare.
- Mbështetje për bujkeshat - themeli i fermave familjare: planifikojmë të dyfishojmë mbështetjen për bujkeshat, deri në fund të vitit 2024.
- Përforsimi kadrovik dhe financiar i sistemit këshillëdhënës shtetëror: Me alokimin e një buxheti më të madh për sistemin këshillëdhënës, do të rrisim mundësinë për të forcuar potencialin njerëzor duke punësuar kuadër të arsimuar, i cili do të përfshihet drejtpërdrejt në zgjidhjen e problemeve në prodhimin bujqësor.
- Përveç kësaj, bujqve do t'u ofrojmë edukime të ndryshme falas për aplikimin e teknologjive moderne të prodhimit, bursa për fëmijët e bujqve të regjistruar në arsimim në profesionet bujqësore, trajnim falas të bujqve për përdorim më efikas të fondeve IPARD dhe programeve nacionale të mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimin rural, si dhe vizita shëndetësore veterinarë falas, edukimin dhe kontrollimin e kafshëve në ferma.

Një prodhim bujqësor i qëndrueshëm, fitimprurës, modern dhe inovativ mund të arrihet mbi të gjitha me POLITIKË të rregullt për UDHËHEQJE të duhur të VENDIT. Për këtë qëllim, qeveria do të zbatojë aktivitetet dhe masat e mëposhtme:

- Shitja e tokës bujqësore shtetërore për prodhim më të madh të ushqimit
- Kufizimi i madhësisë së tokës bujqësore gjatë marrjes me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit
- Alokimi i tokës bujqësore shtetërore për blegtorët
- Zonat bujqësore deri në 3 ha për t'u menaxhuar nga komunat
- Thjeshtimi i procedurës për legalizimin e fermave blegtorale

Për të mundësuar nxitjen e investimeve dhe zhvillimin më të shpejtë ekonomik të MJEDISIT RURAL për të përmirësuar mirëqenien e popullsisë në vendet rurale, për të krijuar dhe zhvilluar "fshatra të zgjuar" dhe për të siguruar kushte që të rinjtë të qëndrojnë të jetojnë dhe të punojnë në to, ne do të marrim masat e mëposhtme:

- Shpërndarja e buxhetit nacional për pagesa të drejtpërdrejta në bujqësi dhe zhvillim rural në raport prej 65:35
- Mbështetje prej 10,000 euro për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në zonat rurale.
- Investimet në infrastrukturën rurale

Për bujqësi zhvillimore, ulje të shpenzimeve të prodhimit, konkurrencë më të mirë, cilësi dhe prodhime të sigurta bujqësore, e dimë se duhet të zbatohen praktikatat më të mira të sistemeve të zhvilluara agro-ekonomike për të cilat përqendrohemi në mënyrë të veçantë në mbështetjen e sistemit të INOVACIONEVE në BUJQSI. Prandaj, në programin tone i planifikojmë masat e mëposhtme:

- Investimi në instalimin e panelëve diellorë të prodhimit të rrymës elektrike për përdorim në ujitje të zonave bujqësore
- Investimi në nxitjen e prodhimit vendor cilësor të farës dhe të materialit mbjellës dhe zhvillimin e potencialit për prodhimtari cilësor
- Investime inovative në ballafaqimin e ndryshimeve klimatike
- Investimi në zbatimin e një sistemi të vëzhgimit dhe të parashikimit të shëndetit të bimëve
- Investimi në aplikimin e një sistemi elektronik të përcjelljes së masës së drurit

Plani ynë për transformim bujqësor nënkupton që çdo prodhues bujqësor duhet të shesë prodhimin e tij me çmimet më të favorshme në treg. Për këtë qëllim, ofrojmë një sërë masash MARKETINGU dhe të SHITJES së prodhimeve bujqësore të vendit. Që të sigurojmë çmime të drejta dhe korrekte në tregun e prodhimeve bujqësore, aktivitetet tona i drejtojmë kah:

- Nxitja e prodhimit të kontraktuar
- Përcaktimi i çmimit prodhues të produkteve bujqësore individuale.
- Mbështetje në marrjen e çertifikatës GlobalGAP
- Mbështetje e shfaqjeve në panairë ndërkombëtare dhe manifestime vendore.
- Ulja e shpenzimeve dhe e kohës së kërkuar në procedurën e hedhjes në qarkullim të ushqimit me pretendime shëndetësore, ushqime për qëllime të veçanta dhe shtesa ushqimore.
- Nxitja i konsumit të frutave dhe të perimeve të freskëta nga prodhimi vendor
- Nxitja i prodhimit të kulturave të reja bujqësore
- Nxitja i prodhimit të produkteve tradicionale dhe produkteve me origjinë të mbrojtur gjeografike
- Ruajtja e statusit të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve për eksportin dhe tregtinë e papenguar të kafshëve dhe produkteve të tyre
- Vendosja e një sistemi për mbledhjen e prodhimeve nus, me origjinë shtazore, lidhur me masat tona në energjetikë dhe ekologji (modeli i ekonomisë rrethore) dhe nxitja e dhurimit të ushqimit të tepërt.

## **Bashkë do ta mundim COVID-19**

Pandemia COVID-19 ishte testi më serioz për sistemin tonë shëndetësor. Në kushtet e krizës më të rëndë botërore, kemi treguar se si të punojmë dhe si të krijojmë besim të madh të qytetarët te punonjësit dhe te sistemi shëndetësor. Më shumë se 80% e të gjithë qytetarëve ishin të kënaqur me mënyrën e menaxhimit të kësaj krize - një rezultat që askush nuk e ka vërejtur që nga pavarësia jonë.

Deri sa disa bënin shaka me virusin dhe e nënvlerësuan rrezikun, ne ishim ndër vendet e para në rajon dhe Europë që zbatuam masa parandaluese para rastit të parë të raportuar (kamera termike, termometra pa kontakt, dhoma izolimi dhe kontrolli në aeroporte dhe vendkalime kufitare, vetizolim i detyrueshëm për udhëtarët që vijnë në vendin tonë, SMS për të gjithë ata që vijnë në vend me telefon nga QSHP-ja në rast të simptomave).

Qytetarët ishin në radhë të parë gjatë marrjes së të gjitha masave. I respektoam njohuritë dhe përvojën e ekspertëve dhe kjo na drejtoi në vendime të sakta dhe të arsyeshme. Qytetarët informoheshin rregullisht, saktë dhe në kohë nëpërmjet konferencave të përditshme të shtypit. Gjithmonë jemi përpjekur ekskluzivisht të themi të vërtetën dhe të jemi të parët që të informojmë. Ishte mënyra e vetme për të parandaluar përhapjen e keqinformimit për të shkaktuar frikë dhe panik në mesin e popullatës.

Vetëm duke iu përmbajtur të gjitha masave dhe rekomandimeve mund ta mbajmë nën kontroll epideminë. Por ne mund ta mbajmë këtë vetëm nëse të gjithë qytetarët i respektojnë masat, dhe institucionet i zbatojnë kontrollet. Përndryshe, rrezikojmë që numri i pacientëve të të rritet përsëri, rrezikojmë që t'i rivendosim masat kufizuese. Kjo është e keqe për ekonominë, për vendet e punës dhe natyrisht për shëndetin.

Virusi Korona nuk do të zhduket dhe do të jetë i pranishëm derisa të ndërtojmë imunitet kolektiv nëpërmjet vaksinës e cila nuk pritet para vitit 2021. Kjo do të thotë se të gjithë duhet të mësohemi të ndjekim masat e mbrojtjes personale dhe të jetojmë me virusin. Ne duhet të kryejmë të gjitha përgjegjësitë tona ditore duke u kujdesur për shëndetin tonë, por edhe për shëndetin e të tjerëve. Të gjitha degët ekonomike, ndërmarrjet dhe organizatat, qytetarët, grupet dhe çdo individ, pa përjashtim, janë pjesë e kësaj lufte.

Pas valës së parë të virusit ne mësuam shumë. Profesionistët e shëndetësisë dhe epidemiologët tani janë më të përgatitur dhe dinë shumë më mirë se si të veprojnë dhe të organizohen për sfidën e ardhshme të virusit korona. Vazhdimisht mësojmë dhe i ndjekim praktikat, njohuritë dhe hulumtimet botërore dhe i prezantojmë ato në punën tonë.

Të gjitha studimet shkencore deri më tani, por edhe përvojat nga epidemitë e tjera në të kaluarën, tregojnë se ka shumë gjasa që virusi të sjellë probleme edhe më të mëdha këtë vjeshtë. Ne jemi duke u përgatitur për këtë në përputhje me rekomandimet e OBSH-së dhe përvojat europiane dhe botërore.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut tashmë ka filluar një investim të madh në sistemin shëndetësor dhe ka filluar të forcojë repartet e kujdesit intensiv në të gjithë vendin. Me 33 milionë euro të Bankës Botërore, do të pajisim të gjitha repartet e kujdesit intensiv me pajisje moderne, shtretër, aparate të frymëmarrjes, aparate me rreze X dhe të gjitha pajisjet e tjera të nevojshme për të qenë në gjendje të ofrojnë kujdes të lartë shëndetësor.

### ***Covid-19 nuk është vetëm një sfidë shëndetësore***

Masat kufizuese në kohë e shpëtuan vendin nga pamjet e tmerrshme të spitaleve të Kinës, Italisë, Spanjës ... Pasi e lamë pas kulmin e parë të virusit, filluam me zbutjen graduale të masave kufizuese. Pjesa më e madhe e prodhimit vendas u riaktivizua, pothuajse të gjitha shitoret, qendrat tregtare, hotelieria dhe objektet sportive u hapën, por sipas protokolleve të mbrojtjes të përcaktuara

me kujdes. Ky është thelbi i "normalitetit të ri": të vazhdojmë me punët e rregullta dhe me aktivitetet shoqërore, por me masa të shtuara të mbrojtjes personale.

Qeveria do të vazhdojë të mbrojë shëndetin, që është në rend të parë, por edhe ekonominë. Të gjitha kufizimet e nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve patën pasoja të mëdha financiare dhe sociale. Të gjitha analizat serioze parashikojnë një goditje të fortë në ekonominë globale, tregtinë dhe tregjet, dhe rritjen e papunësisë dhe varfërisë. Tre grupet e masave qeveritare u udhëhoqën nga prioritetet tona:

- Të mbrojmë më të rrezikuarit me anë të masave të forta dhe të shpejta sociale të parashikuara për më shumë qytetarë dhe familje;
- T'i ndihmojmë ndërmarrjet në periudhën më të vështirë me burime të disponueshme financiare nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë, garancive dhe kredive të volitshme;
- Të zbutet goditja më e forte e krizës, si të ndërmarrjet, ashtu edhe të amvisëritë, duke riprogramuar dhe shtyrë pagesën e kredive;
- Ta forcojmë konsumin privat me masa të synuara për familjet më të rrezikuara, të papunët, të rinjtë dhe studentët.

Në mandatin e ri do ta zgjerojmë mbështetjen për konsum privat me dy kategori të tjera të qytetarëve: njerëzit e papunë që nuk ishin paraqitur çdo muaj në Agjencinë e Punësimit, pensionistët me të ardhura mujore nën 15,000 denarë, të falimentuarit dhe prindërit e vetëm.

Përgatitjet për valën e vjeshtës nuk do të ndërliken vetëm me sektorin e shëndetësisë. Që nga fillimi i krizës, shpejt i përshtatëm shërbimet më të rëndësishme për qytetarët dhe për afarizmin e kohës së re. Shërbimet e shumta digjitale që ne kemi vënë në përdorim në vetëm dy javë nënkuptonin zvogëlimin e mundësive të përhapjes e infeksionit, por edhe një shërbim më të shpejtë dhe transparent për qytetarët tanë dhe për ekonominë tonë. Qeveria do ta vazhdojë këtë prirje edhe gjatë kulminacionit të pritur të virusit këtë vjeshtë. Gjithashtu kemi zhvilluar protokolle të qarta për procesin arsimor në rast të paraqitjes së rrezikut, rritjen e sigurisë në trafikun publik, si dhe për zëvendësimin e karantinave të shtetit me testet e duhura PCR dhe vetizolim.

### *Investojmë në shëndetin publik*

Kriza ka treguar se sa i rëndësishëm është shëndeti publik. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e vendosur që zhvillimin e mëtejshëm të sistemit shëndetësorë ta drejtojë fuqishëm në përputhje me kërkesat nacionale dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e shëndetit publik dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe atyre masivike jongjitëse, me qëndrueshmëri financiare të sistemit, rritjen e cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve shëndetësore, solidaritetin dhe drejtësinë e sistemit shëndetësor, me qytetarët në qendër të sistemit dhe përfshirjen e tyre të plotë. Do të vazhdojmë me investimet në sistemin shëndetësor, si në infrastrukturë, ashtu dhe në burime njerëzore, pajisje dhe metoda dhe terapi më të përparuara. Deri në fund të vitit 2020 do ta përcaktojmë Strategjinë Dhjetëvjeçare të Alokimit dhe të Investimeve në Shëndetësi dhe do të kërkojmë mbështetje të gjerë parlamentare për të. Sistemi shëndetësor ka nevojë për një investim të qëndrueshëm dhe më të lartë.

Qeveria do të zbatojë politikat e mëposhtme:

- Çdo vit do të rrisim rrogat e punonjësve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë deri në 10%. Qëllimi ynë është që rroga më e ulët e teknikëve dhe e infermierëve shëndetësorë të arrijnë rrogën mesatare në vend deri në vitin 2024.
- Nga viti 2021 ne do të trefishojmë numrin e specializimeve në zona të veçanta. Do të shpallim dhe japim specializime shtesë në bashkëpunim me profesionistët e shëndetësisë, duke marrë parasysh mungesën e specialistëve në disa degë mjekësore;
- Një mundësi për çdo mjek të ri të diplomuar me licencë pune. Ne do të sigurojmë përvojë pune me pagesë për çdo mjek të ri, por edhe kompensim në para, si nxitje;

- Të gjithë mjekët në specializim që banojnë jashtë Shkupit e që nuk e kanë zgjidhur çështjen e strehimit do të marrin një subvencion prej 12,000 denarë në muaj;
- Do të nënshkruajmë Marrëveshje Stratregjike me Spitalin Universitar të Frankfurtit për edukimin e mjekëve dhe infermierëve të rinj me princip të ndërrimit;
- Do të hapim kapacitetet e institucioneve shëndetësore publike (sallat e operacionit) për shfrytëzim nga specialistët në përputhje me kriteret e përcaktuara, të cilat do të realizonin të ardhura shtesë për ISHP-të;
- Do të zhvillojmë model për ndryshime sistemike të mënyrës së pagesës për mbrojtjen arësore shëndetësore, në të cilën do të vlerësohet sasia dhe cilësia e shërbimeve që do të zbatojnë mjekët amë. Në këtë drejtim, për herë të parë do të vendosen standarde të parandalimit dhe të ndjekjes së gjendjeve dhe sëmundjeve të caktuara, të përshtatura në nivelin parësor të mbrojtjes shëndetësore. Gjithashtu, me ndryshimet e mënyrës së pagesës do të nxisim investime në arsimim, burime teknike dhe materiale. Do të nxitet përfshirja aktive e infermierëve në realizimin e kujdesit shëndetësor;
- Do të zbatojmë sistem të arsimit të vazhdueshëm të infermierëve me qëllim rritjen e kompetencave dhe njohurive të tyre në fushën përkatëse ku ata punojnë.
- Burokraci më pak, shërbim më të shpejtë shëndetësor. Me lidhjen e plotë shëndetësore-informatike, do të shmangët plotësisht "shëtitja" e pacientit për arsye administrative midis mjekut amë-specialistit-mjekut amë-barnatores. Qeveria do të vendosë shëndetësi të plotë elektronike, pa përdorimin e dokumenteve në formë të letrës.
- Deri në fund të vitit 2020 do ta prezantojmë aplikacionin "Shëndeti im". Me këtë, për çdo qytetar do të sigurohen të dhëna të lidhura në mënyrë elektronike dhe historiat e diagnozave dhe të terapive. Me këtë, qytetarët do të kenë kontroll dhe kujdes më të mirë për shëndetin e tyre.
- Forcimi i kapaciteteve të shëndetit publik (rajonalizimi) nëpërmjet lidhjes funksionale për të gjitha nivelet e mbrojtjes shëndetësore (parësore, dytësore dhe tretësore).
- Do t'i përfshijmë krejtësisht shoqatat e pacientëve në krijimin dhe mbikëqyrjen e politikave shëndetësore dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Me këtë, do ta forcojmë rolin e pacientëve në komunikim me publikun profesionist në miratimin e rregulloreve dhe aktvendimeve ligjore për mbrojtjen shëndetësore.
- Deri në fund të mandatit, do t'i bëjmë të gjitha spitalet dhe qendrat shëndetësore me efikasitet energjetik dhe do t'i rinovojmë të gjitha pikat e vaksinimit dhe repartet më të vjetra në spitale.
- Në vitin 2020 do të sigurojmë 70 automjete të reja për ndihmën e shpejtë mjekësore dhe rinovimin e rregullt të parkut të automjeteve, çdo vit deri në fund të mandatit.
- Do të vendosim tre pika të reja për kujdes të shpejtë mjekësor në zonën e qytetit të Shkupit. Koha e përgjigjes së ndihmës së shpejtë mjekësore do të jetë deri në 10 minuta, në zonat urbane dhe deri në 20 minuta në zonat rurale.
- Do të fillojmë ndërtimin e një Qendre Klinike Universitare të re, moderne dhe funksionale në Shkup, e cila do të ofrojë shërbime shëndetësore me cilësi të lartë për popullatën në të gjithë shtetin.
- Do të vazhdojmë me rindërtimin, zgjerimin dhe pajisjen (përfshirë stafin e nevojshëm) të klinikave spitalore në Tetovë, Manastir dhe Shtip, dhe do të analizojmë nevojat dhe mundësitë e ngritjes së të tyre në klinika universitare, duke marrë parasysh vendndodhjen, kapacitetet dhe vlerën e investimit të Qendrës së re Klinike Universitare. Do t'i bëjmë këto qendra më efikase dhe më të arritshme për qytetarët, duke prezantuar projektin "Telemjekësia" ku udhëton informacioni dhe jo pacienti, e që do të lidhë Qendrën Klinike Universitare në Shkup me tre spitalet Klinike në Manastir, Tetovë dhe Shtip.

- Do të bëjmë furnizimin e pajisjeve të nevojshme mjekësore për modernizimin e institucioneve jashtë Shkupit, përkatësisht "Sh. Erasmus" - Ohër, Spitali i Përgjithshëm - Strumicë dhe Qendra e Urgjencës në Tetovë.
- Do të investojmë në spitalet ditore të reja dhe në kapacitete të zgjeruara ekzistuese ku pacientëve do t'u ofrohet shërbim ditor diagnostik ose terapeutik (internistike, kirurgjikale, dhe pediatrike) për të cilat nuk është i nevojshëm shtrimi në spital.
- Do të zhvillojmë kapacitete për trajtimin dhe kujdesin afatgjatë për të sëmurët kronikë, sidomos për të moshuarit dhe personat e palëvizshëm në gjendje të rëndë, për të cilët kujdesi në shtëpi nuk është i përshtatshëm. Kapacitetet e pashfrytëzuara të spitaleve do t'i kthejmë në shtëpi pleqsh.
- Do të formojmë shërbimin e ndihmësmjekëve në ndihmën e shpejtë mjekësore.
- Do të pajisim shërbimin e patronazhit në të gjitha rajonet e të gjithë vendit, bazuar në përvojën e rekrutimit të personelit në tre vitet e fundit.
- Cilësia e mbrojtjes shëndetësore varet edhe nga cilësia e personelit që udhëheq politikën shëndetësore, veçanërisht nga aspekti i ekonomisë shëndetësore dhe menaxhimit të shëndetësisë. Prandaj, do të formojmë këshill për vlerësimin e teknologjisë shëndetësore gjatë furnizimit të pajisjeve të reja mjekësore ose futjes së barnave të reja në listën pozitive.
- Do të sjellim masa dhe aktivitete për të zvogëluar sëmundshmërinë, paaftësinë dhe vdekshmërinë e parakohshme të shkaktuara nga sëmundjet kronike më të zakonshme jongjitëse (sëmundjet kardio dhe cerebrovaskulare, malinje dhe sëmundja e sheqerit). Nga viti 2021 do të vendosim një program të ri parandalues për skringun e kancerit të lëkurës (melanom).
- Në përputhje me protokollin europian dhe udhëzimet klinike, disponueshmëria e kontrollit të mamografisë do të rritet duke blerë mamografë shresë dhe një të lëvizshëm, që të përmirësohet shkalla e zbulimit të kancerit të gjirit në fazën më të hershme të mundshme.
- Do të forcojmë programet e parandalimit për të përmirësuar shëndetin oral;
- Mjekët e kujdesit parësor shëndetësor do të mundën të punojnë dhe të ofrojnë shërbime (kujdestari, ndihmë të shpejtë, pikat për vaksinim dhe patronazh) në vendet ku ka mungesë të mjekëve, për të cilat shërbime do të paguhën në mënyrë shtesë. Gjithashtu, mjekët e shtëpive të shëndetit do të mundën të regjistrojnë pacientë si mjekët amë;
- nxitja i mjekëve të rinj për të punuar në zonat rurale, nëpërmjet shpërndarjes së granteve për mjekë të rinj që duan të hapin ordinanca në zonat rurale;
- Sigurimi i shërbimeve gjinekologjike nëpërmjet kapaciteteve që disponon sistemi shëndetësor në nivelin dytësor;
- Sigurimi i shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues në zonat rurale nëpërmjet angazhimit të ambulanteve gjinekologjike të lëvizshme;
- Mjekët e fushës së gjinekologjisë dhe të pediatrikës në spitale në vende dhe rajone ku ka mungesë të mjekëve amë, do të mundin të regjistrojnë të siguar, si mjekët amë në këto zona;
- Trajtim falas në spitale (lirim nga pagesa e participimit për të siguruarit shëndetësor të disa kategorive shtesë) krahas grupeve të cënueshme të liruar më parë;
- Kapacitete të reja dhe të zgjeruara ekzistuese të spitaleve ditore në kuadër të institucioneve shëndetësore në të cilat, pacientëve, gjatë një dite pune, do t'u ofrohet shërbimi i caktuar diagnostikues ose terapeutik (interniste, kirurgjikale, pediatrike) për të cilat nuk është i nevojshëm shtrimi në spital;
- Zhvillimi i kapaciteteve për trajtimin dhe kujdesin afatgjatë të pacientëve me sëmundje të caktuara kronike, sidomos për të moshuarit dhe personat e palëvizshëm në gjendje të rëndë, për të cilët kujdesi në shtëpi nuk është i përshtatshëm;
- Krijimi i qendrave të kujdesit paliativ (bujtina) - ripërshtatja i kapaciteteve ekzistuese shëndetësore;

- Rishikimi i Rrjetit të Stomatologjisë Dytësore (proteza, kirurgji orale dhe ortodonci), me qëllim ndryshimin e kritereve të larta të rrjetit, të cilat janë në modelin aktual;
- Rishikimi i çmimoreve të shërbimeve dhe futja e shërbimeve të reja në hap me kohën e re në stomatologji, në mbrojtjen shëndetësore dytësore të dhëmbëve.
- Riorganizim i Qendrës Klinike Emergjente në Shkup (interniste) në një institucion shumë të specializuar dhe modern që do të kujdeset për të sëmurët kritik, duke përshtatur hapësirën, pajisjet dhe personelin;
- Vendosja e metodave të reja në secilën nga klinikat, duke sjellë ekspertizë të huaj që të përmirësohet njohuria e mjekëve tanë dhe për të ulur shpenzimet e trajtimit jashtë vendit;
- Vazhdimi i prirjes së uljes së sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënave dhe të të porsalindurve, me një tendencë për t'iu afruar mesatares europiane;
- Futja e serviseve të telemjekësisë në mbulimin e fushave të caktuara në shëndetësi (kardiologji, radiologji, ndihmë të shpejtë mejkësore), duke synuar rritjen e qasjes dhe përmirësimin e cilësisë së mbrojtjes shëndetësore;
- Do të iniciojmë ndryshime thelbësore në organizimin e aktivitetit stomatologjik me një studim serioz dhe të qëndrueshëm epidemiologjik mbi shëndetin oral të popullatës, nga ku do të dalin ndryshime thelbësore në organizimin e shërbimit dentar.
- Do të vazhdojmë me politikën "Barna në çdo kohë dhe për çdo pacient", pra pa kuota që rrezikojnë shëndetin e qytetarëve dhe krijojnë nervozë dhe frikë në pjesën më të madhe të muajit. Kjo politikë do të garantojë barna të siguruara, si në barnatore ashtu edhe në spitale, çdo ditë të muajit.
- Do të vazhdojmë të përditësojmë listën pozitive të barnave dhe të shtojmë terapi më cilësore dhe më moderne të barnave, në llogari të zëvendësimit të trajtimeve terapeutike të vjetruara.
- Do të vazhdojmë me sistemin e sigurimit të citostatikëve të duhur dhe më të mirë dhe terapive inovative për sëmundjet malinje.
- Siç kemi treguar me rastin e insulinës dhe heqjen e importeve paralele, do të vazhdojmë me politikën e barnave moderne vetëm me certifikimin e cilësisë. Do t'i përmirësojmë procedurat në lidhje me kontrollin dhe analizën e cilësisë së barnave me qëllim që të garantojmë cilësinë e tyre për përdoruesit përfundimtarë.
- Do të publikojmë një regjistër të pajisjeve mjekësore të regjistruara në mënyrë që qytetarët të konfirmojnë cilësinë e pajisjeve mjekësore.
- Në të njëjtën kohë, do të bëjmë një sistem të mbikëqyrjes së konsumit të barnave duke ndjekur çdo kuti të barnave me një 'cloud' sistem. E gjithë kjo me qëllim të përdorimit racional të barnave, si dhe kontrollimin dhe përcaktimin e rezervave ekzistuese të barnave në vend, me qëllim parandalimin e mungesave të barnave të caktuara dhe zëvendësimin i tyre në kohë në mënyrë që të rritet mundësia e qasjes e pacientëve.
- Këtë do ta arrijmë nëpërmjet menaxhimit elektronik të të dhënave, lidhjes dhe integritetit të plotë të të gjitha sistemeve që operojnë me të dhëna që lidhen me barna dhe shërbime shëndetësore. Kështu, do të ketë kontroll të plotë të proceseve që lidhen me barnat dhe pajisjet mjekësore.

## **Kujdes për të gjithë**

### *Politikë sociale*

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të luftojë kundër varfërisë që i zvogëlon mundësitë për një jetë të denjë për disa breza të ardhshëm, e që i "dënon" fëmijët dhe të rinjtë në arsim dhe mbrojtje shëndetësore jo të përshtatshme dhe i lë të rriturit në baltë në vitet kur ndihma është më se e nevojshme për ata. Investimet shoqërore i shohim si një mënyrë për të

mbështetur njerëzit që të përballen me rreziqet e jetës. Ky investim është parakusht për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Në luftën kundër varfërisë kemi detyrë shumë konkrete: të ulim shkallën e varfërisë nën 16%, me një theks të veçantë të varfërisë së fëmijëve.

Gjysma e dytë e rrugës së reformës sociale është të tregojmë se bashkësitë lokale do t'u mundësojnë qytetarëve shërbime sociale cilësore, që do të krijohen me qytetarët dhe në përputhje me nevojat e tyre. Koncepti "Komuna kujdeset" do të krijojë shërbime të reja, por në të njëjtën kohë do të sigurojë vende të reja pune në këtë sektor, duke hapur zyra të qendrave për punë sociale në secilën komunë në territorin e vendit dhe secila qendër për punë sociale do të formojë ekip për ndërhyrje që do të veprojnë 24/7, sipas shembullit të Shkupit.

Qeveria do të promovojë politika të bazuara në argumente dhe ndjeshmëri që do të thyejnë barrierat për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre:

- Ligj për lëvizjen e pavarur me qen udhëzues dhe aplikacion mobil për funksionimin e lehtësuar të personave të verbër.
- Për ushtrimin më të lehtë të të drejtave të tyre, të gjithë personat e regjistruar në regjistrin nacional të personave me aftësi të kufizuara do të kenë një kartë unike identifikimi me anë të së cilës do të kenë qasje falas në shërbime. Ne tregojmë se i respektojmë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi ynë është të ratifikojmë Marrëveshjen e Marrakeshit në drejtim të realizimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Është duke u bërë përgatitja e një ligji plotësisht të ri për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, futja e rehabilitimit profesional të paguar nga shteti në vitin 2021 dhe përgatitja e një regjistri nacional të personave me aftësi të kufizuara.
- Për shkak të kujdesit në kohë dhe të duhur për fëmijët me aftësi të kufizuara, do të formojmë pesë komisione rajonale për vlerësimin funksional të këtyre fëmijëve. Në mbështetje të arsimit përfshirës, do të krijojmë dhoma me sensorë dhe dhoma relaksimi në çerdhe dhe shkolla.
- Do të hapim një qendër për fëmijë më të rritur/ persona me autizëm në Shkup.
- Vazhdojmë të ulim kufirin e moshës për përdorimin e shërbimit të ndihmës personale në gjashtë vjet, dhe në bashkëpunim me shërbimin e patronazhit, çdo familje me një fëmijë me aftësi të kufizuara do të marrë mbështetje dhe edukim intensiv individual në 12 muajt e parë.
- Për herë të parë mundësuam ligjërisht krijimin e një qendre të kujdesit familjar në vend, dhe në periudhën e ardhshme çdo familje që ka person me aftësi të kufizuara do të fitojë 15 ditë kujdes zëvendësues në qendër dhe në të gjithë vendin do të ketë në dispozicion shërbimi 'jetesë me mbështetje për personat me aftësi të kufizuara'. Do të sigurojmë masë për pushimin e kujdesit familjar në baza ditore - me një ekip që mund ta bëjë atë në interval prej 2 deri në 4 orë një herë ose dy herë në javë.
- Ne do të forcojmë rolin e qendrave për fëmijë me aftësi të kufizuara në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor dhe dhënies së terapisë fizike në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara, dhe do të analizojmë mundësinë e integritit të këtyre qendrave me qendra ditore që i themelojnë komunat në nivel lokal.

Për më tepër, Qeveria do të vazhdojë ta konsiderojë kujdesin familjar si një qëllim të rëndësishëm. Për këtë shkak, do të themelohet një fond shtetëror për pagesën e mbështetjes ligjore të fëmijëve në situata kur njëri prind pas shkurorëzimit nuk i përmbush detyrimet ligjore.

Kujdesin do ta bëjmë më efikas nëpërmjet digjitalizimit të zgjeruar. Qytetarët nuk do të shkojnë më nëpër sportele për të mbledhur dokumente të realizimit të kompenzimeve për mbrojtje sociale. Vetë ministria do t'i marrë dokumentet nga institucionet kompetente të ministrive të tjera, me qëllim që qytetarëve t'u kursehet koha dhe paratë që paguajnë për marrjen e dokumenteve. Do të parandalojmë keqpërdorimin në sistemin e mbrojtjes sociale nëpërmjet raportimit të detyrueshëm të të ardhurave të fituara në një vend të huaj.

Qëllimi i Qeverisë është të zhdukë varfërinë e fëmijëve dhe të arrijë përfshirje prej 60% të fëmijëve prej tre deri në gjashtë vjeç në kujdesin dhe arsimin parashkollor deri në fund të vitit 2024. Deri në fund të vitit 2023 do të sigurojmë të paktën 7500 vende për fëmijë në çerdhet në Llozovë, Vasilevë, Bogovinë, Studeniçan, Dellçevë, Manastir, Gjevgjeli, Kumanovë, Çair, Strumicë, Dibër, Gostivar, Shën Nikollë, Tetovë, Tearcë, Negotinë, Gjorçe Petrov, Novakë, Brvenicë, Probishtip, Vallandovë, Haraçinë, Karposh, Likovë, Kriva Pallankë, Resnjë, Koçan, Kisella Voda, Sopishtë, Saraj. Tashmë kemi siguruar 15 milionë euro shtesë për çerdhe të reja gjithëpërfshirëse dhe me efikasitet energjetik. Së bashku me planin ambicioz për rinovimin dhe ndërtimin e çerdheve në secilën komunë, do të analizojmë mundësitë për zbatimin e arsimit të detyrueshëm parashkollor. Do të sigurojmë kujdes falas për të gjithë fëmijët e familjeve me të ardhura të ulëta.

Çdo vit, do të shpallim konkurs të veçantë për botimin e të paktën 10 titujve të reja për fëmijë dhe adolehentë. Anëtarësimi në bibliotekë do të jetë falas për çdo fëmijë.

Shtëpi për çdo fëmijë: shtesën e kujdesit familjar në familjet kujdestare do ta rrisim për 30%.

Do të krijojmë qendër për fëmijët me sjellje të rrezikut të lartë që janë në shtëpi të vogla grupore për shkak të mbrojtjes së fëmijëve të tjerë dhe për shkak të punës më të përqendruar me ta.

Qeveria do të punojë me përkushtim në përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve dhe në sigurimin e pleqërisë së denjë. Qëllimi ynë është të garantojmë:

- Sistem të qëndrueshëm të pensioneve për pensionistët aktualë dhe të ardhshëm;
- Pension të ri minimal më të lartë që do të jetë së paku 10.700 denarë për të gjithë;
- Krijimi i mundësisë ligjore për blerje të stazhit që të fitohet e drejta për pension;
- Sigurim i kujdesit nga ana e bashkësisë për të rriturit nëpërmjet vendosjes së shërbimeve lokale të kujdesit;
- Do të mundësojmë sistem pensioni fleksibël duke vendosur mundësinë e pensionimit të parakohshëm deri në maksimum pesë vjet para ushtrimit të së drejtës së pensionit, me shumë të zvogëluar proporcionalisht të pensionit të rregullt;
- Forcimi i rolit të të moshuarve në bashkësitë lokale dhe sigurimi i kushteve për përfshirje në jetën publike. Do të mundësojmë vullnetarizëm dhe angazhim në punë për të rriturit që duan ditë të plotësuar. Zbatojmë programe për mobilizimin e të moshuarve nëpërmjet transportit të subvencionuar ndërqytetor;
- Do t'i zhvillojmë shërbimet lokale dhe do ta mbështesim kujdesin e komunitetit ndaj të rriturve, ndërkaq do të sigurojmë kushte të kujdesit të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe të sëmurët;
- Do të shqyrtohen mundësitë për zgjerimin e përfshirjes së personave - shfrytërues të pensionit social shtetëror;
- Po themelojmë 10 qendra për plakje aktive dhe të shëndetshme, me programe që do të kujdesen për shëndetin mendor dhe fizik, socializimin dhe komunikimin e bashkëmohatarëve të të moshuarve;
- Po e zgjerojmë programin e rekreacionit banjor-klimatik.

### *Arsim*

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut beson se investimin më të madh në të ardhmen e fëmijëve dhe të rinjve tanë e bën në arsim. Arsimi i mirë ndërton qytetarë të lirë, forcon ekonominë dhe strukturën demokratike. Këto qëllime bëhen edhe më aktuale në kohën kur ballafaqohemi me sfidat e vjetra dhe të reja, kohë që lidh botën me revolucionin e katërt industrial dhe imponon kërkesa krejtësisht të reja për brezat e ardhshëm. Qeveria do të zhvillojë arsim cilësor të arritshëm për të gjithë; arsim që do të krijojë kuadro që do të mendojnë në mënyrë të logjikshme dhe kritike dhe do të nxjerrë

konkluzione bazuar në fakte dhe analiza. Duam arsimim që do të ndërtojë persona që do të respektojnë dhe kujdesen për të drejtat qytetare, tolerancën dhe shumëllojshmëri, do të edukohen dhe arsimohen në frymën e multikulturalizmit dhe do të jenë në gjendje t'i përgjigjen pozitivisht kërkesës së tregut të punës.

Rezultatet e testimit ndërkombëtar PISA në vitin 2018 krahasuar me vitin 2015 tregojnë përmirësim të dukshëm të arritjeve mesatare të nxënësve në të gjitha fushat e testuara: shkenca natyrore me 29 pikë, lexim me 41 pikë dhe matematikë me 23 pikë dhe tregojnë se kemi rritjen më të madhe të rezultateve ndër shtete. Por kjo nuk na kënaq aspak sepse edhe ato nota më të larta janë shumë të ulta në shkallën e arsimimit dhe njohurive. Kjo është çështje me interes të lartë nacional për të formatuar arsimin dhe për të ngritur cilësinë që të mund të përballemi me sfidat e kohës së re. Arsimi ynë duhet t'i përshtatet rrethanave të reja globale. Pandemia COVID-19 na ka treguar sa i rëndësishëm është kapaciteti i sistemit arsimor për të ndryshuar, përshtatur dhe modernizuar. Mësimet e marra nga përpjekjet e para për arsimin online në muajt e fundit të këtij viti shkollor do të jenë bazë e mirë për hapat e ardhshëm reformuese.

Që të kemi arsimit cilësor, do të investojmë shumë në potencialin njerëzor. Çelësi i suksesit është mësimdhënësi, dhe pa mësimdhënësit profesionistë dhe të motivuar nuk ka arsim cilësor. Prandaj, do të mundësojmë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve nëpërmjet trajnimeve falas nga ofruesit e akredituar, dhe njohuritë e fituara nga trajnimet mund të zbatohen në realizimin e përmbajtjeve mësimore. Mësuesit të cilët vazhdimisht do të mësojnë dhe angazhohen do të marrin më shumë kompensime, në përputhje me rregulloren e ndryshuar për rroga dhe shtesa.

- Për tre muaj do të përfundojmë analizën e plotë të rezultateve të testit PISA dhe rekomandimet konkrete që dalin prej saj për reforma reale dhe efektive në arsim. Do të organizojmë teste të ngjashme me PISA-në në çdo semestër dhe çdo shkollë. Këto teste do të jenë anonime dhe nuk do të ndikojnë në notat e nxënësve ose mësuesve, por do të ndihmojnë shkollën dhe shërbimin pedagogjik të përgatisin masa konkrete për të përmirësuar arsimin në secilën shkollë. Njëkohësisht, kështu do të ulët stresin gjatë testimit tek nxënësit. Do të ftojme të gjitha komunat të përfshihen në këtë detyrë dhe ta mbështesin atë.
- Do të zbatohen rekomandimet që janë pjesë e analizës së përgatitur në bashkëpunim me OECD-në dhe UNICEF-in me një Plan Aksionar të miratuar nga Ministria e Arsimit e që do të përfshihet në Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit 2018-2025.
- Do të vazhdojmë të investojmë në mësimdhënësit të motivuar. Qeveria do të investojë në zhvillimin e karrierës dhe avancimin e mësimdhënësve. Rrogat do të vlerësojnë gjithashtu përditësimet e personelit. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, do ta gjejmë modelin më të përshtatshëm të vlerësimit të punës dhe të cilësisë së mësimdhënësve. Me rregulloret e reja, mësimdhënësit do të kenë rroga më të larta nëse kanë ndjekur trajnime dhe kanë fituar kompetenca të reja. Në mënyrë shtesë do ta ulim punën administrative të mësimdhënësve që ata të përqendrohen plotësisht te nxënësit dhe në procesin arsimor. Në mbështetje të një stafi më të mirë mësimdhënësish, Qeveria do të ofrojë bursa për studentët e shkëlqyeshëm në fakultetet e mësimdhënësve.
- Do të vazhdojmë të përqendrohemi në arsimin e dyfishtë. Me investime në programe dhe pajisje, ato tanimë bëhen më tërheqëse. Do të rrisim kapacitetet për arsim të tillë dhe do të debatojmë mbi programet me komunitetin e afarizmit, dhe para fillimit të regjistrimeve do të kemi konsultime me ta në lidhje me kuotat e regjistrimit për profile të caktuara.
- Reforma arsimore do të thotë përqendrim në të menduarit logjik dhe zgjidhjen e detyrave logjike bazuar në analiza që do të fillojnë në ciklin e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar. Për më tepër, do të angazhohemi në promovimin e mësimin me kohë të plotë.
- Do t'u japim mundësi ndërmarrjeve të programimit në vend që të zhvillojnë softuer kompatibil me planin dhe programin mësimor me sistemin tonë arsimor. Në bashkëpunim me fakultetet e

informatikës, studentët që janë në vitet e fundit të studimeve do të kenë mundësinë të krijojnë zgjidhje të bazuara online ku do të sublimohen në një vend: burimet e informacionit, detyrat praktike dhe shembuj të praktikave të mira për përdorim inovativ të teknologjisë IT.

- Do të miratojmë strategji nacionale për digjitalizimin e sistemit arsimor. Me këtë do ta definojmë dhe legjitimojmë mësimin në distancë, si një zgjidhje alternative të mundshme për të mësuar, duke përdorur mjetet e komunikimit elektronik, pa prani fizike të palëve të përfshira. Një ekip qeveritar do të angazhohet plotësisht në zhvillimin e formave dhe të përmbajtjeve digjitale në arsim. Me ndihmën e programuesve vendas dhe mbështetjen nga fakultetet e informatikës dhe teknologjisë do të krijojmë platformë qendrore nacionale me komunikim të dyanshëm, një bazë me shembuj të praktikave të mira, plane dhe programe mësimore, libra elektronike, portofole elektronike të mësimdhënësve, dosje elektronike të nxënësve etj, evidencë dhe dokumentacione pedagogjike që do të jetë lehtësisht i përdorshëm (user friendly) nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, por edhe nga institucionet arsimore. Kështu do të përgatisim gjeneratën e ardhshme për kohën dhe teknologjinë e re, dhe njëkohësisht do të kemi kapacitet të shtuar për t'u marrë me kriza të llojit si pandemia e fundit.
- Në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe FITR-së do të sigurojmë program për përkrahje të produksioneve të videoklipeve si materiale shkollore me përmbajtje dhe tema nga lëndët, e për të cilat mund të aplikojnë të gjithë mësimdhënësit e arsimit fillor dhe të mesëm. Në këtë mënyrë ne mund të nxisim mësimdhënësit që t'i qasen mësimdhënies në mënyrë më kreative, të përdorin përvojat e të tjerëve dhe më shumë t'u interesojnë nxënësve edhe përmbajtjet që i kanë të panjohura. Njëkohësisht, do të krijojmë mundësi të barabarta për mësim në rajone të zhvilluara dhe të pazhvilluara.
- Do ta ndryshojmë metodologjinë për shkrimin dhe botimin e teksteve shkollore. Do të rishikohen disa libra shkollorë për shkak të përmbajtjes së vjetëruar, pamjaftueshmërisë së gjuhës dhe stereotipave që duhet tejkaluar. Do të vendosim libra elektronike në të gjitha gjuhët e mësimin, të arritshëm për çdo student.
- Do të rishikojmë formulën për financimin e shkollave fillore dhe të mesme publike.
- Do të bëjmë analizë funksionale të rrjetit të shkollave të mesme bazuar në nevojat e tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik rajonal.
- Do të krijojmë qendra rajonale "VET". Brenda programit "BE-ja për Rini" – Marrëveshje Sektoriale Reformuese – është bërë ndryshim në Ligjin e Arsimit të Mesëm Profesional në lidhje me mënyrën, si dhe janë zgjedhur tre shkolla të mesme profesionale komunale për të vazhduar punën si qendra rajonale "VET". Janë zgjedhur tre shkolla, përkatësisht Shkolla e Mesme Profesionale Komunale "Kiro Burnaz"- Kumanovë, Shkolla e Mesme Profesionale Komunale "Moshë Pijade"- Tetovë dhe Shkolla Komunale Hotelierike dhe e Turizmit "Vanco Pitosheski"- Ohër.
- Pajisja e shërbimeve profesionale në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm me ekipe prej të paktën tre bashkëpunëtorësh (pedagog, psikolog dhe defektolog).
- Qëllimi ynë do të jetë të investojmë për shkolla më mirë të pajisura (materiale mësimore, laborator, etj.) dhe klasa më të vogla (deri 20 nxënës për klasë).
- Akademia e Sporteve do të ristrukturohet dhe vendoset në kompleksin e ri modern të sporteve.
- Qeveria do të financojë nxënësit dhe studentët tanë më të mirë. Do të sigurojmë mbështetje financiare për nxënësit dhe mentorët e tyre për pjesëmarrje në Olimpiadat dhe garat ndërnacionale, dhe me ligj do të sigurojmë çmime në para për tre vendet e para të fituara. Kjo tashmë ka filluar nëpërmjet Fondit të Inovacionit dhe të Zhvillimit Teknologjik (FIZHT) ku krijuam program të veçantë për përkrahjen e pjesëmarrjes së të rinjve në gara dhe panairë shkencore. Do të krijojmë shpërblime për shkencëtarët e rinj.

- Do të ndërtojmë ose rindërtojmë shkolla fillore dhe të mesme në Aerodrom, Shkup, Studeniçan, Butel, Veles, Tetovë, Çuçer Sandevë, Çair, Kisella Vodë, Kumanovë, Haraçinë dhe vende të tjera. Do t'i pajisim qendrat rajonale të arsimit profesional dhe trajnim (qendrat VET) në Tetovë, Kumanovë dhe Ohër. Do ta ndërtojmë shkollën e mesme matematike dhe informatike dhe Kampusin Universitar "Nënë Tereza" në Shkup. Do të ndërtojmë, rindërtojmë, sanojmë dhe do të sigurojmë efikasitetin energjetik të konvikteve studentore; Do të planifikojmë ndërtimin e sallave sportive në disa shkolla ku ka mungesë.
- Do të përmirësojmë librat shkollorë për mësim në gjuhën amtare për të gjithë komunitet me numër të vogël.
- Do të krijojmë departament për kërkime shkencore në kuadër të Fondit të Inovacionit dhe të Zhvillimit Teknologjik. Buxheti i departamentit do të financojë projekte nacionale hulumtuese-shkencore që do të forcojnë kapacitetet e universiteteve dhe të instituteve shkencore, duke vënë në veprim pajisjet ekzistuese të hulumtimit shkencor. Departamenti do të formohet në vitin 2020, kështu që në vitin 2024 alokimi i përgjithshëm për shkencën do të jetë deri në 1.5%.
- Do të ndihmojmë konkurrencën e universiteteve dhe do të mundësojmë bashkëpunimin e tyre me universitete prestigjioze të huaja për pjesëmarrje të përbashkët në programet ndërnacionale për financimin e projekteve me përkrahje financiare dhe teknike të ekipeve të projektit në konkurs. Gjithashtu do të ndryshojmë legjislacionin nacional për punimet financiare në projekte ndërnacionale me qëllim lehtësimin e realizimit.
- Do të ofrojmë kuota shtetërore për studimet pasuniversitare në vend për ata studentë që kanë përfunduar studimet deridiplomike sipas EKTS-së që të marrin 240 kredite. Përveç bursave për studentët universitarë, do të prezantojmë bursa për studime master në profesione në mungesë, si dhe bursa për studentë të talentuar, që do të mundësojë mbajtjen e të rinjtë të studiojnë në vend.
- Do të krijojmë një sistem që më lehtë të mbahen të diplomuarit më të mirë, të punojnë në veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe në arsim të lartë në universitete dhe institucione shkencore nëpërmjet procedurave më të shpejta të miratimit të punësimit (pas pensionimit) dhe bursave për studimet e tyre të doktoratës.
- Vendosija e mekanizmave për konkurrencën dhe vlerësimin në arsimin e lartë në pajtim me kriteret e listës së Shangait dhe renditjen e universiteteve me qëllim që të rritet cilësia e arsimit të lartë.
- Në arsimin e lartë në kuotat e regjistrimit të anëtarëve të komuniteteve, përparësi do të kenë studentët që do të tregojnë njohuri ose diplomë për njohjen e gjuhës amtare.

### *Sporti dhe rekreacioni*

Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut sporti është një mjet i rëndësishëm që kontribuon në zhvillimin e një shoqërie përparimtare dhe përfshirëse, mundëson ndërveprim social dhe ndikon pozitivisht në përhapjen e parimeve themelore etike të gjitha kategoritë e qytetarëve, veçanërisht të rinjtë. Sporti luan rol jetik në ngritjen e përfshirjes sociale, në ndërtimin e shoqërive të hapura dhe tolerante, sporti mëson vlerat e punës në ekip, të disiplinës dhe të udhëheqjes, si dhe shpërblimin për punën e madhe dhe arritjet.

Qëllimi ynë është të krijojmë sistem ku do të; përparojë sporti dhe rezultatet sportive; sistem që do të forcojë cilësinë e jetës, ndërveprimin social dhe do të mundësojë zhvillimin e vërtetë të individit dhe një mënyrë jetese të shëndetshme të sa më shumë qytetarëve.

Prandaj, treguesit tanë të suksesit do të jenë: rritja e numrit të qytetarëve dhe e të rinjve që merren me sport, rritja e numrit të stafit profesional të sporteve, arritja e rezultateve të larta dhe afirmimi i sporteve të larta, rritja e numrit të grave në sport, infrastruktura sportive cilësore, përmirësimi i statusit të sportistëve dhe punëtorë sportivë, afirmimi i olimpizmit dhe partizim zero në sport.

Në katër vitet e ardhshme do të zbatohet politikat e mëposhtme:

- Me sistemin e kuponëve vazhdojmë të sigurojmë më shumë para për sportet dhe do t'i thjeshtojmë dhe promovojmë, që të kemi mbështetje më të madhe për sportet, sportistët dhe subjektet sportive. Në vitin 2020 arritëm të sigurojmë 10 milionë euro shtesë në sport, si dhe buxhet prej gjashtë milionë denarë për sistemin e shpresave për sportistët e rinjë. Qëllimi ynë do të jetë që deri në fund të mandatit kjo shumë e kuponëve të rritet në 15 milionë euro.
- Do të miratojmë aktvendim që do të rregullojë stazhin e sportistëve.
- Vendosim barazi gjinore në sport - 30% e grave në organet drejtuese (Parlament, Bordin Drejtues, Bordin Ekzekutiv) duke filluar nga viti 2020, dhe 50% deri në vitin 2024. Federatat që marrin mjete financiare nga buxheti i shtetit duhet të sigurojnë funksionimin e sporteve për meshkuj dhe femra, përkatësisht klube sportive për meshkuj dhe femra, dhe / ose ekipe nacionale.
- Të gjitha objektet ekzistuese sportive i ngrohim, i bëjmë me efikasitet energjetik, u japim një dimension shumëfunktional dhe i vendosim në funksion të nevojave të të gjithë sportistëve dhe qytetarëve.
- Do të krijojmë një fond sportiv për sportet kryesore (sportet përfaqësuese, individuale dhe ato të klubit).
- Të gjitha objektet sportive në pronësi të shtetit dhe të komunave e që jepen me koncesion ose janë nën NPP do të duhet të sigurojnë 15% nga terminet për fëmijë dhe të rinjë e kategorive të ndjeshme sociale.
- Qëllimi ynë është të rrisim numrin e të rinjve që merren me sport, për 30%. Do t'i ftojme të gjithë arsimtarët e edukimit fizik dhe sport nga të gjitha shkollat, që çdo të shtunë, për dy orë të mbajnë sporte të organizuara në natyrë: atletikë, shëtitje, ecje, futboll, basketboll dhe lojëra sportive.
- Do të bashkëpunojmë me ndërmarrjet e pajisjeve sportive për të ndihmuar në promovim dhe mbështetje. Në semestrin e parë do të ushtrojnë brenda shkollës, ndërsa në semestrin e dytë do të organizohet olimpiadë shkollore. Tri shkollat kryesore, si shpërblim, do të fitojnë pajisje sportive.
- Në të gjithë vendin, do të organizojmë gara qendrore ndër-fit me muzikë, shoqërim dhe festim për shpirtin dhe trupin e shëndetshëm.
- Do t'i përfundojmë projektet për ndërtimin dhe rindërtimin (rehabilitimin) e objekteve sportive të filluara në vitin 2020, si: ndërtimi i një pishine noti në komunën e Ohrit, ndërtimi i 14 pishinave të mbyllura shkollore, ndërtimi i sallës në komunën e Çairit, për shkathtësi të mundjes, ndërtimi i 10 fushave të basketbollit, ndërtimi i një Shtëpie Sportive, ndërtimi i një pishine të mbyllur në Tetovë, rindërtimi i sallave sportive në Negotinë dhe Veles, pishina në Strugë, stadiumi në Kavadar dhe rindërtimi i infrastrukturës sportive në komunat: Kisella Voda, Manastir, Ilinden, Demir Kapi, Gostivar, arenë hokej në SCBT, Karposh, Kërçovë, Likovë, Dollnen dhe Strugë.
- Do t'i përfshijmë personat me aftësi të kufizuara në të gjitha segmentet e sporteve.
- Po promovojmë qeverisje të mirë, luftë kundër korrupsionit, luftë kundër ndeshjeve të kuredisura dhe dopingun.
- Po i fillojmë të gjitha proceset dhe aktivitetet për zyrtarizimin e sportit elektronik, përkatësisht gejming-lojrat si kategori zyrtare e sportit.
- Do t'i analizojmë të gjitha marrëveshjet e koncesionit për objektet dhe sallat sportive dhe do t'i mbikëqyrim nëse janë përmbushur detyrimet ndaj komunitetit.

### *Demokrati që punon për qytetarët*

Për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, demokrati do të thotë qytetarë të lirë dhe të informuar. Ata një herë në katër vjet, marrin vendim zgjedhor dhe demokratik, por çdo ditë mund të marrin informacion të saktë dhe në kohë, çdo ditë mund të shprehin mendimin e tyre, të organizohen, të inicojnë ndryshime dhe të ndikojnë në vendimet që merren në emër të tyre. Vetëm atëherë sistemi zgjedhor demokratik është plotësisht në të mirë të qytetarëve që i mbron dhe i forcon ata.

Liria e shprehjes është e drejtë themelore e njeriut e që është thelbësore që një shoqëri të quhet demokratike dhe të ecë përpara. Besojmë në lirinë dhe pluralizmin e mediave sepse vendin tonë e shohim si mozaik të kulturave, gjuhëve, zakoneve dhe mendimeve - kjo është veçantia dhe nga aty vjen fuqia dhe madhësia. Jemi të bindur se roli i vetëm i qeverisë në rregullimin e sektorit të mediave duhet të përqendrohet në sigurimin e lirisë së fjalës, pluralizmit strukturor, gjuhën maqedonase dhe gjuhët e komuniteteve dhe mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme mediatike.

Liritë varen edhe nga forca, njohuritë dhe mobilizimi i sektorit civil. Vetëm kjo mund të garantojë zhvillim të qëndrueshëm dhe ndryshime demokratike në vend.

Në katër vitet e ardhshme do të përqendrohemi në zhvillimin e Radio Televizionit Nacional si një transmetues i vërtetë publik që është në hap me kohën, informon në kohë dhe saktë, mbron publikun nga keqinformimi dhe ndërton raportim profesional dhe cilësor.

Njëkohësisht, Qeveria do të punojë në mënyrë aktive në strategjinë e përbaljes me lajmet e rreme që minon sigurinë, demokracinë dhe besimin në institucionet. Qeveria do të mbështesë krijimin e një laboratorit mediatik kërkimor, ku studentët e gazetarisë, që nga fillimi i studimeve, do të përfshihen në mënyrë proaktive në luftën kundër keqinformimit dhe lajmeve të rreme. Do të sigurojmë mbrojtje më të madhe të audiencës së të miturve nga ndikimet e dëmshme të mediave online, duke harmonizuar legjislacionin nacional me direktivën e re të BE-së për rregullat dëgjimoro-pamore që kanë të bëjë me platformat e shpërndarjes së videove.

Qeveria do të udhëheqë politikë të përkrahjes së vazhdueshme dhe jodiskriminuese financiare dhe jofinanciare për mediat e shkruara dhe televizionet lokale / rajonale. Qeveria do të propozojë rregullore më të mirë për pronësi dhe përqendrim të mediave, dhe do të përkrahim vetërregullimin efektiv.

Qeveria do të propozojë heqjen e të ashtuquajturës Qeveri e Përzhinës, e cila ka treguar dobësi të shumta, bllokoi një pjesë të aparatit shtetëror gjatë periudhës së krizës më të madhe botërore dhe është keqpërdorur.

Qeveria është e përkushtuar në përmirësimin e rrethinës ku punon dhe zhvillohet shoqëria civile, e cila kontribuon në forcimin e qeverisjes demokratike dhe krijimin e dialogut të strukturuar me shoqërinë civile që do të kontribuojë dhe përkrahë rrugën e reformave dhe të integritit të vendit në Bashkimin Europian. Tërësisht do të reformojmë sistemin aktual të financimit shtetëror të shoqërisë civile, i cili bazohet kryesisht në legjislacion dhe praktikë të krijuar disa dekada më parë, nuk pasqyron nevojat aktuale të shoqërisë civile, nuk i ndjek praktikën dhe trendet pozitive në BE-së dhe në vendet e zhvilluara. Prandaj:

- Do ta rrisim pjesën e financimit shtetëror nga buxheti qendror dhe buxhetet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale, që të arrihet hise prej 30% (rreth dy miliardë denarë) e të ardhurave të përgjithshme të organizatave të shoqërisë civile deri në vitin 2024.

- Do ta reformojmë procedurën e planifikimit të mjeteve (konsultime të detyrueshme për prioritetet); vendimmarrja (komisione të pavarura, rregullimi i konfliktit të interesit, përfshirja e ekspertëve dhe e përfaqësuesve të organizatave qytetare); dhënia dhe njoftimi për financimin shtetëror për organizatat qytetare; mbikëqyrja e asaj që është arritur dhe vlerësimi etj.

- Do të vendosim mekanizma për planifikim të unifikuar, përkatësisht do të sigurojmë planifikim shumëvjeçar të mjeteve për organizatat civile.

- Do ta përmirësojmë përkrahjen programore të organizatave të shoqërisë civile nëpërmjet një fondi të pavarur për mbështetjen dhe zhvillimin e shoqërisë civile, i cili do të jetë përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e fondeve të destinuara për zhvillimin e organizatave qytetare, nëpërmjet mbështetjes institucionale, me pavarësi administrative, menaxhuese, financiare dhe programore.

- Me Fondin e mbështetjes dhe të zhvillimit të shoqërisë civile do të mundësohet bashkëfinancim i projekteve europiane të organizatave qytetare që janë në përputhje me prioritetet strategjike të vendit, qëllimet e programit të ndihmës së paraanëtarimit me fondet strukturore të Bashkimit Europian.

-Shoqërinë civile do ta përfshijmë në konsultimet sistematike për të vendosur dialog strukturor, përkatësisht do të përcaktojmë dinamikën e proceseve konsultative dhe mënyrat e ndikimit të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në krijimin e politikave. Për më tepër, do ta përkrahim shoqërinë civile për të krijuar model për pjesëmarrjen e organizatave qytetare në strukturën e ardhshme negociuese të BE-së në vend; me anë të modelit përfaqësues dhe gjithëpërfshirës do të mundësohet pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile në Sektorin e grupeve punuese të Sektorit e komiteteve mbikëqyrëse; do të ruajë modelin përfaqësues dhe gjithëpërfshirës për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në Këshillin e Bashkëpunimit dhe të Zhvillimit të Sektorit Civil; do të promovojë bashkëpunimin strukturor me shoqërinë civile nëpërmjet Këshillit të Partneritetit të Hapur Qeveritar.

Qeveria do të organizojë konsultime me shoqërinë civile në një fazë të hershme të analizës, mbi nevojat dhe përgatitjen e politikave dhe ligjeve. Për më tepër, Qeveria do të angazhohet dhe do të garantojë informacione kthyes për shoqërinë civile dhe palët e përfshira nga çdo proces konsultimi për politikën dhe ligjet. Kjo do të thotë që në seancat qeveritare do të miratohen propozim-ligje që përmbajnë raportin me opinionet e marra, propozimet dhe komentet nga procesi i konsultimit me palët e përfshira, ku do të tregojnë arsyet pse propozimet e dhëna nuk u pranuan.

### *Kultura europiane*

Qeveria e sheh kulturën si çelësin e transformimit të shoqërisë sonë: ndryshimi i vetëdijes, shprehitë, nevojat, sjelljen e të gjithë qytetarëve. Parimet dhe vlerat për të cilat insistojmë në këtë program janë vlerat kryesore europiane: kujdesi për identitetet individuale dhe kolektive, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, multikulturalizmi, kujdesi për diversitetin dhe qytetarët e rrezikuar, dialogu ndërkulturor, decentralizimi, pjesëmarrja dhe demokracia kulturore.

Qeveria do të promovojë politikën e respektit të ndërsjellë dhe shfaqjen e diversitetit të përkatësisë individuale dhe kulturore si një përparësi për shoqërinë tonë. Në këtë drejtim, do të ndiqet një politikë e baraspeshuar për zhvillimin e programeve dhe institucioneve ekzistuese dhe / ose të reja për promovimin e vlerave kulturore të të gjitha bashkësive etnike në vendin tonë.

Në njëzetvjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe në mbështetje të kohezionit të brendshëm, 13 gushti do të shpallet si Dita e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe do të shënohet nën kujdesin e Ministrisë së Sistemit Politik dhe të Marrëdhënieve mes Bashkësive.

Qëllimi i qeverisë do të jetë zhvillimi i kulturës në të gjitha segmentet e saj. T'i forcojmë institucionet në mënyrë kadrovike, infrastrukturore, teknike dhe programike. T'i përmirësojmë kushtet e punës në sektorin jashtëinstitucional dhe të krijojmë praktika bashkëpunimi dhe sinergjie mes tyre. Ta përmirësojmë statusin social edhe të punonjësve dhe ta vlerësojmë punën autoriale të të gjithë atyre që angazhohen në kulturë. Të tërheqim më shumë audiencë dhe të mundësojmë sa më shumë qytetarë të marrin pjesë në aktivitetet kulturore. Në të njëjtën kohë, në përputhje me prirjet europiane, parashikojmë masa me të cilat do ta përdorim potencialin e kulturës për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, veçanërisht në nivel lokal. Do të forcojmë praninë e aftësive krijuese dhe kritike në procesin arsimor, por edhe në zhvillimin e afarizmave të reja dhe inovative.

Trashëgimia kulturore do të luajë një rol kyç në politikën tonë. Ajo e forcon ndjenjën e përkatësisë, të ndarjes së vlerave dhe traditave të përbashkëta. E përfaqësojmë idenë europiane që

trashëgimia kulturore është burim i përbashkët, që e ngrit vetëdijen për historinë tonë të përbashkët, që na bashkon si qytetarë, por gjithashtu na legjitimon përpara familjes europiane të shteteve, duke kontribuar në mënyrë aktive në identitetin e përgjithshëm europian.

- Do të zbatohet një sistem i financimit të detyrueshëm të monumenteve nga Lista e monumenteve me interes kombëtar, sipas parimit të kategorisë së vlerës dhe të shkallës së rrezikut. Lista do të jetë e hapur dhe aty do të mund të regjistrohen monumentet e reja nga trashëgimia e paluajtshme, luajtshme dhe jomateriale.
- Do të rrisim numrin e stafit profesional në qendrat e konzervimit.
- Do të bëjmë rishikimin dhe fshirjen e të gjitha monumenteve dhe objekteve të regjistruara në mënyrë të paligjshme në regjistër, nga i ashtuquajti projekti "Shkupi 2014", që për nga natyra e tyre nuk paraqesin trashëgimi kulturore.
- Do të mbështesim zhvillimin e industrive kulturore dhe krijuese që lidhen me produktet e kulturës tradicionale duke përfshirë organizata folklorike amatore që ushqejnë krijimtarinë tradicionale.
- Do të shpallim konkurs ndërkombëtar për revitalizimin e zonës qendrore të kryeqytetit pas dëmit të shkaktuar nga "Shkupi 2014". Si antipod, ky konkurs do të jetë pjesë e aplikimit të Qytetit të Shkupit për programin më të madh kulturor në Bashkimin Europian, Kryeqyteti Europian i Kulturës.

Zhvillimi i nevojave kulturore, pjesëmarrja në aktivitete artistike dhe kulturore, përjetimi i kulturës çon në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së secilit individ. Prandaj, do të mbështesim krijimin e një kinemaje të lëvizshme, dy herë në vit do të organizojmë "Muzeun 24/2" - 24 orë, hyrja gjatë fundjavës në të gjithë muzetë do të jetë falas (të premtën nga 18 deri në ora 24, të shtunën nga 12 deri në ora 24 dhe të dielën nga ora 10 e mëngjesit deri në ora 16), bibliotekat do t'i rregullojnë hapësirat e tyre për një qëndrim më të rehatshëm të lexuesve, do të organizojnë aktivitete për lexuesit, si promovime, klube debati, punëtori leximi, do të rrisim grantet financiare për programe dhe projekte që kontribuojnë në forcimin e bashkësive lokale me anë të përkrahjes së festivaleve lokale, ngjarjeve të rëndësishme, përvjetorëve, të gjitha me qëllim të ruajtjes dhe të promovimit të trashëgimisë jomateriale të zonave rurale dhe të pazhvilluara.

Nëpërmjet Ministrisë së Kulturës do të mbështesim krijimtarinë letrare të autorëve të rinj, duke vendosur masa të veçanta nxitëse. Do të hapim konkurs të veçantë për botimin e të paktën 10 titujve të reja për fëmijë dhe adoleshentë. Do të jepet përkrahje për përkthime dhe për letërsinë përkthyesë, me theks të veçantë në cilësinë e përkthimit dhe vlerësimin e duhur financiar të punës së përkthyesve letrarë që përkthejnë nga gjuha origjinale. Ministria e Kulturës do të forcojë sistemin e mbrojtjes së gjuhës maqedonase dhe përkrahjen e veprave letrare.

Duke përdorur praktikën dhe përvojat europiane, do të krijojmë kushte për financime të llojllojshme në kulturë. Nëpërmjet sistemit të lehtësimeve tatimore, do të nxisim donacionin, sponsorizimin, patronazhin dhe format e tjera të financimit. Qeveria do të nxisë partneritete publiko-private-civile dhe do të propozojë kornizë ligjore për dhënie dhe "grant dotacioneve" për kulturën në të gjitha komunat, pavarësisht nëse ato kanë apo jo institucione lokale. Fondet për grante të tilla do të sigurohen sipas kriterëve të përcaktuara ligjorisht, për shembull: në varësi të numrit të banorëve, numrit të institucioneve, komunës rurale ose urbane, etj. Do të sigurohen mekanizma të qëndrueshëm për bashkëfinansim të pjesëmarrësve në programet dhe projektet e BE-së dhe bashkëpunim tjetër ndërkombëtar dhe rajonal në nivel nacional dhe lokal.

Do të vazhdojmë të investojmë në infrastrukturën kulturore, ku në disa qytete do të themelojmë Qendra Kulturore Rinore, si institucione të specializuara që do të zhvillojnë nevojat kulturore të të rinjve, në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre për t'i mbajtur ata në vend. Në varësi të nevojave,

ato do të jenë qendra multimediale me hapësira shumëqëllimore: salla kinemaje, skena teatri, skena koncerti, salla ekspozite, salla boulingu, bufe ose hapësira e kafeneve afarizmi, etj.

Qeveria do të vazhdojë fazën e dytë të decentralizimit institucional që duhet të sigurojë shërbime më të mira për qytetarët në përputhje me Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Lokale. Që të tejkalohen dobësitë e fazës së parë të decentralizimit, do të kryejmë rritjen e bllok dotacioneve për të mbuluar të gjitha nevojat reale të institucionit lokal, për mjetet e mirëmbajtjes aktuale dhe materiale të institucioneve, për investime të reja, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së objekteve të institucioneve lokale në kulturë dhe funksionalitetin e tyre dhe do t'i aprovojmë rregullisht kërkesat për plotësimin e vendeve të lira të punës, si dhe për punësime të reja të nevojshme në institucionet lokale, nga Ministria e Financave. Jetojmë në një vend të zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Në kulturë do të punojmë në zhvillimin e barabartë kulturor, para se gjithash, përmjet politikave dhe instrumenteve të decentralizimit dhe demetropolizimit të kulturës.

Ekonomia kulturore mund të jetë një burim i madh i të ardhurave dhe të ulë ose parandalojë largimin e njerëzve nga bashkësitë lokale në kryeqytet dhe jashtë vendit. Gjithashtu, është një forcë e madhe lëvizëse për zhvillimin e qëndrueshëm. Diversiteti ynë kulturor përfaqëson një potencial të madh për zhvillimin e këtij lloji të ekonomisë. Ne do të marrim një sërë masash për të ringjallur këtë prioritet të politikave bashkëkohore europiane:

- Do të rrisim numrin e qendrave krijuese dhe të inkubatorëve, ku ndërmarrjet e reja dhe fillestare, shoqatat civile dhe artistët e pavarur, profesionistët e pavarur do të kenë të gjitha mundësitë të punojnë dhe të krijojnë bashkarisht
- Do të japim mbështetje të plotë në përdorimin maksimal të IPA mekanizmit për zhvillimin e industrive krijuese dhe kulturore. Do të sigurojmë trajnim dhe do të krijojmë linja bashkëfinancimi për projekte në këtë, siç kemi bërë me programet e tjera të BE-së, siç është Europa Krijuese.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të respektojë Marrëveshjen Kolektive të të Punësuarve në Kulturë. Ndër tjerash, marrëveshja rregullon kompensimet e shpenzimeve të transportit nga dhe deri në vendin e punës në kushte specifike, pastaj kompensimi i shtesave në terren, kompensimi i shpenzimeve për jetën e ndarë nga familja, kompensimi i shpenzimeve për përdorimin e automjetit personal për nevojat e punëdhënësit, kompensimi i shpenzimeve gjatë migrimit, përgatitja për të shkuar në pension dhe shpërblimet jubilarë. Në bashkëpunim me sindikatat, do të hapim një debat mbi të gjitha të drejtat e tjera të punonjësve në kulturë, të llojit si stazh i përfituar, punë shtesë jashtë Programit Vjetor të Punës së Institucionit, liberalizimi i kushteve dhe procedurave për artistë të pavarur dhe rregulla të përdorimit të llojeve të tjera të përfitimeve, siç janë (përfitimet në të holla, dhënie e hapësirës për punë ose për botimin e veprave, pa kompensim, dhurimi ose huazimi i pajisjeve dhe i instrumenteve pa kompensim dhe mjeteve të punëve të sigurimit, instrumenteve).

### *Barazia midis burrave dhe grave*

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut fuqimisht beson se nuk ka barazi në shoqëri, nëse nuk ka barazi midis burrave dhe grave. Kjo është mënyra e vetme për të ndërtuar një shoqëri ku ka mbrothësi. Vendet ku barazia gjinore është vlerë me prioritet të lartë, janë vende ekonomikisht më të suksesshme. Qëllimi i qeverisë do të jetë arritja e barazisë gjinore në vendin tonë, shuarja e stereotipeve gjinore dhe eliminimi i dhunës me bazë gjinore. Për këtë qëllim, do të ndjekim një politikë aktive të rritjes së përfaqësimit të grave në të gjitha pozitat ekzekutive dhe të zgjedhura nga qeveria.

Qeveria do të vazhdojë të investojë së bashku me njësitë e vetëqeverisjes lokale në hapjen e shërbimeve për mbrojtjen e viktimave nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në çdo komunë në territorin e vendit. Do të zbatohen nga 10 shërbime të reja në nivel vjetor, në mënyrë të barabartë në të gjitha rajonet planore.

Do ta harmonizojmë plotësisht legjislacionin për plotësimin e standardeve sipas Konventës së Stambollit.

Qeveria do të propozojë Ligj të ri të Shqetësimit në Vendin e Punës (mobing) që do të mundësojë mbrojtje reale dhe efektive të punëtorëve nga mobingu dhe do të propozojë ratifikimin e Konventës së Dhunës dhe të Shqetësimit, dhe rekomandimet për dhunën dhe shqetësim të Organizatës Ndërnacionale të Punës, të miratuar në vitin 2019.

Do të luftojmë kundër hendekut gjinor në rroga, duke krijuar politika dhe masa punësimi që do të zvogëlojnë pasivitetin e grave në tregun e punës, politika që rregullojnë pushimin prindëror, mbrojtjen e vendit të punës, orët fleksibël të punës dhe punën me orar të shkurtuar dhe punë të përshtatura për nënat, duke rritur disponueshmërinë e çerdheve sidomos në zonat rurale dhe duke rritur numrin e shtëpive të pleqve në të gjitha rajonet planore.

Do të miratohet një program për riintegrimin e grave - viktime të dhunës, që do të përfshijë modele për strehim të përkohshëm, këshillim psikologjik me mentor, lloje të ndryshme të ndihmës financiare të destinuar posaçërisht për gratë - viktime të dhunës, mundësi për arsimim dhe trajnim në fusha të ndryshme, si dhe masa punësimi të përcaktuara në legjislacionin ekzistues ligjor.

Do t'u bëjmë thirrje të gjitha organizatave joqeveritare dhe aktivistëve që të tregojnë format ekzistuese të diskriminimit dhe krijimit të paragjyqimeve në arsimin fillor dhe të mesëm.

Qeveria do të angazhohet për rritjen e qasjes në shërbime cilësore të planifikimit familjar dhe zgjedhjen e metodave dhe të mjeteve bashkëkohore kontraceptive (në një listë pozitive të barnave), uljen e kufirit të moshës për shqyrtimin e shëndetit riprodhues, vendosjen e klinikave gjinekologjike të lëvizshme në zonat rurale dhe në komunat më të vogla ku nuk ka gjinekologë, pako të detyrueshme shëndetësore (PDSH) falas për gratë mbi 35 vjeç, që përfshin kontroll gjinekologjik dhe mamografi.

Ne do të propozojmë dispozita në Ligjin e Marrëdhënive të Punës që do të përcaktojnë dhe rregullojnë pushimin e lehonisë, pushimin e atësisë dhe do të mundësojmë leje prindërore të përbashkët fleksibile për të dy prindërit, punë nga shtëpia nëse njëri prej prindërve e ndërpret pushimin dhe kthehet më herët në punë me iniciativën e vet, dhe nëse detyrat e punës e lejojnë atë. Do të sigurojmë lehtësim për prindërit e vetëm nga puna e natës.

## **Rendi dhe drejtësia**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e përkushtuar që të ndërtojë një shtet të aftë, me institucione më të qëndrueshme e që do të garantojnë rend dhe sundim të ligjit. Pasi në këto dy vjet e gjysmë i liruam institucionet nga kapjet partiake dhe investuam në ligje të ndryshme dhe në sistem të përgjegjshëm, tani përqëndrohemi në politikat e mëposhtme:

Do të zbatojmë konceptin e ri të sigurimit në trafik "Qyteti i Sigurta", sidomos në qendrat urbane. Kjo nënkupton rregullim të qartë dhe të rreptë të shpejtësive në zonat e populluara, instalimin e sistemit të kamerave për kontrollin e rrespektimit të rregullave dhe shpejtësive, automatizimin e plotë të procesit të gjobitjes dhe detyrimin e gjobave për regjistrimin e makinës. 'Qyteti i Sigurtë' do të fillojë në udhëkryqet dhe bulevardet kryesore dhe gradualisht do të zgjerohet në të gjitha qendrat urbane. Do të instalojmë radarë dhe kamera të lëvizshme në rrugë, sepse numri i madh i viktimeve të aksidenteve të trafikut shpesh është rezultat i shpejtësisë së pa rregulluar dhe mosrrespektimit të kufizimeve.

Do t'i modernizojmë edhe pikat kufitare duke instaluar lexues digjitalë të targave. Sistemi i mbikëqyrjes për vijën kufitare do të forcohet duke rritur numrin e kamerave të lëvizshme, me këtë do të racionalizohen burimet njerëzore dhe do të arrihet efikasitet dhe kontroll më i madh mbi kufijtë.

Qeveria do të propozojë ligje ku parashihen afate për pagesën e gjobave që nuk do të varen nga "faktori njerëzor". Do të mbrohen të gjitha të dhënat, regjistrimet, fotografitë, por do të mund të përdoren për të përcaktuar përgjegjësinë e mundshme të atyre që mbrojnë një sjellje të tillë. Gjobat në trafik do të shkallëzohen dhe do të lidhen me të ardhurat dhe pasurinë e të ndjerit.

Do ta finalizojmë konceptin "Polici i lagjes" duke plotësuar të gjitha vendet për policë të uniformuar dhe duke përdorur përvojën nga pilot projektet në disa komuna. Prania më e madhe e policëve të uniformuar në lagjet tona, do të dekurajojë kriminelët dhe do të qetësojë qytetarët. Njëkohësisht, do të krijojë bashkëpunim më të ngushtë midis qytetarëve dhe policisë.

Rendi në vend nuk varet vetëm nga policia dhe gjyqësori. Ai gjithashtu reflekton në respektimin e rregullave në çdo hap: në dyqan dhe barnatore, në punët komunale dhe në afarizëm, në zhurmën dhe pastërtinë ... Institucionet kryesore në atë fushë janë inspektoratet. Qytetarët dhe afaristët ende kanë mosbesim të madh në efikasitetin dhe paanshmërinë e inspektorateve shtetërore dhe lokale. Për këtë arsye, do të reformojmë sistemin dhe rregullat në mbikëqyrjet inspektuese. Një Zëvendëskryeministër do të bashkërendojë të gjitha inspektoratet. Për një vit, pothuajse do të përgjysmojmë numrin e inspektorateve dhe do të dyfishojmë numrin e inspektorëve të mjedisit jetësor dhe inspektorëve të tregut. Rregullat duhet të vlejné për të gjithë, sidomos ata që paguhen për t'i zbatuar dhe kontrolluar ato, dhe për këtë arsye, të gjithë inspektorët që kanë fshehur ose nuk kanë vepruar në ndonjë rast të veçantë, do të mbajnë përgjegjësi. Qeveria do të prezantojë platformën "e-inspektori" dhe do ta zbatojmë në të gjitha shërbimet e inspektimit, në mënyrë që të eliminojmë diskrecionin dhe subjektivitetin në kryerjen e mbikëqyrjeve inspektuese. Gjithashtu, do të detyrojë të gjithë inspektoratet të publikojnë raportet mujore me të dhëna të sakta kur, ku dhe me çfarë rezultati janë kryer inspektimet. Një herë në muaj ata do të kenë një takim me BNJVL-në dhe OJQ-të e interesuara për rezultatet dhe problemet me të cilat përballen.

Qeveria do të vendosë polici komunale nën kompetenca të qeverisjes lokale, e që do të ketë fuqi ligjore për të siguruar rendin në komunat tona dhe qytetin e Shkupit. Policia komunale do të jetë metodë më e thjeshtë dhe më e lirë për të siguruar rendin jashtë shtëpive dhe do ta lirojë policinë të merret me çështje më të ndërlikuara të sigurisë dhe kimit. Pensionistët (sidomos nga policia dhe ushtria) do të mundën të angazhohen në policinë komunale, të cilët do të vazhdojnë të marrin pensionin dhe gjithashtu do të marrin një shumë pagese për angazhimin (në të cilën do të llogariten dhe paguhen kontributet përkatëse).

Rendi në vend nuk vendoset vetëm duke ndryshuar ligjet, por shumë shpesh "zonat gri" në to dhe veçanërisht mospërputhja e tyre e ndërsjellë lë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe standarde të ndryshme. Kjo nga ana tjetër ushqen korrupsionin dhe mosbesimin në sistem. Prandaj, një njësi e veçantë e Delivery unit (ekip që jep rezultateve konkrete), do të fillojë të funksionojë drejtpërdrejt nën Kryeministrinë, me qëllim që të kontrollohet legjislacioni dhe të gjenden zgjidhje ligjore të qarta dhe të padryshueshme. Ekipi do të përfshijë ekspertë nga shkenca dhe praktika, dhe ne do t'u bëjmë thirrje OJQ-ve, shoqatave, dhomave dhe sindikatave që vazhdimisht të bëjnë propozime për çështje që duhet të përcaktohen më mirë.

### *Shtet funksional i së drejtës*

Demokracia bazohet në shtetin e së drejtës dhe pavarësinë e gjyqësorit ndërsa zbatimi i ligjit duhet t'i shërbejë nevojës për sundim dhe drejtësi. Të gjithëve u duhet sistem drejtësie që mbron liritë dhe të drejtat tona dhe një sistem i përbashkët vlerash.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e përkushtuar fuqimisht në reforma të thella dhe thelbësore në gjyqësor. Vetëm në atë mënyrë do të mundësojmë sundimin e ligjit, dhe jo të fuqishmit, dhe luftë të skajshme kundër kimit në vend. Do të zbatojmë vazhdimisht Strategjinë e Reformave në Gjyqësor, që do të jetë investimi ynë në bisedime efikase dhe të suksesshme me Bashkimin Europian.

Qeveria ka një pajtueshmëri të plotë që është e domosdoshme për "pastrim" efektiv dhe objektiv të gjyqësorit. Hapi i parë i vetingut tashmë është ndërmarrë me kompetencën e Komisionit Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit për të shqyrtuar statusin e pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë. Këshilli Gjyqësor nga ana e vet, në pajtim me ligjet e reja, ka lajmëruar kontrollim

të hollësishëm të punës së gjyqtarve, sidomos në lidhje me disa veprime në lëndë që thuajse u parashkruan për shkak të shtyerjeve, seancave të rralla dhe të ngjashme. Kontrolli mund të përfshijë të kaluarën personale dhe profesionale, profesionalitetin dhe rezistencën ndaj grupeve të interesit.

Këto kontrole nga institucionet ekzistuese dhe bazat ligjore tashmë të vendosura, paralajmërojnë se rezultatet mund të jenë të shpejta dhe efikase dhe të sigurojnë funksionimin e shtetit të së drejtës dhe zgjidhjen e problemeve sistematike që zvarriten prej kohësh në gjyqësorin vendas.

Qeveria do të angazhohet për të siguruar mbikëqyrjen e BE-së për lëndët gjyqësore që kanë të bëjnë me korrupsion të lartë, sa më shpejt që mundet. Ishim vendi i parë në rajon që i kërkuam BE-së të fillojë menjëherë një nismë të mbikëqyrjes së lëndëve gjyqësore lidhur me korrupsionin e lartë. Komisioni Europian e mbështeti këtë dhe njoftoi fillim të shpejtë të këtij instrument. Konsiderojmë se ky hap do të rrisë përgjegjësinë e prokurorëve dhe të gjyqtarëve, do të forcojë luftën kundër korrupsionit, por edhe do të rrisë besimin e qytetarëve në vendin e tyre dhe institucionet e tij.

Qeveria do të propozojë gjithashtu një detyrim ligjor për publikimin e incizimeve zanore të gjykimeve të korrupsionit të lartë dhe të krimit të organizuar. Publiku është aleati ynë më i fortë në luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Prandaj, do të krijojmë detyrim ligjor për të publikuar incizimet zanore të të gjitha gjykimeve për të cilat ka një interes më të gjerë publik, si një pengesë shtesë e vullnetarizmit, e mosobjektivitetit dhe e parregullsisë në zbatimin e procedurës gjyqësore.

Qeveria, si në mandatin e kaluar, do të mbështesë krijimin e komisioneve anketuese ose fillimin e mbështetjes dhe të mbikëqyrjes ndërkombëtar për raste të caktuara që krijuan mosbesim ndëretnik dhe tensione të tilla si Alfa, Monstra, Lagja e trimave etj.

Gjithashtu do të propozojmë detyrime ligjore me të cilat Prokuroria Publike do të duhet të informojë rregullisht dhe vazhdimisht publikun për punën e saj dhe përparimin në rastet që përcillen nga qytetarët. Vetëm me punë transparente do t'i dalim ndaj krimit dhe korrupsionit, por edhe ndaj mosbesimit të qytetarëve në shtetin e së drejtës.

Qytetarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut shpesh heqin dorë nga mbrojtja gjyqësore e të drejtave të tyre për shkak të tarifave të larta gjyqësore. Do t'i ulim këto tarifa të larta sepse e bëjnë drejtësinë të paarritshme për qytetarët. Në procedurat gjyqësore ku paditet shteti për shkelje të të drejtave të qytetarëve, tarifat gjyqësore do të paguhen vetëm pas përfundimit të procesit, nëse gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje.

Sistemi AKMIS duhet të jetë i centralizuar dhe gjykatat të lidhen vertikalisht dhe horizontalisht. Komunikimi i tyre me njëri-tjetrin duhet të jetë i pandërprerë dhe elektronik, ndërsa qendra e informatikës në Gjykatën e Supreme duhet patjetër të jetë e forcuar me staf dhe teknikë, për të garantuar sigurinë e të dhënave. Kështu, do të vendoset komunikim elektronik me prokuroritë publike, komunikimi i detyrueshëm elektronik me avokatët, përmbaruesit, noterët, ndërmjetësit, Agjencinë e Kadastrës dhe të Patundshmërive, Regjistrin Qendror, Zyrën e Avokatit të Shtetit dhe me subjekte tjera.

Qytetarët po e humbin besimin në sistem kur vazhdimisht dëgjojnë për akuza penale dhe hetime për veprime të caktuara kriminale, dhe më pas nuk shohin ndonjë veprim ose rezultat. Ata kanë një ndjenjë se e vërteta humbet më lehtë në labirintin e prokurorit publik. Nga ana tjetër, Prokuroria Publike përballet me teknologji informatike shumë të dobëta dhe të vjetëruar në përpunimin e të dhënave të prokurorive publike. Për momentin, ekzistojnë kompjuterë dhe një program pune në prokuroritë publike (Case Management System), por duhet të saktësohet baza ligjore në mënyrë që të përcaktohet puna e detyrueshme sipas këtij sistemi, të përcaktohet përgjegjësia dhe të eliminohet mundësia e keqpërdorimit. Kështu, me AKMIS në prokuroritë publike, do të jetë e qartë se ku përfundon çdo kallëzim penal, çfarë është ndërmarrë, kush ishte përgjegjës në raste konkrete etj.

Qeveria do të propozojë një model të ri që do të parandalojë keqpërdorimet e sistemit të gjyqtarëve të jurisë nëpërmjet ndryshimit të mënyrës së zgjedhjes, dispozitat mbi konfliktin e interesit, forcimin e përgjegjësisë së anëtarëve dhe procedurat e veçanta të votimit në vendimarrje. Përveç

kësaj, në lighe do të përfshijmë edhe rekomandimet e Raportit të OSBE-së të Mbikëqyrjes së Rasteve të Caktuara.

Në tre muajt e parë, Qeveria do të rishikojë sistemin e ekzekutimit të masave alternative, të vendosur sipas Kodit Penal, e që u tregua jofunksional në praktikë. Kjo do të sigurojë mbikëqyrje efektive të personave të cilët janë liruar me kusht ose që janë dënuar me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, kryerje të suksesshme të arrestit shtëpiak dhe të masës së arrestit shtëpiak (mbikëqyrja elektronike e personave të dënuar), si dhe parandalim të arratisjes së tyre nga shteti.

#### *Ndal keqpërdorimeve*

Korrupsioni dhe keqpërdorimet politike janë armiqtë më të mëdhenj të qytetarëve dhe institucioneve. Ata dëmtojnë buxhetin, prishin shtetin e së drejtës, dobësojnë institucionet dhe kërcënojnë demokracinë, duke krijuar mosbesim tek qytetarët. Drejtësia, barazia dhe liria janë viktimat e para të keqpërdorimeve politike dhe korrupsionit. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të drejtojë betejën nëpërmjet transparencës së gjerë dhe të detyrueshme, mbrojtjes së lirisë së mediave, përkrahjes institucionale të fortë dhe për një Komision Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit (KSHPK) të pavarur, dhe zero tolerancë për keqpërdorimet e zbuluara. Qëllimi ynë është të ndërtojmë sistem që parandalon keqpërdorimet dhe përcakton qartë përgjegjësinë. Do të forcojmë qytetarët dhe institucionet dhe do të zvogëlojmë të drejtat dhe pushtetin diskrecional të politikanëve dhe bartësve të autoritetit publik.

Qytetarët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj keqpërdorimeve nga personat në detyrë, dhe atë me të drejtë. Askush nuk duhet të jetë mbi ligjin, ndërsa personat në detyrë duhet ta dëshmojnë atë me shembullin e tyre. Do të propozojmë ndryshime në Kodin Penal që do të forcojë politikën ndëshkuese për veprimet që lidhen zakonisht me bartësit e funksioneve.

Për më tepër, do të zvogëlojmë privilegjet e zyrtarëve publikë, me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të funksionit për qëllime personale, uljes së shpenzimeve buxhetore dhe do të rrisim efikasitetin në kryerjen e funksionit.

Qeveria do të propozojë obligim ligjor për publikësim të të gjitha shpenzimeve zyrtare të të gjithë funksionarëve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, lokal dhe gjyqësor. Askush nuk ka të drejtë të fshehë arsyet dhe për çfarë shpenzohen paratë e qytetarëve.

Përveç kësaj, krahas spastrimit të gjyqësorit, qeveria do të propozojë krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të origjinës së parave dhe kapitalit të secilit ish-zyrtar dhe aktual, me anë të një sistemi që do të marrë parasysh praktikatat më të mira të BE-së.

Do të përkrahim zbatimin e një sistemi të përcjelljes elektronike të rasteve që dalin nga ankesat për korrupsion dhe me anë të vendimeve të qeverisë dhe të kuvendit, do të kujdesemi që vendimet e zyrtarëve sipas gjykimit të tyre, të jenë vetëm brenda funksionimit të nevojshëm dhe të pandërprerë të organit që e kryeson zyrtari.

Në vitin e parë të mandatit të ri, Qeveria do të miratojë një strategji të re të të dhënave të hapura, që do të vendosë objektiva të qarta dhe më të larta të transparencës për të gjitha institucionet dhe njerëzit e tyre të parë. Përmbushja e tyre do të jetë kusht për çdo udhëheqës (ministër apo drejtor) për të mbajtur pozicionin e tij.

Të dhënat e hapura nënkuptojnë mënyrë të thjeshtë të qasjes te ato. Sektori publik ka dy detyra: të hapë të dhëna për publikun, por edhe t'i bëjë ato të thjeshta dhe të qarta për qasje. Deri në vitin 2024, do të sigurojmë standard të vetëm për shfaqjen dhe qasjen e informacionit në faqet e internetit të institucioneve të sektorit publik, duke përfshirë një mënyrë standarde të kërkimit dhe të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Në gjashtë muajt e parë do të modernizojmë faqet e internetit të ministrive dhe të qeverisë, dhe do të rrisim numrin dhe cilësinë e të dhënave. Qasja do të jetë zhvillimi i mëtejshëm i të ashtuquajturës transparenca aktive.

Të gjitha NJVL-të që do të marrin fonde nga buxheti do të duhet të pranojnë rregullat e hapjes dhe llogaridhënies, nëse duan të përdorin paratë e qytetarëve nëpërmjet buxhetit qendror.

Qeveria do të propozojë ndryshime në Kodin Zgjedhor që do të prezantojë parimin e listave të hapura në zgjedhjet e ardhshme lokale. Zgjedhja e drejtpërdrejtë do të nënkuptojë një lidhje më të madhe e të zgjedhurve me bashkëqytetarët e tyre, në vend të një lidhje të fortë dhe varësie vetëm nga partitë politike.

Prandaj, do të vendosim analizë të forcuar nga ana e DHP-së, për të ardhurat dhe shpenzimet e noterëve / përmbaruesve e që do të jetë bazë e kontroleve të hollësishme, e ndryshimeve dhe e plotësimeve të tarifave të tyre dhe kontroll të thellë të lidhjeve të paligjshme në këtë veprimtari jashtëzakonisht të ndjeshme për qytetarët.

#### *Administratë moderne dhe efikase: më shumë sistem, më pak burokraci*

Të gjithë qytetarët dhe të gjitha ndërmarrjet afariste meritojnë plotësim të shpejtë dhe efikase të nevojave dhe kërkesave të tyre, pa procedura, dokumente dhe ofrues të panevojshëm. Njëkohësisht, administrata publike meriton organizim të mirë, nëpunës profesionistë, të motivuar dhe të paguar si duhet. Prandaj, qëllimi i qeverisë do të jetë krijimi i një administrate publike efikase profesionale, bazuar në digjitalizimin e shpejtë, strukturën optimale dhe proceset e teknikave inovative. Kështu do të arrijmë: shërbim më të shpejtë, cilësi më të mirë dhe qasje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe subjektet afariste.

Pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19 tregoi se shërbimet digjitale dhe digjitalizimi i administratës publike, jo vetëm që janë të mundshme por edhe të dobishme, sidomos në kohë krizash, kur të gjitha shërbimet ofrohen me gjysmën e kapacitetit.

Digjitalizimi dhe inovacioni janë reforma kryesore të administratës publike bashkëkohore, europiane, duke ndihmuar qytetarët dhe komunitetin e afarizmit të marrin më së shumti nga teknologjitë digjitale. E-Qeveria efektive siguron një spektër të gjerë përfitimesh, përfshirë efikasitetin më të madh dhe kursimet e buxhetit, rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjen më të madhe të qytetarëve dhe komunitetit të afarizmit në bërjen e politikave. Në këtë kontekst, Qeveria konsideron se administrata publike duhet të sigurojë shërbime digjitale, si një zgjedhje e detyrueshme; nuk duhet të kërkohej nga qytetarët dhe komuniteti i afarizmit asnjë informacion ose e dhënë që tashmë është siguruar, duhet të dizajnohen shërbime publike që sipas përkufizimit janë gjithëpërfshirëse dhe i plotësojnë nevojat e grupeve të cënueshme, siç janë të rriturit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Digjitalizimi nuk mjafton. Ai nuk është i mundur nëse nuk e ndryshojmë qasjen dhe kuptimin e administratës për rëndësinë, rolin dhe përgjegjësinë në shtet. Administrata Publike mund dhe duhet të jetë profesionale, inovative, e qëndrueshme, transparente dhe të bashkëpunojë me njëri-tjetrin në mënyrë që të zbatojë reforma të suksesshme dhe të përmbushë pritshmëritë e mëdha për shërbime më të mira publike për qytetarët dhe komunitetin e afarizmit. Administrata duhet të jetë e fortë, por jo për të penguar, por për të përshpejtuar proceset demokratike, ekonomike dhe të zhvillimit. Ka profesionistë të shkëlqyeshëm në administratën tonë, por ka shumë nga ata që besojnë se nuk kanë asnjë detyrim apo përgjegjësi ndaj qytetarëve dhe shtetit. Struktura e institucioneve dhe vendosja e tyre nuk është aspak optimale dhe krijon labirinte pa fund, që në vend se të mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe të ndihmojnë ekonominë, bëhen frenuesit e tyre.

Në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të sigurojë zbatim efikas dhe cilësor të procesit të promovimit të përfaqësimit të drejtë dhe të përshtatshëm në administratën publike. Ai gjithashtu përfshin organet që nuk janë të rregulluara sipas Ligjit të Administratës Publike dhe Shtetërore, në të gjitha nivelet e qeverisjes qendrore, si dhe në shërbimet publike ose ndërmarrjet me autorizim publik. Në gjashtë muajt e parë, të gjithë punonjësit nga Marrëveshja Kornizë do të sistemohen dhe do të shkojnë në punë në institucionet shtetërore, ndërkaq institucionet do të miratojnë kërkesat e punonjësve për njohjen e arsimit në përputhje me

ndryshimet e fundit në Ligjin e të Punësuarve në Administratën Publike dhe në Sektorin Publik. Përkatësia etnike nuk do të keqpërdoret gjatë punësimit.

Qeveria do të përqendrohet në ndryshimin e kushteve të lartpërmendura, me ndryshime në strukturën, cilësinë dhe madhësinë e administratës. Ne do të shqyrtojmë disa modele për zvogëlimin e vëllimit të administratës me 20%, duke bashkuar funksionet dhe përgjegjësitë e institucioneve, daljen në pension në 64 vjet (me përjashtimet e përmendura), pako për transferimin e tyre në sektorin privat ose pensionin e parakohshëm, etj. Do të përqendrohemi në punësimin e stafit cilësor dhe mbajtjen e tyre në shërbimin shtetëror, zhvillimin e karrierës dhe trajnimin e tyre, shpërblimin dhe rrogat, motivimin.

Reformat kanë nevojë për udhëheqës të vërtetë. Ne do të vendosim kritere moderne për emërimin, zgjedhjen ose emërimin e zyrtarëve të lartë në mënyrë që të vendosim kushte të barabarta për personat e zgjedhur dhe të emëruar. Besojmë se profesionalizimi dhe depolitizimi i administratës publike duhet të fillojë nga lart, prandaj po krijojmë një shërbim të të lartë drejtues. Qeveria do të fillojë me ndryshime të guximshme në administratë, që do të përfshijnë:

- Riorganizimi të plotë të administratës publike, i cili do të fillojë në vitin 2020. Do të eliminojmë çdo mbivendosje të kompetencave midis institucioneve dhe do të prezantojmë një vartësi të qartë hierarkike në përputhje me rolin e institucionit (politikëbërësi, zbatuesi i politikave, inspektori). Do të kemi një plan të qartë për bashkimin e institucioneve ekzistuese, shfuqizimin e institucioneve ekzistuese ose krijimin e institucioneve të reja.
- Qëllimi është optimalizimi dhe pakësimi i pritshëm i numrit të institucioneve, zvogëlimi i shpenzimeve operative, përmirësimi i menaxhimit dhe përfundimisht rritja e efikasitetit në funksionimin dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e afarizmit.
- Përkufizimi i qartë dhe i konsiderueshëm i kompetencave në të gjitha nivelet në administratë. Kjo do të zvogëlojë ndjeshëm centralizimin e paqëndrueshëm në administratë, që ngadalëson të gjitha proceset, por gjithashtu krijon një atmosferë papërgjegjësie dhe vesi të "pritjes nga lart". Nëse të gjitha vendimet merren nga një person, ai institucion nuk është as funksional dhe as i qëndrueshëm. Do të përcaktohet qartë se çfarë bie në kompetencat e një ministri, sekretari shtetëror, shefave të departamenteve dhe departamenteve. Kjo do të ndërtojë një kulturë kontributi dhe përgjegjësie për secilin punonjës.
- Koncept i ri në menaxhimin e mesëm: jo më menaxherë deri në pension! Qëllimi është krijimi i një sistemi të ri për menaxherët e mesëm, bazuar në analiza të hollësishme dhe praktikat më të mira europiane, që do të sigurojë një lëvizshmëri më të madhe dhe motivim më të fortë për të arritur rezultate më të mira.
- Rroga më të larta - shpërblim për rezultatin. Të gjithë punonjësit në institucion do të jenë në gjendje të marrin shtesa rroge prej 5% nëse arrijnë qëllimet që qeveria do t'i përcaktojë si detyrë në fillim të vitit. Kjo do të nxisë administratën për të dhënë më të mirën e saj, dhe nga ana tjetër si publiku ashtu edhe afaristi nuk do të kenë përshtypjen se po japin më shumë para për të mirëmbajtur një instrument të shtrenjtë dhe të ngadaltë. Ky parim do të fillojë me zbatimin e pagesave nga viti 2022 (për qëllimet e përcaktuara për 2021).
- Përgjegjësi individuale, por vlerësim ekipor. Sistemi aktual i vlerësimit 360 ° i punonjësve në shërbimin administrativ nuk e arrin efektin e përmirësimit të punës, as në drejtim të përgjegjësisë së punonjësve. Qytetarët dhe afaristët nuk janë të interesuar se sa plane strategjike dhe të veprimit i kanë zbatuar formalisht institucionet, por çfarë shërbimesh ofrojnë ata. Për ta nuk ka rëndësi se sa i mirë apo i suksesshëm është menaxheri, por si funksionon ekipi i tij / saj. Pra, do të zbatohet një sistem që i vlerëson institucionet kundrejt plotësisht zyrtar të tabelave dhe zbatimit të planeve strategjike dhe vlerësimit të ekipeve ose departamenteve kundrejt zbatimit të planeve të veprimit.
- E njëjta rrogë për të njëjtën punë. Ne besojmë se të gjithë punonjësit e sektorit publik meritojnë rrogë të barabartë për punë të barabartë dhe përpjekje dhe përgjegjësi të barabartë për punën e tyre. Përveç sistemit të rrogave për punonjësit administrativë, praktikisht nuk ka një sistem tjetër të rrogave në

sektorin publik, që është kaq gjithëpërfshirës, dhe ndryshimet aktuale të rrogave për të njëjtën punë në institucione të ndryshme duken demotivuese për punonjësit, por gjithashtu krijojnë trysni për punësim në institucione ku punonjësit paguhen shumë.

Qëllimi është që ta ndalojmë atë në vitin e parë të mandatit tonë, duke miratuar një ligj plotësisht të ri për rrogat e të gjithë punonjësve të sektorit publik. Për të zbutur efektet e mundshme fiskale dhe sociale, zbatimi i sistemit të ri mund të bëhet në faza, për një periudhë prej të paktën dy vjetësh.

- Duke ndjekur shembullin e Estonisë, Kryeministri do të formojë grupe të vogla (komuniteti akademik, sektori i afarizmit, administrata) të quajtura Njësi të Sistemit të Inovacionit për të ofruar zgjidhje të reja, inovative për problemet sistemike në vend që kanë vazhduar me vite.

- Pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19 tregoi se komunikimi elektronik midis institucioneve është i mundur dhe shumë efektiv. Prandaj, në dy vjet, i gjithë komunikimi midis institucioneve dhe brenda secilit institucion do të kryhet në mënyrë elektronike. Do të adresohen të gjitha rezervat administrative dhe ligjore në lidhje me këtë. Të gjithë punonjësit në administratë do të marrin udhëzime të qarta dhe obligative në këtë drejtim.

- Një Qendër Shërbimesh (NQSH) në çdo qytet duke ndjekur shembullin e NQSH-së në Shkup. Tani do të përqëndrohemi në dhjetë shërbimet më të kërkuara nga qytetarët, disa prej të cilave do të përfundojnë me një produkt plotësisht elektronik (p.sh. certifikatat nga librat amzë).

- Me marrëveshjen e nënshkruar me MasterCard-in e njohur botërisht (e para e këtij lloji), u bëmë një udhëheqës i vërtetë global në zhvillimin dhe zbatimin e certifikatave inovative të vërtetimit digjital të identitetit. Marrëveshja do të nënkuptojë procedura të shpejta dhe pak kohë të shpenzuar të qytetarëve për të marrë dokumente nga institucionet, por gjithashtu nënshkrim dhe aprovim të shpejtë të kërkesave në komunikim me ndërmarrjet private dhe bankat. Të gjitha këto me ndihmën e vetëm një telefoni celular. MasterCard zgjodhi vendin tonë për të zhvilluar më tej teknologjinë që do ta bëjë plastikën të panevojshme. Ajo që dikur kërkonte karta dhe dokumente (të cilat mund të keqpërdoren dhe humbin) tani do të bëhet nëpërmjet një telefoni celular.

- Me zbatimin e Sistemit Elektronik të Automatizimit të Procedurave Administrative BPMS, çdo detyrë pune do t'u caktohet punonjësve qartë dhe saktësisht me mundësinë për të mbikëqyrë ekzekutimin e saj në kohë reale, që do të rrisë efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e punës, ndërkaq promovimi dhe shpërblimi do të bazohet në treguesit dhe kontributin real. Qeveria planifikon të prezantojë një sistem BPMS deri në fund të vitit 2021, në të paktën 30% të organeve të administratës shtetërore dhe deri në fund të vitit 2024 sistemi do të zbatohet në të gjitha organet e administratës shtetërore.

- Në vitin e parë të mandatit të ri do të krijojmë një institucion qendror që do të jetë përgjegjës për bashkërendimin dhe zbatimin e procesit të digjitalizimit në shoqëri, por edhe mbështetjen e plotë IT për institucionet e administratës shtetërore. Me krijimin e një agjencie të tillë, krijojmë një mundësi për avancim dhe përforcimin e vazhdueshëm të njohurive të profesionistëve të IT-së dhe shpërblimin e tyre të duhur.

- Deri në fund të vitit 2020 do të përgatisim një Studim të Fizibilitetit për ndërtimin e një rrjeti optik nacional të transportit për të identifikuar pengesat administrative dhe të përcaktohen propozimet për ndryshimet e duhura në dispozitat ligjore.

- Deri në fund të vitit 2023 do të sigurojmë mbulim të plotë të të paktën një qyteti me sinjal 5G, dhe deri në fund të mandatit, mbulim të 70% të korridoreve kryesore dhe rrjetit rrugor në vend. Kështu, do të parashikojmë kontroll dhe rregullim që do të garantojë sigurinë e qytetarëve, infrastrukturën kritike dhe sigurinë e shtetit.

#### *Qeverisje më afër qytetarëve*

Në mandatin e ri, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë procesin e decentralizimit. Në të shohim demokratizim shtesë të shoqërisë, sigurim dhe ofrim më efikas dhe ekonomik të shërbimeve, por edhe zhvillim të zgjeruar lokal. Çështja është transferimi i kompetencave

në nivelin e menaxhimit (qeverisjes) që është më afër qytetarëve, e që mund t'i kryejë ato në mënyrë më efektive, me burime të përshtatshme financiare dhe përfshirje të garantuar të qytetarëve në vendimmarrje.

Vazhdojmë me politikat e zhvillimit të komunave, përkatësisht decentralizimin fiskal dhe zhvillimin e baraspeshuar rajonal, me qëllim të forcimit të burimet financiare të komunave, por edhe të rritjes së përgjegjësisë dhe transparencës në funksionimin e tyre. Do të diskutohet për mundësitë për rritjen e hises së TVSH-së dhe tatimit mbi të ardhurat personale të alokuara për vetëqeverisjen lokale, me dinamikë të vendosur disavjeçare, me mekanizma të nxitjes së efikasitetit të tyre në rritjen e mbledhjes së pagesave dhe taksave publike komunale. Në këtë drejtim, do të diskutohet rishikimi i metodologjisë së shpërndarjes së fondeve tatimore dhe granteve për komunat.

Do të zbatohet instrumente të reja, më efektive për mbështetjen e komunave, me qëllim të përmirësimit të performancës së tyre. Këtë do ta bëjmë me dy grante shtesë: Granti i Barazimit dhe Granti i Performancës. Me këtë zbatohet një sistem i nxitjes dhe i konkurrencës së komunave, e që sjell shërbime cilësore dhe në kohë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të implementojë Strategjinë e Zhvillimit të Baraspeshuar Rajonal. Për më tepër, do të diskutohet rishikimi i metodologjisë së shpërndarjes së fondeve tatimore dhe granteve nga komunat. Kriteret për zhvillimin e baraspeshuar rajonal do të zbatohen gjithashtu në programet e subvencionimit të ndërmarrjeve për të nxitur zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluara.

Çdo njësi e vetëqeverisjes lokale, që do të përdorë fonde nga buxheti i shtetit, do të duhet të pranojë rregulla të qarta për transparencën në operacionet e saj dhe të vë në dispozicion të opinionit publik të gjitha shpenzimet financiare, nëpërmjet sistemit të Financave të hapura.

Qeveria do të mbështesë një model të Shërbime më të mira dhe më të qëndrueshme të inspektimit të NJVL-së që të përballen si duhet me sfidat në fushën e punëve komunale, ndërtimtari, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve dhe rregullimin e trafikut. Do të rrisim kompetencat e tyre dhe do t'u mundësojmë atyre që të organizojnë veprime të përbashkëta në nivel rajonal dhe shtetëror. Nuk do të mundet që argumentet formale, burokratike të jenë arsye për mosveprim dhe mungesë të mbrojtjes së qytetarëve.

Qeveria do të propozojë zgjidhje ligjore me të cilat qytetarët dhe shoqatat do të kenë mundësinë të propozojnë pika në rendin e ditës dhe të marrin pjesë në punën e Këshillit. Qytetarëve, shoqatave dhe bashkësive lokale do t'u kërkohet të marrin pjesë në miratimin e programeve të zhvillimit dhe buxhetit komunal. Obligimin për konsultime me qytetarët do ta zgjerojmë edhe te programet e komunave.

Do të mbështesim procesin e reformës së shërbimeve me grante dhe kredi të lira për të modernizuar makineritë dhe pajisjet e shërbimeve publike lokale. Në të njëjtën kohë, ndërmarrjet e shërbimeve publike do të obligohen të ndërtojnë kapacitete njerëzore dhe institucionale, që së bashku me infrastrukturën dhe pajisjet janë një parakusht themelor për ofrimin e shërbimeve më të mira dhe me cilësi më të lartë për qytetarët.

Qeveria do të drejtojë një politikë të grupimit të të gjitha investimeve kapitale për NJVL-të në një vend. Do të bashkohen mjetet që dalin nga programet e ministrive dhe agjencive dhe janë të destinuara për projekte komunale, kështu sistemi i bashkërendimit të shpërndarjes së fondeve në përputhje me kriteret e përcaktuara do të kryhet nga Këshilli i Zhvillimit Rajonal të Baraspeshuar. Për shkak të sigurisë më të madhe në planifikimin dhe zbatimin e këtyre investimeve kapitale, do të vendosim buxhetim tre vjeçar.

Qeveria do të sigurojë burime (organizative dhe financiare) për të ndihmuar veçanërisht komunat më të vogla që nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për t'u ballafaquar papritmas me zbatimin e projekteve të mëdha. Në këtë mënyrë do të nxisim zhvillimin lokal dhe rajonal, veçanërisht me anë të

shfrytëzimit maksimal të fondeve të paraanëtarësimit dhe të strukturore e kohezive të Bashkimit Europian.

### *Shoqëri e barabartë për të gjithë*

Besojmë në vlerat e tolerancës, drejtësisë, mundësive të barabarta, njohjes së diversitetit, multikulturalizmit dhe komunikimit ndërkulturor. Besojmë në drejtësinë sociale, mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe arritjen e kohezionit social.

Bashkimi Europian është i bazuar në popuj të ndryshëm, kultura dhe gjuhë të ndryshme, por ai flet dhe funksionon në parimin e BASHKIM PËRMES DALLIMEVE. Ne jemi një shembull real që kjo politikë dhe këto vlera mund të funksionojnë edhe në Ballkan. Kjo ishte e mundur sepse nuk i pranuan vlerat si pjesë e *acquis* europiane ose si kusht i tyre, por si besim dhe vendosmëri që mozaiku ynë i kulturave, gjuhëve dhe zakoneve na bën më të pasur dhe më të mirë.

Lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, Qeveria do të përfundojë formimin e Agjencisë dhe të Inspektoratit në gjashtë muajt e parë të mandatit. Në të njëjtën kohë, Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve mes Bashkësive do të vihet në funksionalitet të plotë dhe do të kompletohet.

Si Qeveri, do të vazhdojmë me politikat që promovojnë vlerat e komunitetit dhe besimin ndëretnik. Në komunat shumetnike do të rrisim përmbajtjet në fushën e arsimit dhe kulturës që kontribuojnë në afrimin e qytetarëve. Shkollat dhe institucionet kulturore që kanë përmbajtje të tillë do të marrin fonde shtesë për funksionimin dhe zhvillimin. Do të financojmë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë deri në 25 vjeç të cilët dëshirojnë të mësojnë maqedonisht, shqip, turqisht, vllahisht, serbisht ose romak.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në muajin e parë përsëri do të propozojë Ligjin Mbrojtjes dhe të Parandalimit të Diskriminimit, si një simbol i përkushtimit tonë ndaj vlerave europiane në këtë fushë. Qeveria do të forcojë mekanizmat institucionalë për të luftuar të gjitha format e diskriminimit.

Qeveria do të ftojë, nxisë dhe bashkëpunojë me sektorin e afarizmit, pra me ndërmarrjet vendase dhe të huaja, për të mbështetur marrëdhëniet e mira ndëretnike dhe vlerat e tolerancës, përfaqësimit dhe besimit të ndërsjellë në mjediset e tyre të punës, në mënyrë që të përdorin potencialin e plotë njerëzor të vendit tonë.

Qeveria do të vazhdojë të zbatojë Strategjinë e Integritimit Ndëretnik dhe të Përfshirjes Qytetare dhe do të prezantojë një çmim vjetor për idenë / projektin më të mirë që zhvillon dhe promovon konceptin e një shoqërie të barabartë për të gjithë. Ai do të jetë i destinuar për të rinj deri në 30 vjeç dhe do të nxisë punën dhe krijimtarinë e përbashkët. Do të nxisim prodhimin e filmit për fëmijë dhe të rinj në disa gjuhë. Ne do të kundërshtojmë indoktrinimin fetar, mostolerancën fetare dhe etnike, që prodhohet në pjesë të hapësirës mediatike dhe rrjeteve sociale.

Qeveria do të krijojë Këshillat Nacionale të Komuniteteve që janë më pak se 20% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Kjo do të përfshijë të gjitha komunitetet në procesin e hartimit të politikave dhe të sigurojë përfaqësim më të madh. Do të parashikojmë një procedurë të hapur dhe të gjerë për konstituimin e tyre. Për ato çështje që prekin komunitetet më të vogla, Qeveria do të kërkojë mendimin e Agjencisë së Ushtrimit të të Drejtave të Komuniteteve.

Në fushën e kulturës, Qeveria do të sigurojë mbështetje për institucionet dhe krijimin kulturor të komuniteteve më të vogla, si dhe për projekte që ofrojnë ndërveprim dhe kohezion më të madh.

### **Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i gjelbër**

E drejta për një mjedis të shëndetshëm është një e drejtë themelore qytetare. Ajo që na tregoi dhe mësoi kriza shëndetësore e shkaktuar nga pandemia e virusit COVID-19 është se duhet të

ndryshojmë mënyrën se si i planifikojmë dhe i kryejmë aktivitetet tona. Në nivel global, rekomandimet janë në rritje që kriza shëndetësore dhe ekonomike nuk duhet të nënkuptojnë shtyrjen e politikave mjedisore. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të ndjekë strategjinë dhe planin e ri për ripërtëritjen e përbërësit ekonomik, social dhe ekologjik të Bashkimit Europian në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe humbjes së biodiversitetit, veçanërisht nëpërmjet zbatimit të Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së dhe Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Nuk ka ekonomi pa qëndrueshmëri dhe nuk ka shëndet pa një mjedis të pastër. Kjo do të jetë sfida jonë më e madhe në mandatin e ri: një mjedis i pastër, i shëndetshëm dhe i ruajtur mirë në mbështetje të një ekonomie të qëndrueshme dhe një shoqërie në të cilën jetojnë qytetarë të kënaqur. Kemi nevojë për përparim shoqëror, mjedisor dhe ekonomik që sjell mbrothësi dhe drejtësi për të gjithë qytetarët, por gjithashtu ruan vlerat për brezat e ardhshëm. Kjo do të thotë planifikim dhe kujdes i zgjuar për interesin publik. Kështu, Qeveria do të drejtohet sipas parimeve të mëposhtme: lufta kundër ndryshimeve klimatike globalisht, si një pjesë integrale e të gjitha politikave sektoriale, veprimi parandalues (para se të ndodh dëmtimi, pra ndotja), ndotësi paguan (shpenzimet e mbrojtjes së mjedisit duhet të mbulohen nga personi juridik ose fizik që e rrezikon mjedisin jetësor), luftë kundër keqësisit të mjedisit jetësorë në burimin e ndotjes (ku është më e thjeshtë dhe më ekonomike për t'i mënjeluar pasojat e ndotjes) dhe integrimi i mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera (bujqësi, transport, energji, politikë industriale, etj).

Qeveria do ta arrijë këtë duke planifikuar dhe kryer procese që nënkuptojnë, nga njëra anë, mbrojtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore nga ndotja dhe zvogëlimi i ndryshimit të klimës, dhe nga ana tjetër, zhvillimin e vendit nëpërmjet investimeve të vazhdueshme në ekonominë e gjelbër dhe krijimin e vendeve të gjelbra të punës.

Vizioni për zhvillimin e vendit mund të realizohet me një planifikim cilësor afatgjatë që i jep përparësi interesit publik, harmonizon nevojat e të gjithë sektorëve dhe ofron korniza optimale për zhvillimin ekonomik që do të ketë më pak ndikimin negativ në mjedis. Ne jemi të përkushtuar për një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë bazuar në përdorimin e kujdesshëm të burimeve natyrore. Kontrolli dhe ulja i ndotjes mbetet një nga qëllimet themelore. Kjo përfshin përdorimin e lëndëve djegëse ekologjike shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve, menaxhimin e duhur dhe të drejtë të ujit dhe transportit të gjelbër. E mbështesim ekonominë qarkulluese nëpërmjet së cilës sasi të e mbetjeve do të zvogëlohen për shkak të ripërdorimit dhe riciklimit të materialeve dhe produkteve.

Për të përmbushur këto qëllime thelbësore, Qeveria do të ndër marrë hapat e mëposhtëm:

- Deri në vitin 2024, asnjë institucion shtetëror nuk do të nxeht me sisteme të vjetra dhe jo-ekologjike të ngrohjes. Të gjitha institucionet publike janë të hartëzuara dhe do të merren vendime për zgjidhjet më të përshtatshme: (1) lidhja e ngrohjes qendrore, (2) gazi, (3) përdorimi i kondicionerëve inverter shumë efikas ose (4) pompat ngrohëse.
- Deri në fund të vitit 2020 do të zbatojmë kontroll të përhershëm 24/7 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe inspektorateve lokale, do të rritëzohet kapacitetet shtetërore dhe lokale dhe do të rrisim kompetencat e tyre. Pas akreditimit të metodave, Laboratori Qendror i Mjedisit do t'u vihet plotësisht në dispozicion, dhe Inspektorati Shtetëror do të nënshkruajë, çdo vit, marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë të akredituar të superkontrollit.
- Do t'i ashpërsojmë dënimet vetëm në fushën e mbrojtjes së mjedisit për shkak të përvojës së keqe të pasivitetit të institucioneve dhe kryerjes burokratike të procedurave. Do të ketë përgjegjësi penale për ata që e ndotin mjedisin në mënyrë të paligjshme dhe e rrezikojnë shëndetin për përfitim. Kushdo që konstatohet se ka shkelur rregullat dhe procedurat do t'i merret licenca dhe lejet për shkak të sjelljes së papërgjegjshme dhe mospërmbushjes së obligimeve ligjore.
- Dy vitet e para të mandatit do t'i kushtohen gjelbërimit të planifikuar të përshpejtuar të vendit dhe veçanërisht të qyteteve më të ndotura. Sipas planit, do të ndërtojmë korridore dhe barriera / mure të

gjelbërta në pikat kritike, siç është muri i gjelbër i Qendrës Klinike "Nënë Tereza", një hapësirë më e madhe, e lënë pas dore, do të zëvendësohet me gjelbërim urban dhe pajisje të përshtatshme urbane, obligim për hapësira të gjelbërta përreth objekteve industriale, pyllëzimi në kazerma.

- Nisim ndryshime në politikat e transportit publik. Qeveria do të mbështesë qytetin e Shkupit, që po fillon ndërtimin e sistemit të Transportit të Shpejtë të Autobusëve - transport i shpejtë me tramvaj (me linjë krediti nga BERZH-i). Do të zbatohet një sistem më të ndërlëkuar të subvencioneve dhe lehtësimeve tatimorë për blerjen e automjeteve "ekologjike" (forcë lëvizëse elektrik dhe hibride), zëvendësimin e lëndës djegëse joekologjike me gaz, te mjetet e transportit (veçanërisht te transportuesit e mallrave, taksitët, etj.) dhe blerjen biçikletave.

Në bashkëpunim me qytetet dhe qytetarët, do të vendosim një model ligjor dhe institucional të përparimit të trafikut të biçikletave dhe do të caktojmë zona me emision të ulët ose një zonë të ndalimit të trafikut të automjeteve të rënda, orar të shpërndarjes së mallrave, politikë lokale të parkimit (sidomos pranë ndërtesave publike, para se gjithash kopshteve, shkollave dhe objekteve shëndetësore).

- Qeveria do të investojë në stacione matëse shitesë në të gjithë vendin dhe një aplikacion të veçantë softuerik që do të sigurojë paraqitje më të lehtë dhe më transparent të situatës me grimcat PM, sipas datës dhe vendndodhjes, me kontrole dhe raporte të përshtatshme.

Në 2021 do të zbatohet një sistem katërnivëlësh rreziku për paralajmërimin e hershëm të një parashikimi të favorshëm të motit për shfaqjen e rritjes së ndotjes së ajrit, që do të jetë pjesë e sistemit ekzistues të paralajmërimit të hershëm në DÇHM.

Të dhënat e emetimeve të kapaciteteve të mëdha ndotëse do të jenë në dispozicion të qytetarëve në kohë reale, si dhe Kadastra e Mjedisit Jetësor, regjistrat e shkarkimit dhe të bartjes së materieve ndotëse, regjistrat e lejeve mjedisore të lëshuara dhe e vlerësimeve të aprovuara.

Do të mbështesim nismat për vendosjen e stacioneve të matjes, duke përkrahur kategori të ndryshme të instrumenteve matëse, sipas saktësisë së matjeve të tre, me qëllim të zbulimit të burimeve lokale dominuese të ndotjes së ajrit.

- Do t'i shfrytëzojmë rezultatet e projektit "Mbështetje për Maqedoninë në anëtarësimin në BE në fushën e mjedisit (2019-2021)" nga ku do të ftojme Raport të gjendjes së mbikëqyrjes së cilësisë së ajrit në Maqedoni, me rekomandimet e përfshira të përmirësimit të sistemit, investimet në instrumente të reja të mbikëqyrjes së cilësisë së ajrit dhe / ose riparimit të instrumenteve, rritjen e kapacitetit të ekspertëve të cilësisë së ajrit në Maqedoni për menaxhimin e të dhënave të cilësisë së ajrit, sistemin e përditësuar të menaxhimit të të dhënave dhe raportimin.

- Do të zvogëlojmë vlerat kufizuese të përcaktuara ligjërisht të substancave ndotëse në ajër (në një nivel më të ulët) dhe do të rrisim standardet e cilësisë së karburantit në drejtim të kontrollit të më shumë parametrave. Do të miratojmë një zgjidhje ligjore të përcaktimit të standardit të cilësisë së peletave. Në vitin 2021 do të zbatohet matjen e nxirjes së tymit sipas standardeve të parapara.

- Në vitin 2021 do të miratojmë një ligj për emetime industriale dhe nga viti 2023 do të sigurojmë linja të buta kredie për furnizimin me pajisje dhe teknologji të reja për uljen e ndotjes së mjedisit për kapacitete të vogla, të mesme dhe të mëdha. Për të njëjtën gjë do të sigurojmë lehtësimin e taksave gjatë importit.

- Do të forcojmë mbikëqyrjen ndaj stacioneve të kontrollit teknik të automjeteve, me qëllim të kontrollit të detyrueshëm të shkarkimit të gazrave nga automjetet që regjistrohen. Gjatë regjistrimit të një automjeti të trafikut, që i tejkalon masat e përcaktuara, do të aktivizohet menjëherë kontrolli dhe përgjegjësia e stacionit që e ka miratuar atë, dhe automjeti do të hiqet përkohësisht nga trafiku.

- Do të ndihmojmë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të përshtaten me standardet e reja ekologjike. Do të hartëzojmë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që e përdorin një pjesë të mbeturinave të tyre për ngrohjen e hapësirës, dhe kështu e ndotim ajrin, dhe do t'i ftojme që të marrin pjesë në thirrjen për subvencionimin e 'eko' pajisjeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

- Do të propozojmë një ligj që do të krijojë një polici komunale në nivelin lokal, ku inspektorët e deritanishëm komunalë dhe 'eko' patrullat do të mundën që bashkarisht të ndërmarrin masa ndaj autorët të veprimtarive të dëmshme: hedhja e mbeturinave në vendet që nuk parashikohet për atë gjë, krijimi i deponive të jashtëligjshme me mbetje ndërtimtarie dhe të përziera komunale, djegia e gomave dhe e materialeve të tjera tepër të dëmshme, djegia dhe shkatërrimi i kontejnerëve, etj., me gjoba te detyrueshme. Policia komunale do të fillojë të funksionojë në vitin 2021.

- Në dy vitet e para do të investojmë pesë milionë euro për efikasitet energjetik të ndërtesave publike për të zvogëluar konsumin dhe ndotjen.

- Në ndërtimtari, do të kryejmë kontroll të shpeshtuar të vendeve të ndërtimit dhe respektim e kontroll të kriterëve energjetike dhe të tjera gjatë ndërtimit dhe rindërtimit të objekteve.

- Nëpërmjet projektit "Forcimi i kapaciteteve të nivelit qendror për zvogëlimin e grimcave të forta në ajër nëpërmjet përdorimit të teknologjive bërthamore" nga IAEA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike), me 235,990 euro, do të blihet një instrument që përdor teknologjinë bërthamore për të analizuar përbërjen e grimcave PM, do të blihen mostra të marrjes së gjedheve të ajrit, do të implementohet një fushatë matëse dhe do të përgatitet një studim nacional për të përcaktuar burimet kryesore të grimcave PM në qytetet kryesore në Maqedoni.

- Qëllimi ynë është që deri në fund të vitit 2025 të përpunohen minimalisht 60% e peshës së mbeturinave të paketimit, të gjeneruara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me anë të operacioneve të përpunimit ose të përdoren për prodhim energjie, ndërkaq deri në fund të vitit 2025 të riciklohen minimalisht 55 %, kurse maksimalisht 80% e peshës së mbetjeve të paketimit të gjeneruara dhe mbledhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2020 do të miratojmë Planin Nacional të Parandalimit të Mbetjeve si një synim nacional dhe politik për gjenerimin, zvogëlimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve (2020-2026).

Do të zbatojmë vazhdimisht aktivitete për instalimin e sistemeve në përputhje me gjashtë ligjet e reja për rrjedhje të posaçme të mbetjeve, që të përparojmë në selektimin parësor të rrjedhjes së posaçme të mbeturimave (mbeturina plastike dhe letre, mbeturina pajisjes shtëpiake, mbeturina gomash dhe vajrash, automjete të përdorura dhe mbetje tekstili).

Do të punojmë në një infrastrukturë të integruar rajonale për mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave, me theks të veçantë për grumbullimin ndaras në vendin ku krijohen mbeturinat, për materimaterialet e riciklueshme dhe trajtimin e mbetjeve të biodegradueshme. Zvogëlimi i përgjithshëm për periudhën 2020-2026 i mbetjeve të biodegradueshme që dërgohen në deponi do të jetë 25%.

- Po zbatojmë kontroll të përforcuar të importit dhe eksportit të mbeturinave, mbledhjen, magazinimin dhe trajtimin e të gjitha llojeve të mbeturinave, si dhe kontrollin e jashtëzakonshëm të të gjitha lejeve të lëshuara për menaxhim të mbeturinave. Do t'u bëjmë thirrje OJQ-ve që të na bashkohen, për transparencë dhe rritje të besimit te qytetarët.

- Do të kryejmë kontroll të përforcuar të inspektimit të personave juridikë që kanë licenca për grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e mbeturinave (veçanërisht ato mjekësore dhe llojet e tjera të mbetjeve të rrezikshme), si edhe krijuesit e tyre.

- Në rajonin e Shkupit do të ndihmojmë në rehabilitimin e menjëhershëm të shumicës së deponive ilegale, duke i dhënë përparisë deponisë në Vardarishtë, si dhe pastrimin dhe rikultivimin e vendeve me mbeturina të hedhura në mënyrë të papërshtatshme në zonat urbane dhe rurale.

Do t'i zbatojmë aktivitetet për një sistem të integruar dhe financiarisht të qëndrueshëm të menaxhimit rajonal të mbetjeve të ngurta në rajonin Lindor dhe Verilindor (IPA), blerjen e automjeteve dhe të pajisjeve për mbledhjen e mbeturinave, mbylljen e deponive dhe ndërtimin e një qendre të menaxhimit të mbeturinave dhe gjashtë objekteve lokale të menaxhimit të mbeturinave - stacionet e transferimit.

Do të sigurojmë kushte për krijimin e një sistemi të menaxhimit dhe financimit të sektorit të mbetjeve komunale në rajonin e Juglindor, të Vardarit, Jugperëndimor dhe të Pelagonisë, për menaxhimin dhe ndërtimin e deponive, blerjen e pajisjeve, stacionet e transferimit, mbylljen e deponive ilegale (ndihma

teknike e BERZH-it) . Do të shqyrtohen mundësitë e financimit nga brenda dhe nga BE-ja, si dhe mundësia e një koncesioni ose e një modeli të partneritetit publiko-privat. Vazhdojmë me modernizimin e deponisë në fshatin Rusino në rajonin e Pollogut me ndihmën e fondeve të siguruara nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh midis Qeverisë dhe Zvicrës deri në vitin 2022 (tetë milionë CHF).

- Si mbështetje për autoritetet lokale në luftën për një mjedis të pastër, do të sigurojmë mbështetje të drejtpërdrejtë për furnizimin e 10,000 koshave dhe kontejnerëve në vit.

- Deri në vitin 2024, do të ndalojmë gradualisht përdorimin e qeseve plastike gjatë shitjes me pakicë.

- Deri në vitin 2024, Qeveria do të përgatisë një plan të ri hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për 15 vitet e ardhshme.

- Do të miratojmë një Metodologji të përgatitjes së planeve hapësinore që do t'i përgjigjen sfidave moderne, do të mbrojnë interesin publik dhe kushtet dhe nevojat e shfrytëzimit të hapësirës.

- Do të rrisim cilësinë e jetesës urbane. Në planifikimin urban, gjatë hartimit të Rregullores së re të standardeve dhe të normave të planifikimit urban, do të sigurojmë:

- Toka që është planifikuar ose mbi të cilën është ndërtuar parku ose gjelbërimi mbrojtës ose hapësira rekreative, nuk do të jetë në gjendje të shndërrohet në një qëllim tjetër (strehim, ndërtesa tregtare, ndërtesa publike ose objekte prodhimi ...).

- Dispozita që në rregulloren aktuale lejon që "Zona e ndërtuar në kategorinë e gjelbërimit të parkut ... të jetë në gjendje të shndërrohet në kategori tjetër të vetëm me një plan të përgjithshëm urban" do të plotësohet me obligimin e sigurimit të një zone tjetër të planifikuar më parë, përkatësisht të mos lejohet tkurrja e zonave të planifikuara për qëllimin D1.

- Dispozita të përforcuara për përqindjen minimale të gjelbërimit për frymë në nivelin e planit të përgjithshëm urban, që natyrisht se duhet të harmonizohet me Ligjin e Gjelbërimit Urban, por të përforcuara në aspekt të sigurimit të një përqindjeje minimale të gjelbërimit publik (park, mbrojtje, zona rekreative), ndryshe nga Ligji i Gjelbërimit Urban, ku në një përqindje minimale janë përfshirë sipërfaqjet që përfaqësojnë të paktën 20% gjelbërimit në ngastrat ndërtimore me me kategori të tjera qëllimi.

- Do të inicojmë një ndryshim në ligjin për lëndët e para minerale për të siguruar që, pasi të jetë realizuar shfrytëzimi, është realizuar pastrimi dhe rregullimi i terrenit.

- Do të angazhohemi me zgjidhjen edhe të vatrave të tjera kritike! Do të pastrojmë vatrat industriale – revitalizim të deponisë së mbetjeve industriale në xeheroren e Radushës dhe Jegunovcës. Sistemi SKADA dhe stacioni i pompës në deponinë e Jegunovcës do të mirëmbahen rregullish dhe do të pastrohet bazeni i sedimenteve në stacionin e trajtimit në Jegunovcë.

- Do të kryhet pastrimi i vatrës industriale, përkatësisht do të zgjidhet problemi me lindanin në uzinën kimike OHIS, Shkup, (mënjani nga një prej dy lokacioneve, me teknologji të përshtatshme dhe rivitalizimi i vendit) me 15.5 milionë dollarë. Do të kryhen testime në pikën e tretë deponuese në OHIS.

- Procedurat për dhënien e koncesioneve të shfrytëzimit të ujit, për nxjerrjen e rërës, haliçit dhe gurëve nga shtrati i lumenjve do të jepen një herë në vit, me dëgjime publike dhe pjesëmarrje të publikut të prekur.

- Ndalimi i ndërtimit të hidrocentraleve të rinj të vegjël në zonat e mbrojtura dhe parqet nacionale.

- Do të rishikohet përcaktimi institucional dhe ndarja e kompetencave në mënyrë që të sigurohet një mbikëqyrje gjithëpërfshirëse e gjendjes dhe e cilësisë së ujërave.

- Ndalimi i ndërtimit të hidrocentraleve të rinj të vegjël në zonat e mbrojtura.

- Qeveria do të mbështesë ndërtimin e një stacioni trajtimi për Qytetin e Shkupit (136 milionë euro përfshi 10 milionë euro grant komponentë)

Deri në vitin 2022 do të përfundojmë me: rindërtimin e rrjetit të kanalizimeve në komunën e Kërçovës, ndërtimin e një stacioni trajtimi dhe rindërtimi i rrjetit të kanalizimeve në Tetovë dhe Manastir, lidhjen e komunës së Vinicës me stacionin e trajtimit në Koçan.

Deri në vitin 2021 do të përfundojmë me: masat e pastrimit dhe të rindërtimit të kolektorit dhe stacionit të trajtimit në Dojran dhe Vranishtë, Ohër.

- Do të sigurojmë furnizim me ujë dhe kanalizim në zonat rurale dhe urbane pa qasje në ujë të pijshëm. Do të sigurojmë tualete të thata në shkollat rurale ku ky problem nuk është zgjidhur dhe ku nuk ka qasje në ujë. Këto nuk janë zëvendësim i atyre tradicionalë, por janë ekologjike, të qëndrueshëm dhe të sigurt për shfrytëzuesit dhe për mjedisin jetësor.

- Do të rrisim përqindjen e zonave të mbrojtura, nëpërmjet vlerësimit të zonave për mbrojtje dhe rivlerësimi i zonave të mbrojtura (Mali Sharr, Malet e Osogovës, Kalaja e Çenginës, Liqeni i Ohrit, Këneta e Studençishkës, Vodno, Kanioni i Matkës, etj.). Plani i qeverisë është të zhvillojë Malin e Sharrit si një park kombëtar. Do të vazhdojë identifikimi i propozim-zonave në kuadër të procesit të krijimit të Rrjetit European Koherent Ekologjik Natura 2000.

Do të përpilojen Plane të reja të Menaxhimit të PN Pelisteri, PN Galiçica dhe PN Mavrova. Do të ndihmojmë që burimet natyrore të shfryrëzohen në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet markimit të zonat dhe prodhimeve lokale.

Do të miratojmë Plane të menaxhimit të zonave të mbrojtura (Mali Sharr, Malet e Osogovës, Liqeni i Prespës, Kullat e Markos, etj.) dhe do të përpilojmë një Studim të vlerësimit të vleftës natyrore të Jablanicës. Do të miratojmë Plane Hapësinore të Parqeve Nacionale Pelister, Galiçica dhe Mavrova, dhe do të përpilojmë një Plan Menaxhimi për zonën shumëqëllimore Jasen.

- Po zhvillojmë një Strategji nacionale të zvogëlimin të rrezikut nga katastrofat, në përputhje me Kornizën Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat.

## **Energjia**

Në kemi filluar ta transformojmë ekonominë për sa i përket energjisë. Politika e qeverisë është që të ndryshojë rrënjësisht profilin e energjisë së vendit dhe ta përgatisë atë për sfidat dhe vitet e ardhshme. Dëshirojmë që ajo të jetë e qëndrueshme, e shumëllojshme, e lirë, me burime të qëndrueshme të furnizimit dhe prodhimi vendas të rritet ndjeshëm dhe shumë më tepër se në të kaluarën, për të përmbushur nevojat e brendshme të energjisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka një plan ambicioz që, deri në vitin 2024, mbi 50% e energjisë elektrike të përgjithshme të instaluar në vendin tonë të jetë nga burime të rinovueshme të energjisë. Do të forcojmë pavarësinë dhe stabilitetin tonë energjetik me kapacitete të reja prodhuese të energjisë elektrike dhe ndërlihdjet e reja të energjisë me fqinjët tanë. Paralelisht, do të zvogëlojmë emetimet e gazrave të dëmshëm të burimeve të energjisë me mbi 20%.

Gjatë gjashtë muajve të parë të mandatit të ri, do të shpallet një tender për modernizimin dhe transformimin e TC Negotina, në një impiant që do të përdorë gaz natyror dhe do të sigurojë mundësi për rritjen e prodhimit bujqësor.

Pas tenderit të shpallur për ndërtimin e HC Çebreni, nëpërmjet partneritetit publiko-privat, kemi regjistruar interes të shtuar dhe me të drejtë presim fillimin e ndërtimit të këtij projekti që është përfolur për disa dekada.

Me termocentralet e reja fotovoltaike prej 400 MW, në sistemin e brendshëm të energjisë do të prodhohet energji elektrike e pastër në nivel prej rreth 560 GWh (ose rreth 10% të prodhimit të përgjithshëm vendas), që do të zvogëlojë emetimet e CO<sub>2</sub>-shit në mjedis me rreth 750,000 ton në vit, dhe investimi i përgjithshëm i pritur do të ishte rreth 250 milionë euro. Nga këto, planifikojmë të zhvillojmë 100MW në TC Oslomej. Qeveria do të nxisë inovacionin në teknologjinë fotovoltaike. Me këto politika, do të ndikojmë edhe në hapjen e vendeve të reja të punës për profesionistët në vendin tonë.

Në këtë mandat të qeverisë, planifikojmë të ndërtojmë mullinjë ere për energji, me një kapacitet shtesë prej 160 MW (përveç projekteve që janë tashmë në proces: faza e dytë e Bogdancit dhe

në Miravci 1) dhe termocentralit Miravci 2 dhe 100 MW mullinjë ere në tokën shtetërore me investitorë privatë, një investim prej mbi 150 milionë euro.

Do të rrisim kuotën për ndërtimin e termocentraleve të reja me biogaz 30 MW, për ata investitorë që do të hapin fabrika blegtorale ose do të organizohen në kooperativa. Sasia e kapacitetit të instaluar për ndërtimin e një termocentrali të biogazit do të varet nga madhësia e fermës së bagëtive ose e kooperativës. Prodhimi vjetor i pritshëm i energjisë elektrike nga këto termocentrale do të ishte rreth 150 GWh, dhe investimi i përgjithshëm, vetëm në termocentralet e biogazit, pa ferma blegtorale dhe bujqësi, do të ishte në nivelin e rreth 90 milionë euro.

Në mandatin e ri do të zbatohet projektet e mëposhtme brenda SHA ESM-së:

- Rivitalizimi dhe modernizimi i të tre blloqeve në REK Manastiri, me pakësimin e pluhurit dhe desulfurizimin.
- Rivitalizimi dhe modernizimi i bllokut 1 në REK Manastiri për të pakësuar emetimet e oksidit të azotit dhe për të hapur mundësinë e përdorimit të llojeve të ndryshme të karburantit.
- Modernizimi dhe rehabilitimi i kullave ftohëse në REK Manastiri, që të rritet efikasiteti i tyre dhe të zëvendësohen materialet e çimentove të azbestit me materiale të pranueshme ekologjike.
- Blerja e mekanizmit ndihmës për minierat në REK Manastiri dhe pajisje për sistemin e shfrytëzimit të ndërprerë (një pjesë e blerjes është në proces).
- Përgatitjet për hapjen e minierës së Zhivojnës.
- Rivitalizimi i hidrocentraleve të mëdhenj ekzistuese.

Do të rindërtojme plotësisht rrjetin e energjisë përçuese, por gjithashtu do të ndërtojme linja të reja përçimi, me çka MEPSO-në do ta bëjnë një qendër rajonale të përimt të energjisë elektrike. Plani është që të realizojmë projektet e mëposhtme: linja e re ndërlidhëse largpërçuese prej 400 kV Manastir (MK) - Elbasan (AL) dhe stacioni transformator prej 400 kV në Ohër; linja e re ndërlidhëse përçuese prej 400 kV që do të ndërtohet pranë termocentralit të ardhshëm Çebren së bashku me stacionin transformator prej 400kV pranë termocentralit dhe forcimin e rrjetit elektrik në të gjithë vendin me linja të reja përçimi dhe stacione transformatorësh, në mënyrë që të mundësojë investime të reja në termocentralet fotovoltaike dhe me erë në të gjithë shtet.

Duke ndarë aktivitetet e telekomunikacionit nga funksionet themelore të SHA MEPSO, do të ndajmë infrastrukturën e linjës së gjerë dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë operatorët që do të dëshirojnë të përdorin të ashtuquajturën Autostrada Digjitale Ballkanike.

Në tre vitet e fundit, me një punë të palodhshme dhe të vazhdueshme, e kemi hartuar dhe filluar realizimin e tubacionit të gazit për ndërlidhje me fqinjin tonë Greqinë, ku gazi mund të përdoret nga TAP-i, por edhe LPG-ja nga терминаlet në rajon, me çka do të shumëfishojmë rrugët e furnizimit dhe do të forcojmë pavarësinë tonë energjetike duke i përfunduar tubacionet kryesore në të gjithë vendin dhe duke zhvilluar me shpejtësi rrjetet e shpërndarjes për amvisëritë, objektet administrative, tregtare dhe industriale. Do të përfundojë ndërtimi i gazsjellësit magjstral Shkup – Tetovë – Gostivar, me mundësi të vazhimit të mëtejshëm në Kërçovë. Qeveria do të fillojë konsultimet me BNJVL-në për modelin më të përshtatshëm të ndërtimit të rrjeteve të shpërndarjes së gazit natyror.

Qeveria do të fillojë një transformim shtetëror të energjisë që do t'i japë secilit prej qytetarëve tanë mundësinë të jetë një prodhues i energjisë dhe, natyrisht, një shfrytëzues i energjisë ekologjike të pastër dhe më të lirë. Për këtë qëllim parashikojmë projekte të posaçme inovative dhe shumë efektive për kolektorë termikë diellorë (do të përfshihen rreth 100,000 amvisëri në një periudhë prej katër vjetësh, për çka nga buxheti shtetëror do të ishin ndarë rreth 30 milionë euro). Kjo masë do të kontribuojë në uljen e emetimeve të CO<sub>2</sub>-shit në atmosferë me rreth 200,000 tonë në vit.

Qeveria do të caktojë të njëjtin çmim për energjinë e ngrohjes dhe fuqinë e angazhuar në qytetin e Shkupit për të gjithë shfrytëzuesit sipas kategorive të lidhura në rrjetin e ngrohjes, pa marrë parasysh se në cilën komunë dhe vendbanim në qytetin e Shkupit jetojnë ose e kryejnë aktivitetin e tyre.

Nëpërmjet SHA ESM-së do të ndërtojmë sistemin e ngrohjes së Manastirit, Mogillës dhe Novacit për ndërtesat publike në qytet, që do të zvogëlojë ndjeshëm ndotjen, ndërkaq shfrytëzuesit do të kenë një mënyrë të pastër dhe të lirë të ngrohjes. Do të zgjerojmë furnizimin me energji të ngrohjes në vendbanimet Çair, Butel, Shkup Veri, Maxhari 2 dhe Lisiçe, duke e zgjeruar rrjetin e ujit të nxehtë.

Do të nxisim amvisëritë individuale dhe ndërtesat e banimit kolektive, si dhe ndërtesat publike (spitale, shkolla, kopshte,...) për të investuar në pajisje kogjenerimi për prodhimin e energjisë elektrike dhe të nxehtësisë. Nëpërmjet SHA ESM-së, në periudhën 2022-2024, është planifikuar të ndërtohet një impiant i ri kogjenerimi prej 50 MW brenda ndërtesës ekzistuese ENERGETIKA në Hekurishte, që do të mundësojë prodhimin shtesë të energjisë elektrike dhe do të plotësojë nevojat për energji termike më të lirë. Investimi pritet të jetë në nivelin e 35 milionë eurove.

Në kuadër të deponive rajonale, do të inkurajojmë ndërtimin e stacioneve të ndarjes së mbetjeve komunale dhe përdorimin e mbeturinave për të prodhuar e energji elektrike me një çmim preferencial dhe me një blerje të garantuar të energjisë së prodhuar.

## **U anëtarësuam në NATO, mund edhe në BE**

Për tre vjet arritëm që, nga një shtet i izoluar ndërkombëtarisht, të qortuar me fqinjët, me procese të ngecura euro-atlantike, me të ardhme të pasigurt dhe pa perspektivë, të ndërtojmë një shtet shembullor që merr vendime të guximshme për të ardhmen. Vend faktor i stabilitetit dhe i përparimit të rajonit. Marrëveshja e Prespës me Greqinë dhe Marrëveshja e Fqinjësisë së Mirë me Republikën e Bullgarisë i hapën dyert për anëtarësimin tonë në NATO dhe Bashkimin Europian.

E kemi arritur qëllimin strategjik disadekadësh - anëtarësimin në NATO! Kjo do të thotë paqe, stabilitet, një e ardhme e sigurt. Me NATO-n, ne kemi siguruar tërësinë dhe zhvillimin e vendit. Do ta përdorim anëtarësimin në aleancën më të fuqishme me mençuri dhe strategjikisht. Aleanca është një mundësi e shkëlqyer për një vend të vogël me burime të kufizuara për të rritur fuqinë e tij specifike dhe ta përdorë për ndikimin e tij. Për këtë qëllim, do të sigurojmë një Mision aktiv dhe të aftë në NATO, që do të tregojë në vepër se vendi ka njohuri, përvojë dhe një frymë të re moderne të punës dhetë bashkëpunimit.

NATO-ja është një mundësi edhe për komunitetin tonë të afarizmit. Me anëtarësimin e plotë, për ndërmarrjet tona është hapur një zinxhir i madh i furnizimit me prodhime për nevojat e aleancës së NATO-s. I sigurojam informacionet dhe kontaktet e para me agjencitë përkatëse të NATO-s, dhe në mandatin e ri do të ndihmojmë strategjikisht të gjitha ndërmarrjet tona të interesuara të përdorin këtë mundësi për zhvillim dhe eksporte më të mëdha në një mënyrë më të organizuar.

Samiti i Bashkimit Europian në mars 2020 vendosi të çelë bisedimet me Republikën e Maqedonisë së Veriut, pa asnjë kusht. Metodologjia e re e miratuar nga BE-ja për bisedime është në përputhje me atë që është më e rëndësishme për ne. Bisedimet të jenë thelbësore, të parashikueshme dhe efikase, me një qëllim përfundimtar të vetëm dhe të padiskutueshëm: anëtarësimin e plotë në BE.

Integrimin europian dhe të gjitha vendimet dhe hapat reformues i bëjmë për veten tonë. Thelbi i të gjitha proceseve të reformave është që Maqedonia e Veriut të bëhet një shtet modern, i zhvilluar, demokratik, i rregulluar dhe i hapur.

Kriza globale e COVID-19 ka treguar se sa të rëndësishme janë aleancat. Anëtarësimi në NATO dhe bisedimet e çelura për anëtarësimin në BE kanë vërtetuar rëndësinë e të qenët një anëtar i barabartë i këtyre familjeve të mëdha si në kohë zhvillimi ashtu edhe në kohë krize. Mbështetja financiare prej 160 milionë euro nga BE-ja si dhe mbështetja në materiale mjekësore për menaxhim më të lehtë të krizës nuk munguan. Ndihma nga anëtarët e NATO-s ishte e shpejtë dhe efektive.

### *Pa siguri nuk ka zhvillim*

Anëtarësimi në NATO është suksesi ynë më i madh shtetëror. E realizuam ëndrrën e themeluesve të shtetit të pavarur të Maqedonisë. U bëmë e aleancës më të fuqishme ushtarako-politike që bota ka parë ndonjëherë, si një ndër të barabartët. Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk e shohim si fundin, por si fillimin e një kapitulli të ri në historinë e vendit tonë: siguria na jep një mundësi dhe forcë për të qenë më ambiciozë dhe më të fortë në sferat e ekonomisë, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit.

Me anëtarësimin në Organizatën e Traktatit Veriatlantik si dhe anëtarësimin e ardhshëm në Bashkimin Europian, vazhdon ndërtimi i aftësive për mbrojtjen kolektive, sigurinë bashkëpunuese dhe menaxhimin e krizave. Çështja e mbijetesës është një temë e mbyllur dhe stabiliteti, zhvillimi dhe e ardhmja e vendit mbeten parësore.

Rëndësia e mbrojtjes dhe e anëtarësimit në NATO u demonstrua gjithashtu gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të pandemisë së virusit COVID-19. Në kushte të vështira dhe të rrezikshme për jetën, Ushtria sërish e dha provimin Me një rol dhe përgjegjësi të shtuar në mbështetje të policisë, sistemit shëndetësor, shtetit dhe institucioneve lokale. Përballa jonë e suksesshme me pasojat e pandemisë COVID-19 ishte e mundur vetëm me një Ushtri të mobilizuar dhe të përgatitur, në të cilën kontribuan shumë trajnime dhe stërvitje të NATO-s. Për më tepër, ndihma e parë në drejtim të materialit dhe të pajisjeve mbrojtëse arriti nëpërmjet Mekanizmit të NATO-s, Qendrës Euro-Atlantike e Bashkërendimit të Përgjigjeve ndaj Fatkeqësive.

Qëllimi i politikës sonë të mbrojtjes dhe të sigurisë është të sigurojmë zhvillimin paqësor, pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit, integritetin territorial, rendin kushtetues dhe sigurinë e qytetarëve. Me anë të parimeve të transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies nga njëra anë, dhe qëndrueshmërisë dhe zbatimit të politikave të bazuara në produktivitetin dhe rezultatet e deritanishme, nga ana tjetër, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë me reformat e suksesshme në sektorin e mbrojtjes.

Për të vendosur një sistem të qëndrueshëm të mbrojtjes, do të vazhdojmë me financimin e qëndrueshëm të mbrojtjes dhe arritjen e 2% të PBB-së për buxhetin e mbrojtjes deri në vitin 2024 nëpërmjet të rritjes prej 0.2% të PBB-së çdo vit. Financimi i qëndrueshëm do të thotë një ushtri e qëndrueshme dhe e fortë dhe një kontribut i mirëfilltë për aleancën. Një ushtri e fortë do të thotë gjithashtu mbështetje e fortë e shtetit në kushte krizash dhe veprimesh për mbrojtje dhe shpëtim në nivelin kombëtar. Një ushtri e fortë do të jetë gjithashtu një mbështetje e fortë për shoqërinë civile.

Sa u përket dokumenteve strategjike, do të përqendrohemi kryekëputë në Planin e Qëllimeve të Mbrojtjes, që i përcakton planet dhe aktivitetet tona të zhvillimit në përputhje me procesin e planifikimit të mbrojtjes së NATO-s – NDPP (NATO defence planning process) - procesin e planifikimit të mbrojtjes së NATO-s.

Financimi i qëndrueshëm i ushtrisë do të mundësojë rritje të mëtejshme të rrogave, por edhe rritje të gatishmërisë luftarake dhe të ndërveprimit të ushtrisë dhe modernizimin e saj serioz, veçanërisht duke marrë parasysh sfidat e reja të sigurisë. Qeveria do të zbatojë Planin e pajisjes dhe të modernizimit të ushtrisë në përputhje me prioritetet për pajisjen e forcave të deklaruara me anë të projekteve shumëvjeçare: zhvillimi i grupit të Batalionit të Këmbësisë së Lehtë i vendosur në garnizonin në Shtip, duke u përqendruar në trajnimin dhe pajisjen, vazhdimi i projektit të filluar për blerjen e autobindave me rrota, mbrojtja kibernetike, sigurimi i aviacionit ushtarak të prodhimit perëndimor, blerja i pajisjeve mbrojtëse personale për pjesëtarët e ushtrisë, blerja i sistemeve të mbrojtjes kundërajrore. Do të shpeshtojmë trajnimet dhe aktivitetet ushtruese. Në të ardhmen dhe në këtë segment do të përqendrohemi te forcat e deklaruara, përkatësisht Grupi i Batalionit të Këmbësisë së Lehtë.

Qeveria do të vazhdojë të investojë në modernizimin e Poligonit të Ushtrisë "Krivolak" (lidhja infrastrukturore, zhvillimi i përmbajtjeve të reja, zgjidhja e problemit të furnizimit me ujë), që do të

bëhet pasuri e brendshme dhe e NATO-s, por gjithashtu do të kontribuojë në forcimin e ekonomisë lokale dhe nacionale. Ekspertët e NATO-s dhe Shtetet e Bashkuara i vlerësojnë shumë kapacitetet e PU "Krivolak", me mundësinë e rritjes në një terren për aftësime dhe aktivitete trajnimi të NATO-s. Në të njëjtën kohë, do të sigurojmë një stacion të përhershëm matës për të treguar respektimin e të gjitha standardeve të mbrojtjes së mjedisit.

Do të specializohemi në frymën e konceptit të "mbrojtjes së zgjuar". Informacionet dhe lajmet e rreme, si dhe komunikimet strategjike dhe marrëdhëniet me publikun, bëhen çështje sigurie të përparësisë më të lartë. Kemi përvojë dhe njohuri që mund ta ofrojmë dhe përditësojmë: Qendrën Rajonale të Marrëdhënieve me Publikun (QRMP), brenda Ministrisë së Mbrojtjes, si një Qendër e Akredituar e NATO-s e Trajnimit dhe e Edukimit, do ta zhvillojmë në një Qendër Rajonale të Luftimit të Dezinformimit dhe të Lajmeve të Rreme, për nevojat e krahut jugor të NATO-s, në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Përsosmërisë së Komunikimeve Strategjike në Riga.

Vazhdojmë me përmirësimin dhe ripërtëritjen e infrastrukturës së objekteve ushtarake me rinovimin e objekteve të vjetra dhe ndërtimin e objekteve të reja, me zbatimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë kudo dhe rindërtimin e kazermave Ilinden, Komandën SEEBRIG, Akademisë Ushtarake, rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit në kazermën e Shtipit.

Në vitin e parë të mandatit, Qeveria do të ofrojë reformë strukturore të sistemeve të menaxhimit të krizave dhe mbrojtje dhe shpëtim nëpërmjet riorganizimit, pajisjes dhe trajnimit të ekipeve operacionale për ndërhyrje të shpejtë. Këto segmente janë themeli në ndërtimin e një shoqërie rezistente ndaj krizave dhe fatkeqësive. Kjo është demonstruar gjatë krizës dhe emergjencës së shkaktuar nga pandemia e virusit korona. Në gjysmën e parë të mandatit do të realizojmë sistemin për thirrje "112".

NATO është gjithashtu një mbështetje për shkencën vendase! Në bashkëpunim me universitetet, do të prezantojmë një linjë buxhetore në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për të mbështetur projekte shkencore me interes për mbrojtjen. Do të merren parasysh edhe mësimet e marra dhe përvoja nga pjesëmarrja në projektet "Shkenca për Paqen". Ministria e Mbrojtjes do të mbështesë çdo projekt shkencor që do të sigurojë mbështetje financiare nga fondet e shkencës së mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s ose nga Aleanca.

Në 12 muajt e parë, Qeveria do të propozojë ndryshime në Ligjin e Furnizimeve Publike që të lejojnë menaxhim të drejtpërdrejtë të fondeve me vlerë prej rreth 500 euro nga komandat dhe kazermat - decentralizimi i buxhetit.

Në Ministrinë e Mbrojtjes do të themelojmë një qendër për mbështetjen e ndërmarrjeve vendase për pjesëmarrje në tenderët e NATO-s. Qëllimi ynë do të jetë që, në vitin e parë të anëtarësimit tonë në NATO, të sigurojmë komunikim të plotë midis dhomave tona dhe agjencive përkatëse të NATO-s.

Qeveria do të vazhdojë të theksojë rëndësinë dhe rolin e diplomacisë parandaluese, parandalimin e konflikteve dhe aktivitetet humanitare. Dhe në vitin 2020, vazhdojmë të përqendrohemi në pjesëmarrjen tonë në operacionet paqeruajtëse ndërnacionale dhe misionet civile në të ardhmen.

#### *Qëllimi i radhës: anëtarësimi në BE*

Për tre vjet, e kemi ndryshuar rrënjësisht pamjen e Maqedonisë së Veriut në rajon dhe në botë. Paralelisht me zgjidhjen e çështjeve dypalëshe dhe thellimin e bashkëpunimit rajonal, kemi filluar reforma të thella të brendshme në fushat më kritike të sundimit të ligjit dhe ndërtimin e një shteti demokratik funksional - reforma në drejtësi, reforma e administratës publike, reforma e shërbimeve të sigurisë dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsioni.

Qëllimi i politikave të qeverisë është që standardet dhe vlerat europiane t'i sjellim në shtëpi dhe t'u mundësojmë qytetarëve një mënyrë europiane të jetës. Bashkimi European është një sistem vlerash që nënkupton sundimin e ligjit, ku të gjithë jemi të barabartë para ligjit, ku rendi, rregullat dhe

organizimi janë të parashikueshëm dhe janë pjesë e jetës sonë të përditshme. Përparimi që kemi bërë gjatë tre viteve të kaluara nënkupton fonde më të hapura për qytetarët tanë, të cilët mbështesin solidaritetin, shoqërinë e barabartë për të gjithë, infrastrukturën cilësore, bujqësinë prodhuese dhe të qëndrueshme dhe një mjedis të shëndetshëm.

Maqedonia e Veriut ka një koncept që mund të jetë një model i dobishëm për Bashkimin European. Sjellja jonë, pjekuria dhe komuniteti që ne ndërtojmë, si dhe qëndrimi ynë ndaj fqinjëve tanë dhe sfidat në shtëpi, mund t'i shtojnë vlerë Europës. Fakti që, nga krizat tona të thella politike, shoqërore dhe ekonomike, kemi dalë më të pjekur, më të fortë dhe më të mençur, mund të jetë një shembull për zgjidhjen e disa çështjeve të hapura në rajon dhe në BE.

Më 26 Mars 2020, Këshilli European vendosi të çelë bisedimet me vendin tonë, për anëtarësimin në BE. Këtë vendim e kemi pritur 15 vjet dhe e merituar. Me çeljen e bisedimeve të anëtarësimit në BE, nisim me transformimin më të thellë të shoqërisë dhe pranimin gradual, por të plotë dhe të qëndrueshëm të rregullave, parimeve dhe vlerave europiane. Qeveria do të sigurojë që transformimi të jetë efikas dhe i suksesshëm, dhe në të njëjtën kohë të mbrojë interesin tonë si shtet, interesin e ekonomisë sonë dhe të qytetarëve tanë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka një plan ambicioz, por realist: të përfundojë bisedimet sa më shpejt të jetë e mundur dhe të bëhet një vend anëtar i BE në valën tjetër të zgjerimit. Në vitin 2020 i nisim bisedimet e anëtarësimit dhe jemi të bindur se vendi ynë ka kapacitetin, aftësinë dhe vullnetin që deri në vitin 2024, në mandatin e kësaj qeverie, t'i çelë 80% të kapitujve dhe të jetë së paku në të njëjtin nivel integrimi me vendet e Ballkanit Perëndimor që aktualisht negociojnë anëtarësimin në BE.

Prandaj:

- Krijojmë një strukturë negociuese të motivuar, efikase dhe profesionale;
- Sigurojmë pajtueshmëri të gjerë midis partive politike, por edhe në shoqëri në përgjithësi, për reformat thelbësore në lidhje me pranimin tonë në Bashkimin European. Do t'u bëjmë thirrje të gjithëve që ta vendosin anëtarësimin në BE para interesave të tyre politikë dhe të mbështesin zbatimin e përparësive të BE-së dhe rekomandimet e institucioneve europiane.
- Tashmë jemi duke zhvilluar një bazë të dhënash për të gjithë ekspertët vendas dhe profesionistë nga diaspora, të cilët do të përfshihen aktivisht në grupet e punës për bisedime;
- Do të krijojmë kushte për lidhje më të mirë infrastrukturore me Brukselin. Do të shqyrtojmë nënshkrimin e një partneriteti strategjik me një ndërmarrje ajrore europiane për të vendosur një linjë ajrore të drejtpërdrejtë, të rregullt me Brukselin;
- Do të krijojmë një program të veçantë buxhetor për bisedimet me BE-në në buxhetet e ministrive dhe institucioneve të tjera kompetente;
- Në konsultim me universitetet, do të mbështesim programe të reja ose të përshtatura arsimore që do të ndërtojnë staf për nevojat e vendit në institucionet europiane;
- Do të kemi bashkëpunim proaktiv me të gjitha institucionet, partitë politike, komunitetin e afarizmit, shoqërinë civile dhe mediat, me synim që ta sjellim procesin e bisedimeve sa më pranë qytetarëve. Ne bisedojmë në emër të të gjithë vendit. Prandaj, bisedimet do të përfshijnë të gjithë: qeverinë, administratën, kuvendin, rregullatorët, shoqërinë civile, komunitetin akademik, botën e afarizmit;
- "Rrjeti Informativ i BE-së": pikat ekzistuese të informacionit të BE-së do t'i transformojmë në qendra rajonale për Europën, ku do të ketë prezantime të përditshme të mundësive që i kanë qytetarët dhe sektori i afarizmit për të përdorur paratë europiane dhe arsimin e vazhdueshëm për thithjen dhe përdorimin maksimal të instrumenteve që ofron procesi i paraanëtarësimit.

Gjatë pandemisë së virusit COVID-19, Bashkimi European e vërtetoi solidaritetin european me Ballkanin Perëndimor dhe Maqedoninë e Veriut në veprim. BE-ja ka caktuar 3.3 miliardë euro për rimëkëmbjen makro-financiare të Ballkanit Perëndimor dhe të fqinjësisë pas pandemisë, nga të cilat 160 milionë euro janë siguruar tashmë për ne. Përveç kësaj ndihme, BE ka siguruar mbi 66 milionë € grante

që mund të përdoren për të ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për të garantuar shlyerjen e buxhetit të vendit. Katër milionë euro ndihmë në pajisje mjekësore për të forcuar kapacitetin e sistemit shëndetësor u miratuan dhe pjesërisht u dhanë nga fillimi i pandemisë. Bashkimi Europian ka përfshirë vendet tona në Fondin Europian të Solidaritetit, në furnizimin e përbashkët të prodhimeve të domosdoshme në mungesë, si dhe në vendet ku pajisjet mjekësore mund të eksportohen nga BE-ja, pa leje.

Deri në fund të vitit 2020, BE-ja do të përgatisë një plan të fuqishëm ekonomik dhe investimesh për Ballkanin Perëndimor për të ringjallur ekonominë dhe për të përmirësuar konkurrencën. Presim që solidariteti të ruhet si një vlerë e lartë europiane, dhe planet e ndihmës të bazohen në investime të drejtpërdrejta në zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve dhe hua të lira në vend të kredive të shtrenjta, kursimeve të paarsyeshme dhe mbingarkesës afatgjatë.

Të gjitha fondet, pavarësisht fushës ku drejtohen, do të përdoren për të forcuar dhe reformuar institucionet dhe politikën, për të promovuar dialogun me të gjithë aktorët e interesuar dhe për të matur ndikimin e tyre në përfshirjen sociale, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Qëllimi i qeverisë do të jetë afrimi i fondeve me qytetarët - të jenë më të arritshëm, më të dukshëm. Kjo do të thotë që përveç institucioneve shtetërore, do të sigurojmë fonde të reja IPA 3 për komunat, shkollat, sindikatat, grupet e marginalizuara, punëdhënësit, të papunët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, organizatat e shoqërisë civile, universitetet dhe institucionet kërkimore, madje edhe për grupet joformale të qytetarët.

1. Të vetëdijshëm për sfidat në fuqinë përthitëse, Qeveria do të investojë në kapitalin njerëzor në institucione, dhe më gjerë, për përgatitjen e projekteve të të menduara mirë që do të financohen nëpërmjet IPA 3 dhe përgatitjen e vendit për përdorimin më të suksesshëm të fondeve të mëdha strukturore dhe kohezive europiane. Projektet i zhvillojmë në disa shtylla kryesore:

2. Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia;

3. Qeverisja e mirë, harmonizimi me standardet europiane, komunikimi strategjik dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë;

4. Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme - mjedisi dhe ndryshimi i klimës / transporti / ndryshimi digjital / energjia / ekonomia qarkulluese;

5. Konkurrenca dhe rritja gjithëpërfshirëse - reformat strukturore / investimet kapitale / ndërtimi i kapaciteteve administrative;

6. Bashkëpunimi territorial dhe ndërkuftar - INTERREG / CBC.

*Për këtë qëllim:*

- Do të përpilojmë Dokument Strategjik Nacional për Ndihmën Dypalëshe. Sikur që ekziston një Dokument Strategjik Nacional për Ndihmë Europiane, kështu do të përpilojmë një dokument të tillë për ndihmë nga vendet e tjera (ndihma dypalëshe);

- Do të zbatojmë linja buxheti për bisedime dhe për zhvillimin e politikave. Nevoja për të siguruar një paketë të tillë fleksibël financiare lind nga nevojat *ad-hoc* që lindin në fazën e harmonizimit me legjisllacionin e BE-së, që nuk mund të parashikohen në fazën e programimit të fondeve IPA;

- Do të ndajmë grante për bashkëfinansim të projektit dhe ndihmës në zhvillimin e projekteve cilësore dhe të menduara mirë të BE-së, mbështetja nëpërmjet skemave të kuponave dhe konsulentëve kornizë: Zhvillimi i projektit është një aktivitet tregtar, që do të nxisë individët dhe ndërmarrjet të fillojnë këtë afarizëm dhe zhvillim të të ashtuquajturit sistem i kuponëve. Ky sistem është veçanërisht i përshtatshëm për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme kur përdorin fonde nga programet e Unionit, veçanërisht në zhvillimin e zgjidhjeve inovative dhe të digjitalizuara. Sistemi i kuponëve do të jetë i disponueshëm për grupe të tjera të synuara, të tilla si bujqit në zhvillimin e projekteve nga programi IPARD, institucionet arsimore për Programin Erasmus + dhe të tjerët. Sistemi i këshillimit do të rregullohet në

mënyrë rigoroze duke ndjekur shembullin e konsulentëve kuadër të BE dhe do të marrë përfitime shtesë, kryesisht lehtësime tatimore.

- Do të ndajmë grante për bashkëfinancim të projekteve dhe lidhje me statusin e interesit publik. Çdo organizatë që do të tërheqë fonde europiane dhe do të marrë fonde për bashkëfinancim, do të fitojë statusin e "organizatës me interes publik" dhe do të marrë përfitime shtesë, kryesisht lehtësime tatimore.

Nuk ka integrim të suksesshëm në BE pa njerëz cilësorë në institucione: të motivuar, kompetent, të trajnuar mirë, njerëz me integritet të cilët do të jenë shtylla kryesore e procesit të ndryshimit pozitiv. Do të zhvillojmë një politikë gjithëpërfshirëse, të zgjuar të mbajtjes së personelit.

### ***MK në botë***

Jemi bërë shembull në rajon për miqësi dhe bashkëpunim. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me fqinjët ka çuar në krijimin e flukseve të reja pozitive ekonomike dhe financiare dhe solli energji të freskët në bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor.

Suksesi ynë është konfirmuar nga Bashkimi Europian. Për herë të parë, vendet e Procesit të Berlinit ranë dakord këtë vit të kryesojnë dy vende, një nga Ballkani Perëndimor - Republika e Maqedonisë së Veriut dhe një shtet anëtar i BE-së - Republika e Bullgarisë. Kryesimi me Procesin e Berlinit është një mundësi për ndikimin tonë më të madh në proceset dhe politikat në rajon, por edhe për promovimin e sukseseve tona dhe bashkëpunimin më të fortë ekonomik.

Interesi kryesor i MK-së në bashkëpunimin rajonal është zhvillimi i masave praktike që lehtësojnë jetën e përditshme të qytetarëve dhe heqin pengesat për tregti më të lehtë, më shumë investime, lëvizshmëri më të madhe të kapitalit njerëzor dhe digjitalizim dhe modernizim më të shpejtë të Ballkanit Perëndimor. Nëpërmjet një bashkëpunimi të tillë rajonal, ne, vendet e Ballkanit Perëndimor, treguam pjekuri që mund të bëjmë diçka për rajonin dhe qytetarët tanë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të vazhdojë të ndërtojë dhe rivendosë klimën pozitive të bashkëpunimit, besimit dhe respektit ndërmjet vendeve në rajon. Do të hapim gjashtë vendkalime të reja kufitare me fqinjët që të mundësojmë komunikim më të lehtë në pikat kufitare, përkatësisht Strezimir-Restelicë (me Kosovën), Maiden-Promahi dhe Këmba e Markos (me Greqinë), Klepallë (me Bullgarinë), Llojan-Miratoc dhe Golesh- Bosiligrad (me Serbinë), dhe Xhepishtë-Trebishtë (me Shqipërinë).

Prespa si rajon gjeografik bashkon tre vende, tre kombe, grupe të ndryshme etnike, gjuhë, tradita, kultura. Pasuria e saj e shumëllojshmërisë bashkon thesare të jashtëzakonshme natyrore dhe trashëgimi kulturore dhe historike. Prandaj, do të fillojmë nismë për një Qendër Rajonale për Dialog - Forumi i Prespës. Forumi rajonal për fqinjësi të mirë dhe zgjidhjen e çështjeve dypalëshe, por edhe një forum nga i cili do të dalin nisma të reja për bashkëpunimin rajonal. Brenda forumit, do të mbështesim procesin e krijimit të zyrave për bashkëpunim të të rinjve MK-GR, si dhe të gjitha aktivitetet dhe projektet e zyrave që do të mundësojnë shkëmbimin e përvojave dhe lidhjen e të rinjve nga të dy vendet.

Duke udhëhequr një politikë të njohur, marrim pjesë aktive në punën e Këshillit të Europës, OKB-së, OSBE-së, OBT-së, UNESCO-s, si dhe në të gjitha organizatat e tjera ndërnacionale në të cilat jemi anëtarë; do të këmbëngulim që të promovojmë modelin e suksesshëm të marrëdhënieve ndëretnike në vend dhe politikën e fqinjësisë së mirë.

Republika e Maqedonisë së Veriut është një partner i besueshëm në luftën kundër terrorizmit dhe një anëtar i Koalicionit Global për Fitoren mbi ISIS-in. Në këtë drejtim, ajo mbështet fuqimisht rolin e NATO-s në luftën e bashkësisë ndërkombëtar kundër terrorizmit.

Në politikën e jashtme, Qeveria do të miratojë një Strategji të Diplomacisë Publike që do të përcaktojë me kujdes qëllimet dhe drejtimet, si dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve të

interesuara dhe kompetente, dhe do të harmonizojë qëllimet e politikës së jashtme dhe politikën nacionale. Përveç përfaqësuesve të institucioneve qeveritare, në përgatitjen e kësaj strategjie do të përfshihen edhe organizatat joqeveritare dhe ndërnacionale. Do të krijojmë një Rrjet të qytetarëve tanë të suksesshëm jashtë vendit dhe do t'i thërrasim ata që të ndihmojnë në përpjekjet tona për të promovuar vendin. Ne gjithashtu do të bëjmë promovim të synuar të potencialeve ekonomike, kulturore dhe turistike: "Toka e Mundësive" (me theks në sukseset e reja në kulturë: Oskar, Eurovision).

Qeveria do të vazhdojë të investojë në një rrjet diplomatik cilësor, duke optimizuar misionet diplomatike dhe forcuar kapacitetin njerëzor dhe teknik në to. Sektori i Diplomacisë Publike do të kryejë përgatitje konkrete dhe të hollësishme të stafit diplomatik me elemente për veprimtarinë e tyre diplomatike në drejtim të diplomacisë publike, kulturore dhe ekonomike.

Do të favorizojmë e-Ambasadat. Do të digjitalizojmë shërbimet e bashkëqytetarëve tanë të cilët udhëtojnë jashtë vendit, ose që qëndrojnë përkohësisht dhe përgjithmonë jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut duke prezantuar aplikacionin "e-Embassy" në mënyrë që PDK-të tona të përmbushin në kohë nevojat, kërkesat e bashkëqytetarët tanë.

Qeveria tashmë ka miratuar Strategjinë e parë Nacionale për Bashkëpunim me Diasporën. Me këtë, kemi vendosur një urë të fortë që do të rezultojë në një bashkëpunim cilësor dhe konstruktiv midis shtetit dhe diasporës në disa fusha, siç janë: çështjet politike-ligjore dhe konsullore, ekonomia, arsimit, shkenca, rinia dhe kultura. Qeveria do të vazhdojë të sigurojë mbështetje financiare për projekte të diasporës siç janë mbi 50 projekte në tre vitet e fundit. Kështu, për investimet fillestare krahasuar me investitorët vendas dhe të huaj, për investitorët e diasporës, mbështetja financiare nga shteti është më e lartë për 10%.